

KOPERTINA

TERMINOLOGJI INFORMATIKE

Problematika dhe zgjidhje

ERION ÇANO, EDMOND TUPJA

Tiranë, mars 2022

Titulli i librit: **TERMINOLOGJI INFORMATIKE** *Problematika dhe zgjidhje*

Autorë: Erion ÇANO, Edmond TUPJA

Ky libër elektronik licensohet nën Licensën Ndërkombëtare Creative Commons Attribution 4.0 (CC BY 4.0) në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e saj që shpjegohen te adresa më poshtë:

<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>



Tiranë, mars 2022

PASQYRA E LËNDËS

1	Parathënie	9
2	Problematika të përgjithshme drejtshkrimore	13
2.1	Gjuha dhe interneti	13
2.2	Përkthimet automatike	14
2.3	Shkronjat ë dhe ç	16
2.4	Emrat e përveçëm	18
2.5	Drejtshkrimi i shkurtesave	21
2.6	Mënyra e disa foljeve	22
2.6.1	Veprime të përgjithshme	22
2.6.2	Veprime në postën elektronike	24
2.6.3	Veprime në internet	25
2.7	Presja dhjetore	27
2.8	Shkronjat e mëdha	28
3	Problematika të ndryshme leksikore	30
3.1	Parashtesa dhe prapashtesa	30
3.1.1	Parashtesa EN	30
3.1.2	Parashtesa DE	31
3.1.3	Parashtesa HYPER	33
3.1.4	Prapashtesa AL	34
3.1.5	Prapashtesa ER	35
3.1.6	Prapashtesa ACION	36
3.1.7	Prapashtesa TIVE	39
3.1.8	Prapashtesa ICIEN	39
3.2	Shtrembërimet fonetike	40
3.2.1	Ngatërrime të c-së me ç-në	40
3.2.2	Shtrembërimet të fonemës GJ	41
3.2.3	Prurjet me shkronjën W	42
3.3	Mospërkthime të fjalëve e shprehjeve	43
3.4	Prurje të panevojshme	67
3.5	Mospërshtatje dhe keqpërshtatje	76
3.6	Mungesa dhe neologjizma	83
3.7	Harresa dhe rijetësime	89
3.8	Shmangie nga tradita	92
4	Problematika të hapura	96
5	Problematika të teksteve shkollore	104

SHKURTIME GJUHËSORE

em.	emër	num.	numëror
mb.	mbiemër	parafj.	parafjalë
fol.	folje	përem.	përemër
shpr.	shprehje	lidh.	lidhëz
ndajf.	ndajfolje	pasth.	pasthirmë
pj.	pjesëz	shkurt.	shkurtesë/shkurtim
parasht.	parashtesë	prapasht.	prapashtesë

SHKURTIME KUPTIMORE

alg.	algoritmikë	pers.	person/personalitet
a.p.	arkitektura përpunimi	p.f.	pjesë/pajisje fizike
b.d.	baza të dhënash	prog.	programim
elek.	elektronikë	rrj.	rrjete informatike
e.n.	elektronikë numerike	sig.	siguri sistemi/rrjeti
graf.	grafikë/tipografi	s.d.	struktura të dhënash
i.a.	inteligjencë artificiale	s.o.	sisteme operative
i.s.	inxhinieri softuer	stan.	standarde
kod.	kodim/kode	stat.	statistikë
krip.	kriptografi	sh.t.	shkencë e teknologji
logj.	logjikë	h.u.	hapësira ueb
mat.	matematikë	tel.	telekomunikim

1 Parathënie

Përparimi i vrullshëm i teknologjisë së informacionit dhe i drejtimeve si elektronika, informatika, robotika dhe telekomunikimi gjatë tri dekadave të fundit ka sjellë ndryshime të mëdha në shoqëri. Informatizimi i jetës sonë dhe kultura e sotme e rrjeteve shoqërore virtuale nuk mund të mos të ndikonin edhe te gjuha me të cilën shkëmbehet sasia e jashtëzakonshme e informacionit në internet. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm ka qenë ngritja e anglishtes në pozitën e gjuhës ndërkombëtare, pozitë që deri para një shekulli i takonte latinishtes dhe deri rreth 40 vite më parë gjuhës frënge. Epërsia dhe mësymja e gjuhës angleze ndaj gjuhëve të tjera në dekadat e fundit kanë qenë të padiskutueshme, duke u nxitur pjesërisht edhe nga zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit, për të cilat duhet pranuar se kontributin kryesor e kanë dhënë shoqatat dhe firmat e mëdha amerikane.

Hapja e vendit tonë e shoqëruar me lëvizjen e njerëzve dhe hyrja e vrullshme e fjalëve të gjuhës angleze kanë bërë që këto fjalë të përdoren së tepërmi në gjuhën e folur, shpesh pa përshtatje ose me një përshtatje minimale dhe jo sistematike. Po dëgjojmë gjithnjë e më shpesh në ligjërimin bisedor e madje edhe në media dhe televizione huazime si *foruordoj*, *logohem*, *sejvoj*, *insertoj*, *sortoj* etj., të cilat janë jo vetëm të pasakta, por edhe qesharake. Problemet e shqipërimit të fjalëve të huaja po vihen re për fat të keq edhe në botime. Shqetësim të madh në këtë pikë përbëjnë botimet shkollore të lëndëve të informatikës dhe të teknologjisë së informacionit për klasat e arsimit parauniversitar, tekste që ndikojnë drejtpërdrejt në formimin tekniko-shkencor, por edhe atë gjuhësor të rinjve e të rejave.

Ky libër paraqet një shqyrtim të gjerë bibliografik, që përqendrohet tek terminologjia e teknologjisë së informacionit dhe botimet e lidhura me të. Pavarësisht titullit të përmbledhur që kufizohet tek disiplina e informatikës, bibliografia e shqyrtuar është e larmishme dhe analiza terminologjike shtrihet jo vetëm në drejtimit më specifike të informatikës, por edhe në fusha të tjera të lidhura ngushtësisht me teknologjinë e informacionit, si: matematika, logjika, statistika, elektronika analoge, elektronika numerike, telekomunikimi etj. Është zhbiruar fund e krye terminologjia në 31 tekste shkollore, nga të cilat 19 janë për klasat e arsimit parauniversitar dhe 12 për lëndë të ndryshme të arsimit universitar. Janë shqyrtuar gjithashtu me imtësi 2 tekste universitare në gjuhën italiane (për referenca ndërgjuhësore), 9 fjalorë të vjetër shumëgjuhësh (në gjuhën shqipe dhe disa gjuhë të tjera) të disiplinave tekniko-shkencore, 3 fjalorë në gjuhët angleze, italiane dhe frënge, 4 fjalorë të përgjithshëm në gjuhën shqipe (FGJSSH dhe tre të tjerë), 2 botime të natyrës informuese, 2 studime gjuhësore, si dhe 4 artikuj studimorë të viteve të fundit.

Problemet gjuhësore që vihen re janë nga më të ndryshmet. Te tekstet shkollore ndeshen shpesh renditje të palogjikshme të kapitujve dhe të njësisve mësimore, përkthime me “Google Translate” të shprehjeve e fjalëve të ndryshme, mospërshtatje të prurjeve leksikore, gabime në lakimet e emrave, gabime logjike nga pakujdesia etj. Ajo që vihet re më shumë është pasiguria në përkthimin apo përshtatjen e fjalëve të koncepteve, teknologjive etj. Brenda të njëjtit tekst (madje shpesh tek e njëjta faqe) hasen emërtime të ndryshme për të njëjtin koncept. Një emërtim mund të ndeshet p.sh. pa asnjë përshtatje, si fjala në anglisht, dhe tjetri mund të paraqitet me njëfarë përshtatjeje fonetike. Shkaqet e problematikave të shumta gjuhësore në tekstet shkollore mund të jenë të ndryshme. Njëri prej tyre mund të jetë prirja “për t’i rënë shkurt” dhe për të shkruar apo përkthyer sa më shpejt. Varfërimi i njohjes së leksikut të shqipes nga autorët dhe përkthyesit mund të jetë një tjetër arsye. Një pjesë e përgjegjësive qëndron pa dyshim edhe te redaktimet, të cilat nëse janë të shpejta e të pakujdesshme, nuk arrijnë të kapin gabimet logjike e drejtshkrimore që po shfaqen.

Vlen të theksojmë se shkaqet e problemeve gjuhësore, veçanërisht të atyre që lidhen me përshtatjet e fjalëve të huaja, nuk mund të kufizohen tek autorët dhe botuesit. Një tjetër arsye është pa dyshim mungesa e studimeve terminologjike që do të shërbenin si bazë orientuese në ndihmë të arsimtarëve për një përgatitje më cilësore të materialeve mësimore përkatëse. Një faktor që ka ndikuar negativisht ka qenë me siguri edhe mungesa e fjalorëve tekniko-shkencorë të disiplinave të reja. Seria më e plotë e fjalorëve terminologjikë që kemi gjetur është [1–8] botuar rreth 50 vjet më parë. Shqipërimi i termave në këta fjalorë vlen edhe sot, por referencat ndërgjuhësore janë shumë të pakta për arsye se terminologjia e asaj kohe ka qenë e kufizuar. Një kufizim tjetër është fakti që si gjuhë krahasimi jepen vetëm frëngjishtja, rusishtja dhe serbokroatishtja, pra mungon gjuha angleze. Kjo ka qenë e kushtëzuar nga rrethanat gjeopolitike të asaj kohe. Nevoja për fjalorë bashkëkohorë nga fusha e teknologjisë së informacionit është e kuptueshme dhe vihet në dukje gjithashtu nga vetë autorët e teksteve, siç ndodh p.sh. te [9] f. 3. Shqipërimi i termave nga këto disiplina përbën një domosdoshmëri për lehtësimin e punëve përkthimore dhe për ruajtjen e gjuhës shqipe, si edhe një mundësi të mirë për kultivimin e pasurimin e saj.

Mungesën e studimeve dhe fjalorëve jemi munduar ta lehtësojmë disi nëpërmjet këtij punimi ku, veç vrojtimit të problematikave, jemi përpjekur të japim edhe zgjidhje për secilën prej tyre. Trajtohen fillimisht disa problematika të rëndësishme drejtshkrimore si shmangia e shkronjave ë dhe ç, shkrimi dhe lakimi i emrave të përveçëm (veçanërisht emrat e markave dhe të firmave ndërkom-bëtare), shkrimi e lakimi i shkurtesave dhe shkrimi në mënyrën urdhërore i disa foljeve që shprehin komanda. Vazhdohet më tej me disa problematika

të natyrës stilistike si presja e numrave dhjetorë dhe përdorimi i shkronjave të mëdha. Pjesa më e madhe e problemeve që vihen në dukje kanë të bëjnë me shqipërimet dhe përshtatjet e prurjeve nga gjuha angleze. Parashtesat dhe prapashtesat kanë rëndësi të veçantë, sepse përbëjnë një cilësi tipike të gjuhës që duhet ruajtur. Diskutohen më tej disa probleme të natyrës fonetike, si p.sh. ngatërrimet e shkronjave *xh* dhe *gj* apo *c* dhe *ç*.

Ndër problemet më të shpeshta që ndeshen dendur në bibliografi është edhe mospërkthimi i fjalëve të ndryshme nga anglishtja, megjithëse ka fjalë përkuese në gjuhën shqipe që e mbartin mjaft mirë kuptimin e tyre. Jemi munduar të japim edhe përkthime të shprehjeve që përfaqësojnë teknologji apo teknika të reja, por që shfaqen pa përkthim nëpër punime diplomash apo shkrime të tjera shkollore. Prurjet e panevojshme dhe keqpërshtatjet janë bërë gjithashtu objekt i një vëmendjeje të rëndësishme. Jemi përpjekur të nxitim përdorimin e formave të sakta të fjalëve shqipe që i zëvendësojnë mirë ato, në secilin kuptim e rast përdorimi. Duhet pranuar se për disa fjalë të anglishtes, nuk gjehen fjalë përkuese në gjuhën shqipe. Në raste të tilla, jemi munduar të gjejmë dhe të propozojmë kompozita të përshtatshme nisur nga kuptimet e morfemave në përbërje të fjalëve angleze. Në disa raste, kemi gjukuar se zëvendësimi i fjalëve të huaja mund të bëhet duke rijetësuar disa fjalë të vjetra e të “harruara” të cilat na duken të përshtatshme. Vështirësitë e shqipërimit në fushën e teknologjisë së informacionit duken të pakapërcyeshme për disa fjalë, pavarësisht përpjekjeve fjalëformuese, fjalëve të gjetura në FGJSSH dhe në fjalorët e tjerë të përdorur, si edhe fjalëve të dobishme që kemi vjelë nga bibliografia. Shembujt e kësaj kategorie paraqiten si problematika të hapura dhe përfshijnë ndërkombëtarizma, fjalë informale dhe me kuptime të figurshme apo mungesa të hershme që janë zëvendësuar me përshtatje të pjesshme të cilat janë rrënjësuar prej kohësh si në gjuhën e folur, edhe në botime. Nevojiten diskutime të gjera për të qartësuar format e duhura të përshtatjes së ndërkombëtarizmave apo mënyrën e shqipërimit të prurjeve të papërshtatura. Në fund, kemi paraqitur përmbledhtazi dhe me pak shembuj problemet më të zakonshme që ndeshen në tekstet shkollore të informatikës dhe të teknologjisë së informacionit.

Diskutohen rreth 500 kuptime fjalësh e shprehjesh, që shoqërohen me rreth 600 citime nga bibliografia. Secili citim përfaqëson një përdorim të saktë, të pasaktë ose të diskutueshëm të fjalës që shqyrtohet. Secila fjalë që diskutohet jepet fillimisht në gjuhën angleze, me shkrim kursiv e të theksuar. Jepet më tej, brenda kllapave katrore, transkriptimi i shqiptimit të saj me shkrim daktilografik. Për këtë të fundit, i jemi referuar fjalorit Oxford Advanced Learner's Dictionary.¹⁾ Vazhdohet me shkurtimin e pjesës së ligjëratës, të paraqitur me

¹⁾<https://www.oxfordlearnersdictionaries.com>

shkrim kursiv, të theksuar dhe të zvogëluar. Bashkësia e shkurtimeve gjuhësore, ku përfshihen edhe shkurtime të pjesëve të ligjëratës, sqarohet te tabela e shkurtimeve gjuhësore. Më tej jepet shkurtime i fushës apo disiplinës në të cilën fjala përdoret më shpesh, i shkruar me shkrim të theksuar dhe të zvogëluar. Shkurtime të këtyre fushave të përdorimit sqarohen në tabelën e shkurtimeve kuptimore. Vazhdohet me shpjegimin e fjalës dhe diskutime të problemeve që paraqet fjala, një apo disa forma të gabuara apo të papërshtatshme të saj, si edhe formën e saktë që sugjerojmë. Format e sakta në gjuhën shqipe shkruhen me shkrim të theksuar. Format e gabuara shkruhen me shkrim normal të vijëzuar. Po të vijëzuara paraqiten edhe fjalë të tjera të gabuara që gjenden brenda shkëputjeve nga bibliografia. Vijëzimi të këto shkëputje është shtuar nga ne dhe nuk figuron te njësi bibliografike nga është marrë shkëputja. Shembuj të formave të tjera jepen me shkrim kursiv të drejtë për fjalët shqipe, dhe shkrim kursiv të pjerrët për fjalët angleze.

Format e sakta e të gabuara të fjalëve shoqërohen shpesh edhe me shembuj nga njësitë bibliografike ku ato janë ndeshur. Për secilin citim jepet indeksi nga lista e njësive bibliografike i ndjekur nga numri i faqes brenda tekstit ku fjala gjendet. Në fund jepen dhe shembuj përkthimi të shprehjeve në të cilat figuron fjala e diskutuar. Kemi zgjedhur qëllimisht këtë formë të paraqitjes së fjalëve, sepse mendojmë se në këtë mënyrë mund t'u vijmë në ndihmë përkthyesve, të cilët mund të kërkojnë fjalën angleze e të gjejnë më tej fjalën shqipe, si dhe shembujt ilustrues të përkthimeve. Renditja alfabetike e fjalëve në secilin seksion nuk është rigorozë. Në raste të rralla, rendi alfabetik thyhet qëllimisht për të sjellë një vijueshmëri më logjike të fjalëve nga e njëjta familje (p.sh. një folje, emri foljor që rrjedh prej saj dhe mbiemri përkatës). Renditja e njësive bibliografike është kryer sipas radhës së citimit të tyre në tekst. Titujt dhe të dhënat e tjera të tyre i kemi shkruar siç paraqiten (fjalë për fjalë) në faqen e parë të librave përkatës, duke shmangur kështu çdo përgjegjësi tonën për gabime drejtshkrimore, logjike apo stilistike që mund të përmbajnë.

2 Problematika të përgjithshme drejtshkrimore

2.1 Gjuha dhe interneti

Komunikimi elektronik në internet përbën sot një realitet të padiskutueshëm dhe të pakthyeshëm që ka nisur njëzet apo tridhjetë vite më parë. Dy karakteristikat kryesore të këtij komunikimi janë shpejtësia dhe masiviteti. Shpejtësia ka të bëjë me mundësinë për të komunikuar në kohë reale apo të shkurtër, e madje pa kosto, me këdo në botë që ka qasje në internet. Masiviteti lidhet me mundësinë që informacioni i përcjellë në internet në formë librash, artikujsh, shkrimesh me përmbajtje informuese e faktike, lajmesh, imazhesh etj., mund të lexohet, përpunohet apo përdoret nga një masë shumë e madhe njerëzish, pra përsëri nga gjithkush në botë që ka qasje në internet. Objektet digjitale janë shtuar në internet eksponencialisht gjatë dy dekadave të fundit. Kjo prirje e pandalshme po na shpie deri në atë pikë saqë, në mënyrë të figurshme, do të thuhet që “nëse diçka nuk gjendet në internet, atëherë nuk ekziston”.

Digjitalizimi dhe lidhja në internet e veprimtarive shoqërore dhe e krejt informacionit që i shoqëron po ndikojnë edhe te gjuha e kultura e vendeve të ndryshme duke i bërë më të njohura. Duhet theksuar gjithsesi se jo tërë gjuhët e botës pasqyrohen në internet në masë të njëjtë apo në përpjestim të drejtë me numrin e popullsisë që e flet secilën prej tyre. Sipas statistikave, nëse merret për bazë numri i përdoruesve të internetit, rezulton që gjuha angleze udhëheq me 25,5% duke lënë ndjeshëm pas gjuhë si kinezçja dhe spanjishtja të cilat fliten nga më shumë banorë.¹⁾ I njëjti burim statistikor shfaq një epërsi të padiskutueshme të anglishtes, edhe nëse merret për bazë gjuha në të cilën figuron diçka e ngarkuar në internet. Në këtë rast, rezulton se 54% e objekteve në internet janë shkruar apo përshkruhen në gjuhën angleze dhe vetëm 6% në gjuhën ruse, që renditet e dyta.

Po theksohet gjithnjë e më shumë fakti që mbijetesa e gjuhëve dhe e kulturave do të varet nga shkalla e përhapjes së tyre në internet.²⁾ Në këtë pikë duhen pasur parasysh dy aspekte: sasia, pra shkalla e pasqyrimit të një gjuhe në internet, dhe cilësia, pra saktësia, pastërtia dhe veçori të tjera të gjuhës. Lidhur me aspektin sasior, gjuha shqipe deri më sot nuk është e përhapur kënaqshëm në internet. Sipas statistikave të fundit, në Wikipedia gjenden 83677 artikuj dhe 252837 faqe në gjuhën shqipe.³⁾ Ndërkohë, gjuha hungareze që flitet nga një popullatë afërsisht e njëjtë shfaqet në 491520 artikuj dhe 1404731 faqe. Ky çalim sasior i gjuhës shqipe në internet lidhet pa dyshim me shpejtësinë

¹⁾Për më shumë lexo: <https://www.babbel.com/en/magazine/internet-language>

²⁾Për më shumë lexo: https://en.wikipedia.org/wiki/Language_preservation

³⁾Për më shumë lexo: https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_Wikipedias

e përhapjes së internetit të shtëpitë apo zyrat e popullsisë shqipfolëse gjatë dekadave të fundit, pra, edhe me çështje të karakterit ekonomik, historik dhe shoqëror. Nevojitet një vëmendje më e madhe ndaj digjitalizimit dhe rrjetëzimit të veprimtarive të ndryshme shoqërore, veçanërisht ndaj atyre që lidhen me arsimin, kulturën dhe shkencën.

Aspektit cilësor të gjuhëve në internet po i kushtohet një vëmendje e veçantë vitet e fundit, duke qenë se komunikimi elektronik po ndikon edhe te vetë gjuhët. Ky ndikim përbën objektin e studimit të një disipline të re gjuhësore që njihet si gjuhësia e internetit (angl. *internet linguistics*), me përfaqësues kryesor gjuhëtarin e njohur britanik David Kristal (*David Crystal*). Sipas tij, gjuhët njerëzore gjatë dy dekadave të fundit po shkruhen në internet me një stil më pak akademik dhe më shumë shprehës [10]. Në lidhje me shqetësimet e ndryshme për rënien e cilësisë së gjuhës në internet, ai pohon se ato kanë baza dhe njihen në histori, duke iu referuar zhvillimit të shtypshkronjave në shekullin XV. Nisur nga vrojtimit tona, problemet e drejtshkrimit, shtrembërimet fonetike, mospërshtatja e fjalëve të huaja dhe çështje të tjera të shkrimit të shqipes në internet janë serioze dhe po shfaqen në mënyrë të frikshme e me pasoja të shumta. Problemet cilësore të shqipes në internet kanë qenë një nga shtysat kryesore për punën studimore që paraqitet në këtë libër dhe trajtohen në seksionet e kapitujt në vazhdim.

2.2 Përkthimet automatike

Zhvillimet në dekadat e fundit kanë sjellë përparim të vrullshëm në drejtime ndërdisiplinore si gjuhësia kompjuterike dhe përpunimi i gjuhëve natyrore, të cilat përdorin tekste të mbledhura nga librat ose interneti dhe koncepte e teknika të inteligjencës artificiale [11–13]. Një zbatim mjaft interesant është përkthimi i teksteve nga një gjuhë në një tjetër. Deri para dy dekadash, kjo detyrë u besojë plotësisht përkthyesve profesionistë. Gjithsesi, automatizimi i përkthimeve, pra mundësimi i përkthimeve automatike me saktësi e cilësi të pranueshme nëpërmjet metodave kompjuterike ka pasur gjithnjë interes të lartë.

Rol të madh në këtë drejtim kanë luajtur firmat e mëdha si Google (shqipto: `gu:gëll`) e Microsoft (shqipto: `majkrëso:ft`), ndër të tjera, të cilat zotërojnë kapacitete të larta përllogaritëse, sasi të mëdha të dhënash (në këtë rast çifte tekstesh dygjuhëshe) dhe burime njerëzore me kualifikim të lartë. Interesi i firmave të teknologjisë së informacionit për përsosjen e përkthimeve automatike lidhet me integrimin e tyre në platformat apo shërbimet që ato firma u ofrojnë përdoruesve në të gjithë botën, të cilët njohin e flasin gjuhë të ndryshme. Sistemi “Google Translate” (përkthe nga Google-i) është sot, pa dyshim, shërbimi më popullor i përkthimeve automatike dhe mundëson përkthime dydrejtimeshe midis

109 gjuhëve.⁴⁾ Cilësia e përkthimeve automatike është përmirësuar vazhdimisht duke iu afruar asaj të përkthyesve profesionistë.⁵⁾ Kjo ka bërë që sistemet e përkthimeve automatike të përdoren në masë, veçanërisht për shkak të lehtësisë dhe të shpejtësisë që ofrojnë. Cilësia e përkthimeve automatike mund të jetë e pranueshme për tekste të shkurtra nga një fjalë, deri te një a disa fjali, të cilat i përkasin ligjëritim teknik ose atij të përgjithshëm. Për tekste më të gjata si paragrafet e më tej, cilësia e përkthimit automatik bie ndjeshëm për shkak se shfaqen gabime logjike, fjalë jashtë kontekstit etj. Për më tepër, përkthimet automatike nuk janë të përshtatshme në rastet e përkthimeve letrare të mbushura me kuptime të figurshme.

Kompjuterizimi i mënyrës së punës, për shumicën e profesioneve, mundëson që gjithkush të ketë qasje të shërbimi “Google Translate” dhe ta përdorë lehtësisht edhe për përkthime të cilat kërkojnë përkushtim, seriozitet dhe profesionalizëm. Përdorimi në masë i sistemit “Google Translate” përbën shpesh papërgjegjshmëri dhe është një nga shkaqet kryesore të degradimit të cilësisë së gjuhës shqipe në hapësirën e internetit. Pasojat vihen re p.sh. te tekstet e faqeve në Wikipedia, të cilat shtohen (duke përkthyer faqet përkatëse nga anglishtja) dhe redaktohen nga vullnetarë. Këta të fundit, duke qenë relativisht të paktë përpiqen ta shpejtojnë punën e tyre me përkthime nga “Google Translate”. Në përgjithësi vihet re se prirja për “ekonomizim të kohës” po sjell përkthime të dobëta librash, artikujsh, lajmesh etj.

Problemet gjuhësore që shfaqen janë të llojeve të ndryshme. Më të dukshme dhe të rënda nga pikëpamja e përkthimit janë fjalët jashtë kontekstit, pra nxjerrja e një fjale shqipe për një fjale angleze, në një nga kuptimet e saj, që nuk ka lidhje me kontekstin ku ajo fjalë është përdorur. P.sh., shprehja *nitrogen properties* që duhet përkthyer vetitë e azotit ndeshet e përkthyer ~~pronat e azotit~~, çka është qesharake. Gabime të tilla po ndeshen vitet e fundit edhe në tekstet shkollore. Te [14] f. 99 lexojmë: “konkurrenca ndodh kur shumë ndryshime realizohen në të njëjtën kohë...”. Në këtë rast bëhet fjalë për konceptin e njëkohshmërisë (ose njëkohësisë) që i korrespondon fjalës angleze *concurrency*, e cila është përkthyer gabimisht ~~konkurrenea~~. Në faqen 44 të të njëjtit tekst lexojmë: “në Python trupi i shprehjes if tregohet nga dhëmbëzimi i tekstit”. Në këtë rast është fjala për *text indentation*, pra nxjerrja në kryeradhë e tekstit. Përkthimi i gabuar ~~dhëmbëzimi i tekstit~~ duket qartë që është kryer automatikisht nga “Google Translate”, sepse është përkthimi i parë që shfaqet te ndërfaqja e tij. Te [15] f. 207 shkruhet “...kur një sasi personal kompjuterash

⁴⁾Për më shumë hollësi lexo: https://en.wikipedia.org/wiki/Google_Translate

⁵⁾Teknikisht cilësia e përkthimeve automatike vlerësohet nga kombinimi i treguesve të ndryshëm të tekstit të krijuar si rrjedhshmëria, saktësia, mungesa e gabimeve drejtshkrimore, gabimeve sintaksore, gabimeve logjike etj.

përdoren në rrjet...”, pra ndeshet shprehja ~~personal-kompjuterash~~ e cila përbën një përkthim fjalë për fjalë dhe ndoshta të kopjuar drejtpërdrejt nga “Google Translate”. Forma e duhur do të ishte kompjuerash personalë. Një tjetër shembull i pamundësisë së shërbimit “Google Translate” në interpretimin e saktë të shprehjeve figurative vihet re te [15] f. 215 ku lexojmë “...mund të ngjasojë shumë me kërkimin e gjilpërës në stomakun e sanës”. Është e qartë që në këtë rast, shprehja e duhur në gjuhën shqipe do të ishte “...me kërkimin e gjilpërës në kashtë”. Shembuj të tillë tregojnë më së miri se përkthimet automatike nuk duhet të përdoren në asnjë rast, kur është fjala për hartimin e teksteve shkollore.

Përkthimet automatike sjellin në mënyrë të pashmangshme edhe gabime gramatikore, që megjithëse jo dhe aq trashanike, ngelen probleme serioze. Ndër to mund të përmendim ngatërrime të rasës, numrit apo trajtës së emrave, kohës apo vetës së foljeve, lakimit të mbiemrave etj. Duhet thënë gjithsesi se gabimet gramatikore po ndeshen rrallë vitet e fundit. Pavarësisht kësaj, një kategori gabimesh duket se do të jenë të pashmangshme edhe për shumë vjet. Është fjala për ato që lidhen me figurshmërinë, më së shumti në përkthimet letrare. Sistemet e përkthimit automatik e kanë të pamundur të interpretojnë saktë shprehjet e figurshme dhe japin përkthime të drejtpërdrejta që janë cilësisht të dobëta. Përkthyesit profesionistë ngelen të pazëvendësueshëm në këtë pikë.

2.3 Shkronjat ë dhe ç

Një problem tjetër i hershëm, por që po ndeshet gjithnjë e më shpesh në ditët e sotme është shmangia e shkronjave Ë, ë, Ç dhe ç duke shkruar në vend të tyre shkronjat E, e, C dhe c. Në rastin e shkronjës ë janë të shpeshta edhe format e gabuara pa ë dhe pa e në vend të saj. Kjo përbën dukurinë e ngrënies së ë-ve fundore. Po bëhen, pra, të zakonshme fjalët e shkruara si më poshtë:

~~mir~~, ~~mire~~ (mirë); ~~esht~~, ~~eshte~~ (është); ~~shum~~, ~~shume~~ (shumë); ~~un~~, ~~une~~ (unë); ~~uj~~, ~~uje~~ (ujë); ~~buk~~, ~~buke~~ (bukë); ~~vrin~~, ~~vrime~~ (vrinë); ~~rrug~~, ~~rruge~~ (rrugë); ~~muzik~~, ~~muzike~~ (muzikë) dhe sa e sa të tjera.

Në rastin e shkronjës ç janë më të shpeshta fjalët me ç nistore e cila shkruhet c, pra ndeshim fjalët e shkruara si më poshtë:

~~ekemi~~, ~~e'kemi~~ (ç'kemi); ~~efare~~ (çfarë); ~~e'do~~ (ç'do); ~~edo~~ (çdo); ~~ej~~ (çaj); ~~eoj~~ (çoj); ~~emim~~ (çmim); ~~eift~~ (çift) dhe sa e sa të tjera.

Pasojat negative të këtij problemi janë të shumta dhe serioze. Format e gabuara (me e dhe c në vend të ë-së dhe ç-së) të fjalëve shfaqen si fjalë më vete. Kjo rrezikon seriozisht ruajtjen e saktësisë së gjuhës dhe të shkruarit korrekt të saj nga të rinjtë që janë përdoruesit kryesorë të internetit. Për më

tepër, hulumtuesit (si shqipfolës, edhe të huaj) që kryejnë studime me metoda kompjuterike bazohen pikësisht te tekstet që gjenden në internet, të cilat mbledhen lehtësisht. Papastërtia e tyre çon patjetër në rezultate të anuara apo plotësisht të gabuara.

Një nga shkaqet e masivizimit të këtij problemi është sigurisht mungesa e këtyre simboleve të veçanta⁶⁾ në tastierat US ISO (tastiera amerikane e standardit ndërkombëtar) të cilat janë më të përdorurat sot. Përdoruesit e kompjuterit, që shkruajnë shpesh në gjuhën angleze, e kanë më lehtë të përdorin tastierën US ISO. Kjo bën që të tregohen indiferentë ndaj shkronjave Ë, ë, Ç dhe ç, duke i shkruar për lehtësi E, e, C dhe c. Ky qëndrim nuk duhet kursesi të justifikohet. Katër simbolet e veçanta të shqipes janë shumë pak krahasuar me sa e sa simbole të tilla në gjuhë të tjera, të cilat shkruhen gjithsesi shumë saktë në internet. Mund të përmendim këtu simbolet me theks majtas, me theks djathtas dhe me theks rrethues në frëngjishte, simboli ß dhe simbolet me dy pika (ä, ü, dhe ö) në gjermanishte, simbolet e veçanta të gjuhëve sllave etj.

Zgjidhjet për këtë problem janë të ndryshme. Përdoruesit apo radhësit që shkruajnë më shpesh në gjuhën angleze mund të përdorin tastierën amerikane dhe të ndjekin disa marifete për shkrimet në gjuhën shqipe. Mënyra më e thjeshtë është që simbolet e veçanta të shqipes të shkruhen me anë të kodeve të tyre të kombinuara me tastin **Alt**. Duke supozuar se po përdorim një sistem Windows (shqipto: uindëus) të firmës Microsoft, janë të mundshme kombinimet e mëposhtme:

Alt + 0203 jep Ë; **Alt** + 137 jep ë; **Alt** + 128 jep Ç; **Alt** + 135 jep ç

Në çdo rast të tillë mbahet shtypur tasti **Alt** dhe më pas shtypen njëri pas tjetrit nga blloku numerik i tastierës tastet e numrave që formojnë kodin përkatës. Kjo praktikë mund të përdoret për simbolet Ë, Ç dhe ndoshta edhe ç, që nuk janë shumë të shpeshta. Në rastin e shkronjës ë, e cila është më e shpeshta në gjuhën shqipe, shtypja e kombinimit **Alt** + 137 sa herë që ajo ndeshet nuk është e volitshme. Një zgjidhje që ndiqet shpesh nga gazetarët në shkrime lajmesh është përdorimi i shkronjës *w* (shtypet me gishtin e unazës së dorës së majtë) në vend të shkronjës ë dhe zëvendësimi automatik i të gjitha rastisjeve në fund të shkrimit. Kjo praktikë nuk sugjerohet të ndiqet për arsye se edhe në shkrimet shqip mund të rastisë të përdoren fjalë të gjuhës angleze me shkronjën *w*. Në këto rast, shkronja *w* duhet të ruhet, por në fakt zëvendësohet automatikisht nga shkronja ë, çka shkakton gabime.

Një tjetër marifet i lehtë, por që nuk shkakton asnjë gabim, është përdorimi

⁶⁾Në kuptimin që nuk përfshihen te simbolet bazë të kodit ASCII (*American Standard Code for Information Interchange*, kodi standard amerikan për shkëmbim informacioni)

i dy simboleve ; (pikëpresje) të njëpasnjëshme, pra shkrimi i ;; në vend të ë. Tasti ; shtypet lehtë dhe shpejt me gishtin e vogël të dorës së djathtë. Dy pikëpresje të njëpasnjëshme nuk përdoren në ndonjë rast tjetër e as përbëjnë ndonjë simbolikë në ekuacione e formula shkencore, pra nuk krijojnë konflikt në asnjë rast. Zëvendësimi i ;; me ë mund të kryhet në fund të shkrimit. Shumica e programeve për shkrim/redaktim teksti (p.sh. Notepad++) ofrojnë mundësi për automatizimin e veprimeve të tilla nëpërmjet shkurtoreve të sajara nga përdoruesi, të cilat përcaktohen te konfigurimi i programit. Është e mundur p.sh. që për të zëvendësuar ;; me ë të përdorim shkurtoren **Ctrl** + ; në çdo çast që dëshirojmë. Kjo e lehtëson dhe shpejton mjaft punën e radhitësit.

Për përdoruesit apo radhitësit profesionistë, që shkruajnë më së shumti në gjuhën shqipe, do të ishte më e përshtatshme që të shkruhej me tastierën e shqipes në vend të tastierës amerikane. Tastiera e shqipes përfshin pak devijime nga ajo amerikane, pra shkathtësimi në punën me të arrihet në pak kohë. Dallimet më të dukshme janë zëvendësimi i simbolit [me ë dhe i] me ç.⁷⁾

2.4 Emrat e përveçëm

Në përputhje me parimin e dokumentit të Kongresit të Drejtshkrimit të Shqipes [16], kapitulli III, § 37, shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Në shfaqjen e parë të një emri të kësaj kategorie mund të shënohet në kllapa edhe shkrimi i tij sipas grafisë së gjuhës nga buron. Pra, i shkruajmë emrat e njerëzve si më poshtë:

Ernest Heminguej (*Ernest Hemingway*), Teodor Drajzer (*Theodore Dreiser*), Xhorxh Oruell (*George Orwell*), Uiliam Shekspir (*William Shakespeare*), Stiv Xhobs (*Steve Jobs*), Mak Mek-Donald (*Mac McDonald*), Shon Konëri (*Sean Connery*), Tomas Man (*Thomas Mann*), Leonard Oiler (*Leonhard Euler*), Blez Paskal (*Blaise Pascal*) etj.

Pas shfaqjes së parë, që shoqërohet me sqarimin në kllapa të shkrimit të emrit në gjuhën burimore, shfaqjet e tjera shkruhen si më sipër po pa sqarime të mëtejshme në kllapa. Shkruajmë në të njëjtën mënyrë emra vendesh si:

Nju-Jork (*New York*), Uashington (*Washington*), Mynhen (*München*), Cyrih (*Zürich*), Mançester (*Manchester*) etj.

Përshtatja grafike e këtyre emrave bën që ata të lakohen njësoj si emrat e përveçëm të shqipes, pra me mbaresa të trupëzuara dhe pa përdorur shenjën e

⁷⁾Kriteret e ndjekura për ndërtimin e tastierës shqipe dhe hollësi të tjera rreth saj gjenden te: <https://gjuhashqipe.com/softueret/tastiera>

vizës (-) për ndarjen e mbaresës nga rrënja e emrit. Pra shkruajmë:

ardhja e Xhorxh Bushit, foli Uashingtoni zyrtar, skuadra e Mançesterit, lexoj Uiliam Shekspirin, roman nga Teodor Drajzeri, shpikje e Blez Paskalit, qyteti i Mynhenit, aeroporti i Cyrihut etj.

Duhet theksuar gjithsesi se ndodh shpesh që rregulli i mësipërm të shmanget, veçanërisht në kopertinat e përkthimeve të librave të huaj artistikë, ku emrat e autorëve shkruhen si në paraqitjen e tyre në gjuhën e huaj dhe jo të përshtatura sipas alfabetit të shqipes. Lexojmë pra shpesh në kopertina të librave emra autorësh si *George Orwell* në vend të Xhorxh Oruell, *Ernest Hemingway* në vend të Ernest Heminguej, *Thomas Mann* në vend të Tomas Man etj.

Ndërkohë, emrat e përveçëm të firmave dhe markave të njohura ndërkom-bëtarisht paraqesin vështirësi e probleme edhe më të mëdha. Emra të tillë ndeshen shpesh në ligjëratën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, ku firmat e mëdha ndërkombëtare njihen për markat e tyre të kompjuterave, telefonave të mençur, sistemeve operative, programeve të ndryshme etj. Emrat e kësaj kategorie njihen ndryshe si emra të regjistruar apo të rezervuar dhe në shumicën e rasteve përfshijnë vetëm një fjalë. Nëse do t'i qëndronim rregullit të mësipërm, do të shkruanim:

Fejsbuk, Gugëll, Wërd, Instëgram, Epëll, Juniks, Soni, Paithën, Ma-jkrosoft, Xhava, Uindous, Xhavaskript, Sisko, Samsung Galaksi, Paskal (gjuha e programimit), aifëun, Zimens etj.

Në këtë mënyrë, lakimi i këtyre emrave do të bëhej njësoj si në rastet e emrave të njerëzve, pra me mbaresë të trupëzuar. Një mundësi tjetër do të ishte përjashtimi i këtyre kategorive të emrave të përveçëm nga rregulli i mësipërm dhe të shkruarit e tyre si në gjuhët e origjinës. Në një rast të tillë do të shkruanim:

Facebook, Google, Word, Instagram, Apple, Unix, Sony, Python, Mi-crosoft, Java, Windows, Javascript, Cisco, Samsung Galaxy, Pascal (gjuha e programimit), iPhone, Siemens etj.

Në shfaqjen e parë të një emri të tillë mund të shënohet në kllapa transkrip-timi i shqiptimit të tij në gjuhën shqipe, duke ndihmuar kështu lexuesin që nuk e njeh gjuhën e huaj të origjinës së atij emri dhe nuk është mësuar me fonetikën e saj. Mund të shkruajmë p.sh. Unix (shqipto: juniks), Facebook (shqipto: fejsbuk), Google (shqipto: gugëll) etj. dhe në shfaqjet e tjera të shkruhet vetëm emri siç paraqitet në gjuhën burimore, pra Unix, Facebook, Google, etj.

Nëse i referohemi bibliografisë, mund të vëmë re se në këtë pikë ka kontradikta, pra autorët ndjekin herë rregullin e parë dhe herë të dytin brenda të njëjtit

libër apo shkrim. Ndodh madje shpesh që i njëjti emër i përveçëm të shkruhet në forma të ndryshme brenda së njëjtës faqe të një libri. Kjo gjë vihet re p.sh. tek [17] f. 27. Në këtë rast, emri i programit Microsoft Excel shkruhet Excel, si në gjuhën burimore, por edhe Eksel, pra i përafuar me shqiptimin në gjuhën shqipe. Vihet re gjithsesi se shkrimi si në gjuhën burimore ndeshet më shpesh, por fatkeqësisht pa e sqaruar shqiptimin në kllapa. Ndeshet madje edhe praktika e shkrimit të këtyre emrave si në gjuhën burimore, por duke i përfshirë brenda thonjzave. Kjo vihet re te [18] ku lexojmë:

“Google”, “Amazon”, “AlexNet”, “IBM”, “iPhone”, “Microsoft”, “DeepBlue”, “OpenAI”, “Baidu”, “Facebook”, “GPT-3”, “Reddit”, “Apple”, “DeepMind”, “Samsung”, “YouTube”, “Siri”, “Oxbotica”, “Face++” etj.

Këtu gjykojmë se kemi të bëjmë me një përdorim të tepruar të thonjzave, çka krijon vështirësi praktike. Për mendimin tonë, shkrimi i kësaj kategorie emrash si në gjuhën e tyre burimore dhe jo midis thonjzave është mënyra më e përshtatshme, për disa arsye. Së pari, në shumicën e gjuhëve ndiqet ky rregull, pra emrat e firmave dhe markave të njohura ndërkombëtarisht shkruhen siç paraqiten në gjuhën e tyre burimore. Në kategorinë e gjuhëve që ndjekin këtë rregull ka madje edhe gjuhë me natyrë fonetike, pra si gjuha shqipe. Së dyti, emrat e kësaj kategorie njihen në mbarë botën siç paraqiten në gjuhën burimore. Modifikimi i formës origjinale të tyre krijon hutim të lexuesit dhe keqkuptime të shumta. Së treti, nuk ka gjithnjë pajtueshmëri për përshtatjen në gjuhën shqipe të shqiptimit të këtyre emrave. P.sh., emri i kompanisë amerikane Facebook në disa raste shqiptohet *fej*sbuk dhe në disa të tjera *feis*buk. Vështirësi të tilla ndeshen edhe me emra njerëzish si shkrimtari *James Joyce*, emri i të cilit ndeshet Xhejms Xhois por edhe Xhejms Xhojs. Së katërti, përshtatja në gjuhën shqipe e çdo emri të huaj të përveçëm krijon vështirësi të shumta dhe nuk është praktike. Së fundmi, futja në thonjëza e emërtimeve prej një fjale të vetme, nuk është e domosdoshme (në dallim nga emërtimet prej disa fjalësh), nuk është praktike dhe krijon ngarkesë grafike të kotë. Kjo çështje mbetet e hapur dhe nevojiten diskutime të shumta midis gjuhëtarëve dhe institucioneve përkatëse, për një normë të qartë e përfundimtare.

Në rastet kur emrat e huaj të përveçëm shkruhen si në gjuhën burimore, lakimi paraqitet disi më i ndërlikuar. Lind nevoja e përdorimit të vizës për ndarjen e rrënjës së huaj nga mbaresa e shqipes. Na duhet, pra, të shkruajmë në raste të ndryshme:

llogari Facebook-u, mbylla Facebook-un, përdorues i Facebook-ut, llogaria e Google-it, mbyll Word-in, kompjuter nga Apple-i, telefon i Apple-it, administrator i Unix-it, mbështetje nga Microsoft-i, sistem i Microsoft-

it, komandë Windows-i, përdorues i Windows-it, kod Python-i, klient i Samsung-ut, mësoj Javascript-in, rrjet i Cisco-s, përdorues i Instagram-it, shërbim nga Google-i, çmimi i iPhone-it, udhëzuesi i Java-s etj.

Ky rregull ndiqet deri diku në bibliografi, por përsëri vihet re mungesë koherence jo vetëm midis teksteve të ndryshme, por edhe brenda të njëjtit tekst. Ndër të paktat tekste ku ka koherencë në këtë pikë mund të përmendim [19] dhe [20], tek të cilat emrat e huaj lakohen gjithnjë me vizë. Në tekstet e tjera, lakimi me vizë nuk është sistematik.

2.5 Drejtshkrimi i shkurtesave

Shkurtesat (angl. *acronyms*) paraqesin gjithashtu probleme të shumta. Shkurtesat e ligjërimiave juridike, politike apo ekonomike ndodh shpesh që të përdoren të përkthyer. Disa shembuj tipikë janë:

USA (*United States of America*) – SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), UNO (*United Nations Organization*) – OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara), IMF (*International Monetary Fund*) – FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar), WB (*World Bank*) – BB (Banka Botërore) etj.

Në përputhje me shembujt që jepen te dokumenti i drejtshkrimit të shqipes (te [16], kapitulli VI, § 84), duhet pasur parasysh që shkronjat e shqipes që përbëhen nga dy simbole si Dh, Gj, Ll, Nj, Rr, Sh, Th etj. shkruhen me të dyja simbolet e mëdha kur janë pjesë e shkurtesave, kjo më shumë për arsye estetike sesa gjuhësore. Pra siç u ilustrua dhe më sipër, shkruajmë SHBA dhe jo ShBA siç ndeshet te [18] f. 97, SQBDH (Sistem i Qeverisjes së Bazës së të Dhënave) dhe jo SQBDh si te [21] f. 82 etj. Shkurtesat nga teknologjia e informacionit dhe e komunikimit nuk para përkthehen, pra njihen e përdoren botërisht në formën e tyre origjinale, në ngjashmëri me emrat e markave e të firmave ndërkombëtare. Ndër to mund të përmendim shembuj të mirënjohur si:

CPU (*Central Processing Unit*, njësia qendrore përpunuese), IP (*Internet Protokoll*, protokoll i internetit), RAM (*Random Access Memory*, kujtesë me kapje rastësore), VPN (*Virtual Private Network*, rrjet privat virtual), DNS (*Domain Name System*, sistemi i emrit të domenit) etj.

Shkurtesat e huaja të kësaj kategorie duhen shkruar siç paraqiten në gjuhën burimore, por është e rëndësishme që në përdorimin e parë të jepet në kllapa edhe paraqitja e gjatë dhe përkthimi në gjuhën shqipe, pra të shkruhen njësoj si në shembujt më sipër. Pas përdorimit të parë mund të jepet vetëm shkurtesa, pa sqarime të mëtejshme. Duhet theksuar gjithashtu se në paraqitjet e mësipërme me sqarime në kllapa, shkruhen si shkronja të mëdha vetëm nistoret e paraqitjes

së plotë në gjuhën e huaj dhe jo nistoret e përkthimit në gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, sqarimi i plotë i shkurtesave të shqipes mund të jepet në kllapa me nistore të shkruara si shkronja të mëdha. Pra, mund të shkruajmë:

PTT (Postë Telegram Telefon), ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare), VKM (Vendim i Këshillit të Ministrave), RTSH (Radio Televizioni Shqiptar), FSHN (Fakulteti i Shkencave Natyrore) etj.

Problemi që vihet re më shpesh në shkrimin e shkurtesave është moslakimi i tyre. Ky problem ndeshet te të gjitha shkurtesat, si ato të huaja edhe ato shqipe. Shembujt e gabimeve të tilla në bibliografi janë të shumtë, ndaj nuk po ndalemi në raste specifike. Njësoj si për emrat e përveçëm, edhe te paraqitja e lakuar e shkurtesave duhet përdorur simboli i vizës për të ndarë shkurtesën nga mbaresa e lakimit. Duhet, pra, të shkruajmë:

CPU-ja e sistemit, ndryshoj CPU-në, frekuenca e CPU-së, fuqia e kësaj CPU-je, punëtorët e PTT-së, linjë nga PTT-ja, sasia e RAM-it, shtoj RAM-in, burim i ATSH-së, shkoj te ATSH-ja, IP-ja e kompjuterit, vendos IP-në, gjatësia e IP-së, ndjek RTSH-në, njoftim i RTSH-së, lidhje VPN-je, VPN-ja e sistemit, konfiguruj VPN-në etj.

2.6 Mënyra e disa foljeve

Në punën me sistemet informatike ndeshen shpesh komanda që i mundësojnë përdoruesit të kryejë veprime nëpërmjet shtypjes apo aktivizimit të tyre. Fjalët përkatëse për veprimet janë folje të cilat përfaqësojnë urdhra, që përdoruesi ia jep sistemit për të kryer veprimin e dëshiruar. Këto folje hasen në forma të ndryshme, por, duke qenë urdhra, gjykojmë që duhen shkruar në mënyrën urdhërore, numri njëjës. Duhet shmangur, pra, të shkruarit e tyre si emra apo si folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore. Në seksionet më poshtë jepen disa shembuj tipikë.

2.6.1 Veprime të përgjithshme

Një pjesë e madhe e veprimeve dhe e komandave që përdoruesi kryen duke ndërvepruar me sistemet informatike janë të përgjithshme. Ato paraqiten me të njëjtat emërtime në sisteme nga më të ndryshmet, si në kompjuterat e zakonshëm edhe në mjedise specifike të përpunimit të informacionit. Te kjo kategori përfshihen folje si:

autofilter që gjendet si komandë dhe veprim në disa programe të analizës së të dhënave dhe përdoret për të përzgjedhur një pjesë të rreshtave sipas ndonjë

kriteri të caktuar. Në rastet kur paraqet komandën në ndërfaqen grafike të atyre programeve, kjo fjalë duhet shkruar **vetëfiltro** dhe jo ~~vetëfilitroj~~ apo ~~vetëfiltrim~~.

close që përdoret thuhet në çdo program kompjuterik apo në sisteme të tjera kontrolli e komandimi për të mbyllur një dritare grafike ose ndonjë element tjetër. Duke qenë komandë, kjo fjalë duhet përkthyer **mbyll** dhe jo ~~mbyllje~~.

copy që është me shumë gjasë komanda me përdorim më të shpeshtë në çdo pajisje, sistem apo program kompjuterik. Edhe kjo folje duhet shkruar në mënyrën urdhërore, pra **kopjo** dhe jo ~~kopjoj~~, ~~kopjim~~ etj.

cut që është gjithashtu komandë me përdorim shumë të shpeshtë e cila pret një pjesë teksti nga një dokument, një skedar apo grup skedarësh nga një direktori apo në përgjithësi një njësi nga një strukturë mbajtëse, për ta vendosur më pas diku tjetër. Kjo fjalë duhet përkthyer **pre** dhe jo ~~pres~~, ~~prerje~~ etj.

delete që është jo vetëm komandë mjaft e përdorur, por edhe një tast në tastierë. Përdoret për të fshirë një pjesë teksti apo ndonjë objekt të përzgjedhur. Kur përfaqëson komandën e një sistemi, kjo fjalë duhet përkthyer **fshi**, **shuaj** dhe jo ~~fshij~~, ~~fshirje~~, ~~shuarje~~.

edit që gjendet gjithashtu në çdo program grafik, i mundëson përdoruesit të kryejë redaktime të dokumenteve, imazheve, videove apo njësisive të ndryshme të informacionit. Kjo folje ndeshet shpesh e papërkthyer, pra në formën ~~editoj~~ ose ~~editim~~. Përkthimi i saktë në kontekstet ku paraqitet si komandë duhet shkruar në mënyrën urdhërore, pra **redakto** dhe jo ~~redaktoj~~ apo ~~redaktim~~.

filter që është gjithashtu komandë e zakonshme në programet që punojnë me rreshta të dhënash. Me anë të saj, përdoruesit kanë mundësi të filtrojnë disa rreshta me të dhëna që plotësojnë një apo disa kushte. Përkthimi i saj kur shfaqet si komandë duhet të shkruhet **filtro** dhe jo ~~filtroj~~ apo ~~filtrim~~.

hide është komandë që ndeshet në shumë programe grafike dhe i jep mundësi përdoruesit të fshehë nga dritarja elemente të ndryshme sipas dëshirës. Përkthimi i duhur i saj si komandë e disponueshme në programet grafike duhet të jetë **fshih** dhe jo ~~fsheh~~ apo ~~fshehje~~.

open që është gjithashtu një komandë shumë e zakonshme në programet që punojnë me skedarët dhe në shumicën e rasteve shërben për të hapur një skedar. Përkthimi i saj në rastet kur shfaqet si komandë duhet të jetë **hap** dhe jo ~~hapje~~.

paste që është komanda e ngjitjes së një pjese, skedari apo njësie tjetër informacioni, e cila më parë është kopjuar me komandën **copy** (kopjo) apo është prerë me komandën **cut** (pre). Përkthimi i saktë i saj është **ngjit** dhe jo ~~ngjitje~~.

preview që shfaqet si komandë e lidhur me komandën e shtypjes për t'i treguar përdoruesit një pamje paraprake të dokumentit siç do të dalë në shtyp. Në këtë kontekst, kjo folje duhet përkthyer **parashfaq** dhe jo ~~parashfaqje~~.

print që është komanda e shtypjes së dokumenteve në letër ose e afishimit të mesazheve të ndryshme nëpër terminale. Në këto raste përdorimi, kjo folje duhet të përkthehet **shtyp** ose **afisho**, dhe jo *shtypje* apo *afishim*.

remove që është mjaft e përdorur, deri diku e ngjashme me *delete*. Kur përfaqëson komandën e një sistemi duhet përkthyer **hiq**, **fshi** dhe jo *heq*, *fshij*.

run që ndeshet në butona të programeve për të nisur ekzekutimin e programit. Në këtë kontekst, kjo folje duhet përkthyer **ekzekuto** dhe jo *ekzekutoj*.

pause që gjendet bashkë me komandën *resume* (rinis) dhe përdoret për të ndalur përkohësisht një proces që zakonisht kërkon njëfarë kohe. Përkthimi i duhur i saj është **pezullo** dhe jo *pezulloj*.

resume që përdoret për të rinisur një proces të pezulluar më parë nga komanda *pause* (pezullo). Përkthimi i duhur i saj është **rinis** dhe jo *rinisje*.

stop që përdoret për të ndalur përfundimisht një aktivitet apo proces, pra pa pasur mundësi për ta rinisur. Përkthimi i duhur i saj është **ndal** dhe jo *ndaloj*, *ndalim* apo *ndalje*.

save që është një komandë e pranishme në çdo pajisje, sistem apo softuer dhe shërben për të ruajtur dokumente, skedarë ose gjendjen e sistemit apo të të dhënave të lidhura me të në një kohë të caktuar. Përkthimi i duhur i kësaj komande është **ruaj** dhe jo *ruajtje*.

view që gjendet gjithashtu në çdo program me ndërfaqe grafike dhe i mundëson përdoruesit të shohë dhe të ndryshojë elementet grafike që shfaqen në ndërfaqen e programit. Përkthimi i kësaj komande duhet të jetë **shih** dhe jo *shoh* apo *shikoj*.

2.6.2 Veprime në postën elektronike

Posta elektronike është një nga shërbimet e para të digjitalizuara dhe me një përdorim masiv në të gjithë botën. Në kontekstin e programeve të postës elektronike, përdoruesit kryejnë shpesh veprime me komanda të ndryshme për të shkruar e dërguar mesazhe, për të parë e organizuar mesazhet etj. Në këtë kategori përfshihen folje si:

archive që është komanda për të arkivuar mesazhe të ndryshme të postës. Në këtë kontekst përkthehet **arkivo** dhe jo *arkivoj* apo *arkivim*.

forward që përdoret kur përdoruesi ka marrë një mesazh nga dikush dhe dëshiron t'ia dërgojë atë dikujt tjetër. Nëse i referohemi bibliografisë, për këtë folje gjejmë përkthime si *eeje përpara* tek [21] f. 175 apo *përparo* tek [22] f. 112, tek [23] f. 153, tek [15] f. 219 etj. Për mendimin tonë, përkthimi më i përshtatshëm në paraqitjen si komandë (pra në mënyrën urdhërore) është **përcill**.

mark as read që është një veprim që kryhet nga përdoruesi për ta shënuar një mesazh si të lexuar (çdo mesazh i ri shfaqet i theksuar për t'u dalluar nga mesazhet që janë lexuar më parë), edhe pse mund të mos ta ketë lexuar ende. Përkthimi i duhur i kësaj shprehjeje është **shëno si të lexuar**.

mark as unread që është veprimi i kundërt, pra shënon një mesazh të lexuar si të palexuar (p.sh. nëse përdoruesi dëshiron të kujtohet që ta lexojë përsëri më vonë). Përkthimi i duhur i kësaj shprehjeje është **shëno si të palexuar**.

resend që është veprimi dhe komanda që në disa raste ridërgon një mesazh që mund të mos jetë dërguar me sukses herën e parë. Në këtë kontekst, kjo komandë duhet përkthyer **ridërgo** dhe jo *ridërgoj* apo *ridërgim*.

send që është veprimi dhe komanda kryesore e cila aktivizohet nga përdoruesi për të dërguar një mesazh të shkruar. Përkthimi i duhur i kësaj komande në këtë kontekst duhet të jetë **dërgo** dhe jo *dërgoj* apo *dërgim*.

reply që është komandë e cila aktivizohet sa herë që përdoruesi, pasi lexon një mesazh, dëshiron t'i kthejë dërguesit përgjigje. Përkthimi i duhur i kësaj foljeje në këtë kontekst duhet të jetë **përgjigju** dhe jo *përgjigjem* apo *përgjigje*.

unsubscribe që është komanda e kundërt e *send*, pra i jep mundësinë përdoruesit (zakonisht brenda një intervali të shkurtër kohor) të prapësojë dërgimin e një mesazhi. Shkrimi i duhur duhet të jetë **zhdërgo** dhe jo *zhdërgoj* apo *zhdërgim*.

2.6.3 Veprime në internet

Në kontekstin e lundrimit në internet hasen vështirësi me shumë fjalë që mundësojnë ndërveprimin e përdoruesit me faqet që viziton. Shumë prej këtyre fjalëve përfaqësojnë komanda të shprehura me folje, të cilat duhet të shkruhen në mënyrën urdhërore. Disa të tjera janë komanda me të cilat përdoruesit e rrjeteve shoqërore ndërveprojnë mes tyre. Disa shembuj janë:

comment që si folje tregon veprimin e shkrimit të një komenti për të dhënë një mendim ndaj një mesazhi, fotografie apo në përgjithësi ndaj një postimi. Në këtë kontekst duhet përkthyer **komento** dhe jo *komentoj*.

download që përbën një nga komandat më të zakonshme të përdoruesve të internetit. Në rastin e përgjithshëm, kjo folje duhet përkthyer **shkarkoj**, dhe jo *transferoj* siç ndeshet tek [24] f. 10. Në rastet kur paraqitet si komandë, duhet të shkruhet në mënyrën urdhërore, pra **shkarko** dhe jo *shkarkoj* apo *shkarkim*.

follow që është veprimi i aktivizuar nga përdoruesi sa herë që dëshiron të ndjekë një profil për t'u lajmëruar rreth postimeve të reja në të. Përkthimi i duhur i foljes në këtë kontekst është **ndiq** dhe jo *ndjek*.

like që kryhet miliona herë në rrjetet virtuale me shumë përdorues, kur ata

pëlqejnë një postim. Në atë kontekst duhet përkthyer **pëlqe** dhe jo **pëlqej**.

log in dhe **sign in** janë gjithashtu shumë të zakonshme në faqet e portaleve apo shërbimeve ku përdoruesit kanë një llogari tek e cila hyjnë. Ndeshen shpesh pa përkthim, si p.sh. tek [25] f. 76 ku lexojmë **logohuni**. Përkthimi më i thjeshtë dhe i qartë është **hyr**, **hyni** dhe jo **kyçu**, **kyçuni**, që, megjithëse mbart idenë e hyrjes me një fjalëkalim, shkakton njëfarë hutimi te lexuesi apo përdoruesi.

log out dhe **sign out**, njësoj si më sipër, përfaqësojnë komandën që përdoruesi jep për të dalë nga llogaria e vet. Ndonjëherë ndeshim prurje qesharake si p.sh. **ç'logimi** tek [22] f. 108. Njësoj si për rastin më sipër, përkthimi më i përshtatshëm është **dil** dhe jo **shkyçu**, fjalë e cila nuk është shumë e qartë.

refresh që është komandë e cila përdoret shpesh nga operatorët për të rifreskuar faqet ueb që janë duke lexuar. Kjo folje duhet përkthyer **rifresko** siç shkruhet saktësisht te [22] f. 107 dhe jo **rifreskoj** apo **rifreskim**.

reload që është shumë e ngjashme me **refresh** dhe përdoret për të përditësuar një faqe ueb. Në këtë kontekst, pra kur paraqitet si një komandë te programi shfletues, përkthimi i duhur i saj është **ringarko** dhe jo **ringarkoj** apo **ringarkim**.

report që përdoret nga përdoruesi për të raportuar një problem apo një shkelje të rregullave. Në këtë kontekst duhet shkruar **raporto** dhe jo **raportoj**.

share ndeshet shpesh në faqet e rrjeteve shoqërore virtuale në të cilat përdoruesit postojnë mesazhe, fotografi, video etj. Kjo fjalë lidhet me veprimin e shpërndarjes së postimeve nga përdoruesit, si te profilet e tyre apo edhe duke ua dërguar personave të tjerë. Përkthimi i duhur në këtë kontekst është **shpërnda** (në rastin e përgjithshëm **shpërndaq**) dhe jo **nda** që mund të paraqesi paqartësi.

submit që paraqitet shpesh në butona dhe përdoret për të konfirmuar dorëzimin e një formulari të plotësuar apo të një dokumenti të bashkëngjitur, ose për të miratuar ndonjë veprim tjetër. Përkthimi i duhur në këto raste është **dorëzo**, **mirato** dhe jo **dorëzoj**, **miratoj**, **dorëzim** apo **miratim**.

subscribe që është një komandë të cilën përdoruesi e aktivizon kur kërkon të lajmërohet për postime të reja nga një faqe ueb apo kanal a profil. Përkthimi i duhur në këtë kontekst është **pajtohu**, **abonohu** dhe jo **pajtohem**, **abonohem**.

unfollow që është veprimi i kundërt i **follow**. Përkthimi i duhur i foljes përkatëse është **çndiq** dhe jo **çndjek**.

unlike që përfaqëson veprimin e kundërt të **like**. Kur paraqitet si komandë, kjo folje duhet përkthyer **shpëlqe** dhe jo **shpëlqej**.

unsubscribe që është veprimi i kundërt i foljes **subscribe**. Përkthimi i duhur si komandë është **shpajtohu**, **çabonohu** dhe jo **shpajtohem**, **çabonohem**.

upload që është komanda e cila kryen veprimin e kundërt të shkarkimit, pra ngarkon objekte digjitale në hapësirën e uebit. Në rastin e përgjithshëm, përkthimi i kësaj fjale është ngarkoj, ngarkim siç ndeshet tek [26] f. 8 dhe jo transferoj, transferim si tek [19] f. 34. Në rastet kur figuron si komandë të programi shfletues apo diku tjetër, forma e duhur e foljes është zgjedhimi i saj në mënyrën urdhërore, pra **ngarko** dhe jo ngarkoj apo ngarkim.

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se shkrimi në mënyrën urdhërore i foljeve të mësipërme duhet të kryhet vetëm kur ato paraqiten si komanda në terminalin apo grafikën e sistemeve dhe programeve kompjuterike. Në çdo përdorim tjetër duhet të zgjedhohen sipas rastit, zakonisht në një nga kohët e mënyrës dëftore.

2.7 Presja dhjetore

Vihen re gjithashtu probleme të shpeshta me të shkruarit e numrave dhjetorë. Në gjuhën shqipe këta numra njihen ndryshe si numrat me presje ose numrat me presje dhjetore. Disa shembuj numrash të tillë janë:

3,14 (tre presje katërmbëdhjetë), 0,606 (zero presje gjashtëqind e gjashtë), 120.000,75 (njëqind e njëzet mijë presje shtatëdhjetë e pesë).

Përdorimi i simbolit të presjes për ndarjen e pjesës së plotë nga pjesa dhjetore përbën një standard jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera të rëndësishme të Evropës kontinentale, si italishtja, gjermanishtja etj. Përjashtim këtu bën gjuha angleze në të cilën përdoret simboli i pikës, pra numrat e mësipërm shkruhen:

3.14 0.666 120,000.75

Mund të vihet re dallimi në përdorimin e simboleve të presjes dhe pikës. Në gjuhët e Evropës kontinentale si edhe në gjuhën shqipe, simboli i presjes përdoret për ndarjen e pjesës së plotë nga pjesa dhjetore e numrave. Simboli i pikës mund të përdoret për ndarjen estetike të grupeve treshifrore në numrat e mëdhenj. Kjo ndarje e grupeve treshifrore me pikë nuk përbën standard zyrtar dhe mund të shmanget ose të kryhet edhe me gjysmëhapësirë ose me simbolin e apostrofit. Mund të shkruajmë pra:

120000,75 ose 120.000,75 ose 120 000,75 ose 120'000,75

Në gjuhën angleze ndodh e kundërta. Përdoret simboli i pikës (njihet si pika notuese) i përcaktuar te standardi IEEE 754⁸⁾ për ndarjen e pjesës së plotë nga pjesa dhjetore, dhe simboli i presjes për ndarjen estetike të grupeve treshifrore

⁸⁾Hollësitë teknike gjenden te: https://en.wikipedia.org/wiki/IEEE_754

tek numrat me shumë shifra. Devijimi nga standardi i gjuhës shqipe po ndodh vitet e fundit me përhapjen e pajisjeve kompjuterike, të cilat i shkruajnë dhe shtypin numrat e tillë duke ndjekur standardin IEEE 754. Për këtë arsye, po ndeshim gjithnjë e më shumë pikën notuese në numrat që paraqiten në fatura apo kupona, në programe kompjuterike, në faqe ueb e madje edhe në tekste shkollore. Te [22] f. 164 lexojmë “pas pikës dhjetore” dhe numrat shkruhen herë me simbolin pikë e herë me simbolin presje. E njëjta gjë ndodh te [24] f. 15 ku shkruhet numri 12.6 (pra me pikë), dhe po te e njëjta faqe lexojmë “numra me presje dhjetore”. Në ndonjë tekst tjetër si te [27] përdoret emërtimi “pikë dhjetore” dhe simboli i pikës për shkrimin e numrave, pra ka koherencë, por për fat të keq jo në përputhje me rregullin e gjuhës shqipe. Nevojitet, pra, që në çdo rast të përdoren emërtimet “numra me presje” dhe “presje dhjetore” si dhe të përdoret simboli i presjes për shkrimin e numrave.

2.8 Shkronjat e mëdha

Mësymja e gjuhës angleze kundrejt gjuhëve të tjera nuk po kursen as aspekte gjuhësore të natyrës stilistike. Një prej tyre është përdorimi i shkronjave të mëdha. Dihet që këto shkronja përdoren shpesh në gjuhën angleze (edhe në atë gjermane), por rrallë në gjuhët e tjera të Evropës kontinentale ku hyn edhe shqipja. Në gjuhën angleze është e zakonshme të shkruhen me nistore të madhe të gjitha fjalët e titujve, me përjashtim vetëm të lidhëzave, nyjave dhe parafjalëve të cilat janë jo më të gjata se tri shkronja. Pra shkruhet:

“The Computational Theory of Mind” (teoria kompjuterike e mendjes), *“Methods in Computational Linguistics”* (metoda të gjuhësisë kompjuterike), *“A Symbolic Analysis of Relay and Switching Circuits”* (një analizë simbolike e qarqeve komutuese me rele), *“The Unix Programmer’s Manual”* (udhëzuesi i Unix-it për programuesit), *“Computing Machinery and Intelligence”* (makinat përlllogaritëse dhe inteligjenca) etj.

Duhet qartësuar se këtu është fjala për shkrimin e titujve në brendësi të teksteve dhe jo në ballinë, ku për arsye estetike mund të paraqiten me të gjitha shkronjat e mëdha ose në ndonjë formë tjetër. Ky rregull i gjuhës angleze po ndiqet kohët e fundit edhe në shkrimet në gjuhën shqipe, çka vihet re më shpesh në titujt e këngëve, por ndonjëherë edhe në tituj librash. Ndeshim pra:

“Ti Po Më Mundon!”, “Gjërat Kanë Ndryshuar”, “Hanibali, Kapërcimi i Alpeve dhe Beteja e Trebias”, “Enciklopedia e Gjeniut”, “Zemër E Plagosur” etj.

Në përputhje me parimin e dokumentit të Kongresit të Drejtshkrimit të

Shqipes (te [16], kapitulli VI, § 83), titujt e gazetave, revistave, librave etj. vendosen gjithnjë midis thonjzave dhe shkruhet me nistore të madhe vetëm fjala e parë ose ndonjë fjalë tjetër që përbën emër të përveçëm. Pra, titujt e mësipërm duhet të shkruheshin:

“Ti po më mundon!”, “Gjërat kanë ndryshuar”, “Hanibali, kapercimi i alpeve dhe beteja e Trebias”, “Enciklopedia e gjeniut”, “Zemër e plagosur” etj.

Edhe vendosja e titujve midis thonjzave është një rregull që ndodh të anashkalohej, çka përbën gjithashtu një gabim. Ndërkohë, teprimi me shkronjat e mëdha vihet re edhe më tepër në shkrimet e komunikimit të përditshëm ku sigurisht, serioziteti është më i paktë apo mungon krejtësisht.

3 Problematika të ndryshme leksikore

Problematikat më të mëdha dhe më të shpeshta që kemi ndeshur në bibliografi kanë të bëjnë me shqipërimet dhe përshtatjet e prurjeve nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Çështje të tilla, si përshtatja e parashtesave dhe e prapashtesave, mospërkthimet e fjalëve apo të shprehjeve, prurjet e panevojshme dhe të keqpërshtatura, ndër të tjera, janë serioze, prishin strukturën fjalëformuese të gjuhës shqipe dhe dëmtojnë pastërtinë e saj. Në vazhdim jepen shembuj nga bibliografia për secilën problematikë.

3.1 Parashtesa dhe prapashtesa

Parashtesat dhe prapashtesat luajnë një rol të rëndësishëm në fjalëformim dhe përbëjnë veçori dalluese të gjuhëve nga njëra-tjetra. Ndodh shpesh që fjalët e huazuara nga gjuhët e huaja të sillen pa përshtatje, dhe në këtë rast me përshtatje nënkuptojmë pikërisht ndryshimin e parashtesës apo prapashtesës së fjalës nga gjuha burimore në përputhje me rregullsitë fjalëformuese të gjuhës shqipe dhe parashtesave e prapashtesave të saj. Në rastet e huazimeve nga anglishtja vihen re përdorime të gabuara ose të tepruara të parashtesave **en-**, **de-** dhe **hyper-**, si dhe të prapashtesave **-al**, **-er**, **-acion**, **-tive** dhe **-icien**. Ndikim në këtë rast kanë pasur patjetër edhe gjuhë si italishtja, veçanërisht në teprimet me prapashtesën **-acion**. Në rastin e parashtesës angleze **en-** nevojitet heqja e saj, ndërsa për të tjerat, në shumicën e rasteve duhet të nxitet përdorimi i fjalëve me parashtesa e prapashtesa tipike të shqipes. Është e vërtetë se ka edhe disa raste kur prurjet me parashtesa apo prapashtesa të huaja kanë zënë rrënjë në gjuhën shqipe dhe përdoren masivisht, madje gjenden e shpjegohen edhe në FGJSSH. Në vazhdim jepen shembuj të ndryshëm prurjesh të gabuara, korrigjimet përkatëse, si dhe shembuj prurjesh të pranuar gjerësisht.

3.1.1 Parashtesa EN

Kjo parashtesë haset në gjuhën angleze, zakonisht në fillim të foljeve të cilat tregojnë aftësim apo zbatim të një procesi si dhe në emrat foljorë përkatës. Në gjuhën shqipe nuk është e pranishme, ndaj përkthimet e fjalëve që e përmbajnë duhet të bazohen te rrënja e secilës fjalë duke rrëzuar parashtesën **en-**. Disa shembuj me përdorim të shpeshtë në ligjëratën e teknologjisë së informacionit jepen në vazhdim.

encapsulation [in,kapsju'leishën] **em. prog.** në përgjithësi është veprimi i futjes së diçkaje në një "kapsulë". Në kontekstin e programimit i referohet izolimit apo fshehjes së kodit në njësi të ndryshme. Kjo fjalë po haset në

formën ~~enkapsulim~~, pra në ngjashmëri me fjalën angleze. Në raste të rralla si te [19] f. 162 ndeshet në formën ~~inkapsulim~~ që është gjithashtu e gabuar. Forma e duhur në gjuhën shqipe është **kapsulim**. Shembuj: *code encapsulation* kapsulim i kodit, *data encapsulation proces* procesi i kapsulimit të të dhënave.

encode [in'këud] **fol. kod.** kthej informacionin nga paraqitja origjinale në një bashkësi shifrash sipas një kodi të caktuar, zakonisht standard. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **kodoj**. Duhet të mësohemi të shmangim përkthimin e gabuar ~~enkodoj~~ që ndeshet shpesh, si në të folur edhe në botime. Shembuj: *encode a signal* kodoj një sinjal, *encode automatically* kodoj automatikisht.

encoder [in'këudër] **em. kod.** pajisje apo metodë që kthen informacionin nga paraqitja origjinale në bashkësi shifrash, sipas një kodi të caktuar. Përkthimet e sakta të kësaj fjale janë **shifrues** ose **kodues**. Kjo e fundit ndeshet deri diku në bibliografi, p.sh. te [27] f. 194, te [28] f. 24 etj. Në përditshmëri haset forma e gabuar ~~enkodues~~. Edhe më i rëndë është mospërkthimi fare i fjalës, pra përdorimi i formës ~~enkoder~~ si te [9] f. 43. Edhe forma ~~koder~~ që ndeshet te [29] f. 52 nuk është e përshtatshme, duke qenë se përfshin prapashtesën **-er** e cila nuk është e natyrshme në shqip (shih seksionin 3.1.5). Shembuj: *automatic encoder* kodues automatik, *digital encoder* kodues digjital.

encoding [in'këuding] **em. kod.** veprimi apo procesi i kodimit sipas foljes së mësipërme. Në këtë rast, fjala e saktë në gjuhën shqipe është **kodim**. Një formë e gabuar që përdoret shpesh në gjuhën e folur është ~~enkodim~~. Në bibliografi, p.sh. te [23] f. 31, te [15] f. 13, te [15] f. 201 etj. ndeshet më shpesh forma ~~kodifikim~~ e cila është gjithashtu e gabuar dhe duhet shmangur. Shembuj: *binary encoding* kodim binar, *hardware encoding* kodim harduer, *encoding system* sistem kodimi.

encrypt [in'kript] **fol. krip.** fsheh kuptimin e informacionit duke ngatërruar simbolet përbërëse. Edhe në këtë rast haset përdorim i panevojshëm i parashtesës **en-** në forma si ~~enkriptoj~~ ose i,e ~~enkriptuar~~ që ndeshet te [14] f. 136. Përkthimi i duhur i formës foljore është **kriptoj**. Shembuj: *encrypt a data file* kriptoj një skedar të dhënash, *encrypt the private data* kriptoj të dhënat private.

encryption [in'kripshën] **fol. krip.** veprimi i kriptimit, pra i fshehjes së kuptimit të informacionit duke ngatërruar njësitë përbërëse. Sikurse u shpjegua më sipër, përkthimi i saktë është **kriptim**. Ndër format e gabuara veçojmë ~~enkriptim~~ që ndeshet te [30] f. 6 dhe ~~kodifikim~~ që ndeshet te [14] f. 135. Shembuj: *symmetric encryption* kriptim simetrik, *strong encryption* kriptim i fortë.

3.1.2 Parashtesa DE

Kjo parashtesë ka natyrë mohuese dhe në gjuhën angleze haset tipikisht në fillim të foljeve të cilat tregojnë çaftësim, prapësim apo zhbërje të një procesi, si dhe

në emrat foljorë që rezultojnë. Duhet theksuar se parashtesa **de-** është disi e pranishme edhe në gjuhën shqipe, veçanërisht në ligjërimin libror të disiplinave të ndryshme shkencore, ndër të cilat edhe teknologjia e informacionit. Duhet nxitur, gjithsesi, që krahas fjalëve me parashtesën **de-** të përdoren edhe fjalët me nistore **sh-**, **ç-**, **zh-** të gjuhës shqipe që përbëjnë veçori dalluese të saj. Më poshtë po japim disa shembuj fjalësh me përdorim të shpeshtë.

decapsulation [di:kapsju'leishën] **em. prog.** veprimi i kundërt i kapsulimit, pra nxjerrja e diçkaje nga kapsula ku është e vendosur. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **shkapsulim**, por mund të përdoret edhe fjala **dekapsulim**. Shembuj: *code decapsulation* shkapsulim i kodit, *data decapsulation proces* procesi i shkapsulimit të të dhënave.

decode [di:'këud] **fol. kod.** kthej një strukturë informacioni nga paraqitja e koduar në paraqitjen origjinale, pra zhbëj procesin e kodimit. Fjala e shqipëruar është **shkodoj**, por mund të përdoret edhe **dekodoj**. Një formë e gabuar foljore e hasur në bibliografi është **çkodoj** te [14] f. 9. Shembuj: *decode a signal* shkodoj një sinjal, *decode the transmission* shkodoj transmetimin.

decoding [di:'këuding] **em. kod.** veprimi apo procesi i shkodimit, pra zhbërja e kodimit. Mund të përdoren fjalët **shkodim**, **dekodim**. Shembuj: *signal decoding algorithm* algoritëm për shkodimin e sinjaleve, *automatic decoding* shkodim automatik.

decompression [di:këm'preshën] **em. sh.t.** veprimi i kundërt me atë të ngjeshjes, pra veprim që kthen mbrapsht objektin origjinal nga ai i ngjeshur. Duhet të nxitet pra përdorimi i fjalës **çngjeshje** krahas fjalës **dekompresim** që gjithashtu është e përdorshme dhe haset te [23] f. 37. Shembuj: *archive decompression* çngjeshje e arkivit, *decompression algorithm* algoritëm i çngjeshjes.

deconvolution [di:konvë'ljushën] **em. mat.** veprimi i kundërt me atë të thurjes, pra veprim matematik që kthen mbrapsh thurjen. Duhet shmangur fjala **dekonvoluteion** (it. *deconvoluzione*) dhe të përdoret në vend të saj fjala **shthurje**. Shembuj: *deconvolution of a matrix* shthurje e një matrice, *deconvolution function* funksion i shthurjes.

decrypt [di:'kript] **fol. krip.** kthej mbrapsh veprimin apo procesin e kriptimit, pra marr informacionin origjinal nga ai i kriptuar. Mund të përdoren fjalët **shkriptoj**, **dekriptoj**. Shembuj: *decrypt a secret message* shkriptoj një mesazh sekret, *decrypt the transmitted data* dekriptoj të dhënat e transmetuara.

decryption [di:'kripshën] **em. krip.** emri foljor që shpreh veprimin apo procesin e zhbërjes së kriptimit. Për këtë fjalë mund të përdoren **shkriptim**, **dekriptim**, por duhet shmangur fjala e gabuar **çkëdifikim**, e cila ndeshet te [14] f. 135. Shembuj: *the decryption is impossible* shkriptimi është i pamundur,

message decyption machine makinë për shkriptim mesazhesh.

decipher [di: 'sajfër] **fol. krip.** sinonim i *decrypt*, pra mund të përkthehet **shkriptoj**, **dekriptoj**, ose edhe **deshifroj** sipas rastit të përdorimit. Shembuj: *decipher a symetrik encryption* shkriptoj një kriptim simetrik, *decipher ancient writings* deshifroj shkrime të lashta.

Si fjalë të tjera angleze, përkthimet e të cilave përfshijnë parashtesat nistore **sh**, **ç**, **zh**, por edhe format përkatëse me parashtesën **de**, mund të përmendim **decomposition** që përkthehet **shpërbërje**, **zbërthim**, por edhe **dekompozim**, **defragmentation** me përkthime **shpjesëzim**, **shfragmentim**, por edhe **defragmentim**, **demodulation** me përkthim **çmodulim**, por edhe **demodulim**, **demodulator** që përkthehet **çmodulus** ose **demodulus** etj.

3.1.3 Parashtesa HYPER

Kjo parashtesë vendoset përpara disa emrave që përfaqësojnë parametra të fiziologjisë njerëzore apo parametra të dukurive të ndryshme. Formon terma që nënkuptojnë vlera mbi normën e parametrin në fjalë. Mund të gjendet edhe në fjalë që përfaqësojnë koncepte abstrakte, si p.sh. nga matematika ose informatika, raste në të cilat nënkupton një koncept tjetër të një shkalle të sipërme apo më të lartë se koncepti bazë. Tradicionalisht, kjo parashtesë është përshtatur në gjuhën shqipe në formën **hiper** dhe gjendet në fjalë të ndryshme si hipertension, hiperglicemi, hiperklorat etj. I njëjti rregull duhet ndjekur pra edhe në përshtatjen e fjalëve të reja nga fusha e teknologjisë së informacionit, disa prej të cilave paraqiten më poshtë.

hypercube ['haipër, kju: b] **em. mat.** figurë gjeometrike 4-përmasore që mund të konsiderohet si dy kube 3-përmasorë të lidhur te këndet përkuese të njëri-tjetrit. Përkthimi i duhur i kësaj fjale është **hiperkub**. Shembuj: *hypercube modeling* modelimi i hiperkubit, *hypercube volume* vëllimi i hiperkubit.

hypergraph ['haipër, graf] **em. mat.** përgjithësim i konceptit të grafit, duke lejuar mundësinë që secila brinjë të lidhë jo vetëm dy, por një numër të pakufizuar nyjash me njëra-tjetrën. Në vend që kjo fjalë të shkruhet **hypergraph** si në anglisht, sugjerojmë që të përkthehet **hipergraf**, në përputhje me traditën e përkthimeve në tekstet e matematikës. Shembuj: *hypergraph traversal* bredhje e hipergrafit, *hypergraph structure* struktura e hipergrafit.

hyperedge ['haipër, exh] **em. mat.** brinjë që lidh dy apo më tepër nyja në një hipergraf. Sipas të njëjtit rregull, kjo fjalë duhet të përkthehet **hiperbrinjë**. Shembuj: *counting the hyperedges* numërimi i hiperbrinjëve, *hyperedge interconnection* ndërlihdje e hiperbrinjëve.

hyperlink ['haipër, link] **em. h.u.** shënjeshtë i vendosur në një objekt si faqe

në ueb apo fjalë në një dokument, që mundëson kalim të shpejtë të një pozicion tjetër në të njëjtin objekt (p.sh. seksion tjetër brenda të njëjtit dokument) ose të një objekt tjetër, pra të një njësi e jashtme. Në shumë raste si p.sh. te [31] f. 43, kjo fjalë nuk përkthehet, pra hasim **hyperlink**. Një variant është mbilidhje që ndeshet te [17] f. 88, por që devijon nga rregulli i mësipërm në lidhje me përshtatjen e parashtesës **hyper-**. Një përkthim tjetër i papërshtatshëm është **ndërlidhje**, çka përbën një koncept tjetër me të cilin nuk duhet ngatërruar. Sugjerimi ynë është fjala **hiperlidhje** e cila përbëhet nga morfema **hiper** dhe nga rrënja **lidhje** që është përkthimi i **link**. Kjo formë ndeshet edhe në njësi bibliografike si te [22] f. 117, te [23] f. 157, te [15] f. 214 etj. Shembuj: *section hyperlink* hiperlidhje e seksionit, *the hyperlink of a page* hiperlidhja e një faqeje.

hypertext [ˈhaipërtekst] **em. h.u.** format i veçantë i paraqitjes së tekstit, me lidhje dhe hiperlidhje, të cilat i mundësojnë lexuesit të lëvizë në pika të ndryshme tek i njëjti dokument ose nëpër dokumente të ndryshme në ueb. Kjo fjalë ndeshet shpesh e shkruar **hypertext**, p.sh. te [31] f. 14, te [22] f. 102 etj. Përkthimi i duhur është **hipertekst**, siç ndeshet te [21] f. 175, te [24] f. 86 etj. Shembuj: *hypertext link* lidhje në hipertekst, *hypertext pages* faqe hiperteksti.

3.1.4 Prapashtesa **AL**

Edhe prapashtesa **-al** është e pranishme në gjuhën shqipe, por ka fjalë që po përkthehen me përtesë në paraqitjen e tyre si në gjuhën angleze, në vend që të marrin prapashtesa tipike të shqipes, kur kjo gjë është e mundur. Bëhet fjalë kryesisht për mbiemra, si shembujt që vijojnë.

binomial [bai ˈnëumiël] **mb. mat.** cilësi matematike që i referohet shprehjeve të përbëra nga dy pjesë. Haset shpesh përkthimi **binomial**, ndërkohë që fjala e duhur shqipe për këtë mbiemër është **binomik**. Shembuj: *binomial expression* shprehje binomike, *binomial distribution* shpërndarje binomike.

natural [ˈnaçërëll] **mb. mat.** është fjala për mbiemrin **natyror** që duhet të mbarojë me prapashtesën **-or**, e cila përbën një veçori dalluese të gjuhës shqipe. Përdorimi i formës **natyral**, përveçse në matematikë, po ndeshet rëndom edhe në të folurin e përditshëm. Sugjerojmë që të shmanget dhe të zëvendësohet nga **natyror** në çdo rast. Shembuj: *set of natural numbers* bashkësia e numrave natyrorë, *operation on natural numbers* veprim mbi numrat natyrorë.

neural [ˈnurëll] **mb.** mbiemër që cilëson koncepte apo entitete të lidhura me sistemin nervor, nervat, trurin etj. Përkthimi i duhur në shqip është **nervor** që mbaron me prapashtesën **-or**. Përdorimi i formës **neurral** si te [18], te [32] f. 18, te [14] f. 68 etj., përbën “përtesë” në përkthim apo përshtatje dhe një gabim serioz që krijon një shfaqje të tepruar të prapashtesës **-al**. Shembuj: *neural*

network rrjet nervor, *neural system* sistemi nervor.

polynomial [,poli' nëumiëll] **mb. mat.** mbiemri **polinomik** që përdoret në matematikë për t'iu referuar shprehjeve me më shumë se një grup shkronjash që lidhen me njëra-tjetrën me simbolin e mbledhjes apo të zbritjes. Në këtë rast duhet përdorur forma me prapashtesën **-ik**, e cila përbën veçori dalluese të gjuhës shqipe dhe duhet shmangur forma ~~polinomial~~ e cila ndeshet te [14] f. 35 dhe në raste të tjera. Shembuj: *polynomial expression* shprehje polinomike, *polynomial computation complexity* kompleksitet përlogaritës polinomik.

spectral ['spektrëll] **mb. sh.t.** është fjala për mbiemrin **spektror** që haset në disiplina të ndryshme shkencore e teknike. Edhe në këtë rast, duhet përdorur forma e saktë me prapashtesën **-or** dhe duhet shmangur forma ~~spektral~~. Shembuj: *spectral analysis* analiza spektrore, *spectral lines* vijat spektrore.

thermal ['thë:rmëll] **mb. sh.t.** edhe te kjo fjalë që haset në disiplina shkencore e teknike (më shpesh në termodinamikë) duhet shmangur forma me prapashtesën ~~a~~ në favor të asaj me prapashtesën **-ik**. Në vend të ~~termal~~ duhet përdorur fjala **termik**. Kjo e fundit haset në shprehje të ndryshme të botimeve tekniko-shkencore, si “analiza termike” te [4] f. 7, “bilanc termik” te [4] f. 9 etj.

Përdorime të tepruara të prapashtesës **-al** ndeshen edhe në ligjërimin e përgjithshëm, pra përtej atij tekniko-shkencor. Mund të përmendim këtu fjalë si **kulturor**, **teator**, **muzikor** që hasen shpesh në formën ~~kultural~~, ~~teatral~~, ~~muzikal~~. Duhet pranuar gjithsesi që kemi huazuar edhe fjalë të huaja duke i pranuar me prapashtesën **-al** si në gjuhën burimore, ndaj duhet pasur kujdes në këtë pikë. Ndër to mund të përmendim **artificial** (ndërtuar apo prodhuar nga njeriu), **funksional** (që ka të bëjë me funksionin), **racional** (që lidhet me arsyen dhe arsyetimin), **esencial** (thelbësor, i qenësishëm), **origjinal** (zanafillor, i fillimit) etj. Të pestë shembujt e fundit gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH.

3.1.5 Prapashtesa ER

Prapashtesa **-er** përbën një veçori të gjuhës angleze dhe haset shpesh te emrat që përfaqësojnë profesione, funksione etj. Në gjuhën shqipe është e rrallë dhe vihet re kryesisht te fjalët e huazuara. Ka disa raste fjalësh që përkthehen me përtesë si në formën e tyre në gjuhën angleze, pra me prapashtesën **-er** në dëm të prapashtesës **-ues** apo të ndonjë prapashtese tjetër të shqipes.

encoder [in'këudër] **em. kod.** siç u sqarua në seksionin 3.1.2, është fjala për një pajisje apo metodë që kthen informacionin nga paraqitja origjinale në bashkësi shifrash sipas një kodi të caktuar. Përkthimet e sakta të kësaj fjale janë **kodues**, **shifrues**. Haset shpesh forma e gabuar ~~enkoder~~, e cila duhet shmangur. Shembuj: *digital encoder* kodues digjital, *signal encoder* kodues sinjali.

decoder [di: 'këudër] **em. kod.** pajisje, metodë apo program që kthen një sinjal apo njësi informacioni nga paraqitja e koduar në atë origjinale. Kjo fjalë ka hyrë në përdorim masiv vitet e fundit, për shkak të kalimit nga transmetimet televizive analoge tek ato digjitale të cilat kërkojnë pajisjen. Fatkeqësisht përdoret në masë forma e gabuar *dekoder*. Fjalët e duhura në gjuhën shqipe janë **shkodues** dhe **dekodues**, të cilat gjenden në bibliografi të [15] f. 11, të [27] f. 206 etj. Shembuj: *digital decoder* shkodues digjital, *electronic decoder* shkodues elektronik, *the decoder is not working* shkoduesi nuk funksionon.

Duhet theksuar se prapashtesa **-er** shfaqet edhe në huazime të cilat kanë zënë rrënjë prej kohësh në gjuhën e përditshme e madje gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH. Ndër to mund të përmendim fjalët **portier**, **korrier**, **kamerier** etj. Për këtë arsye, ka disa fjalë nga teknologjia e informacionit për të cilat nuk mund të thuhet me bindje nëse në gjuhën shqipe duhet të mbarojnë me **-er** apo me **-ues** a ndonjë prapashtesë tjetër. Ndër to përmendim:

blogger ['blogër] **em. h.u.** person që publikon rregullisht në një blog ose në disa blogje të ndryshme. Në përditshmëri kjo fjalë haset e përkthyer më së shumti në formën *bloger*, e cila është e afërt edhe me shqiptimin në frëngjisht (fr. *blogueur*). Nuk mund ta themi me bindje nëse *bloger* është shqipërimi i duhur apo do të ishte më e përshtatshme ndonjë formë tjetër si *blogues* apo *blogist*.

scanner ['skanër] **em. sh.t.** pajisje që ndijon imazhe dhe i kthen në sinjale elektrike të cilat përfaqësojnë paraqitjen digjitale të imazheve. Edhe për këtë fjalë nuk mund të themi me bindje nëse shqipërimi i duhur është *skaner* apo *skanues*. Faktikisht, forma *skaner* ka përdorim masiv dhe madje ka hyrë në FGJSSH (botimi i vitit 2006), prandaj ndoshta përbën shqipërimin e duhur.

3.1.6 Prapashtesa ACION

Prapashtesa **-acion** është gjithashtu e pranishme në gjuhën shqipe në njëfarë mase. Haset më së shumti të fjalët me prejardhje ndërkombëtare që huazohen me njëfarë përshtatjeje. Janë fjalë që në gjuhën angleze mbarojnë me *-ation*, ndërsa në gjuhën italiane me *-azione*. Për fat të keq vihet re një teprim i dëmshëm nga përdorimi i kësaj prapashtese edhe në fjalë që në gjuhën shqipe mbarojnë me prapashtesën **-im**, ndoshta për shkak të ndikimit të shqiptimit të këtyre fjalëve në gjuhën italiane. Kjo dukuri ilustron në shembujt e mëposhtëm:

application [,apli 'keishën] **em. sh.t.** kjo fjalë mbart tri kuptime kryesore: kërkesë a kandidatim për një vend pune, studimi apo diçka tjetër; përdorim apo zbatim i një mjeti, teknike apo teorie; si dhe një program kompjuteri, telefoni, etj. Në gjuhën angleze dhe në atë italiane, të tri kuptimet (madje edhe ndonjë

tjetër) mbarten nga një fjalë e vetme, përkatësisht *application* dhe *applicazione*. Në gjuhën shqipe, për kuptimin e parë përdoret fjala aplikim e cila nuk gjendet në FGJSSH dhe ndoshta mund të shqipërohet më tej me ndonjë fjalë tjetër, për të dytin fjala zbatim, ndërsa për kuptimin e tretë përdoret më së shumti fjala aplikacion. Nga shpjegimi që lexojmë te [33] f. 14 (“*a computer program that performs useful work not related to the computer itself*”), vihet re që kuptimi i tretë është i kufizuar në fushën e informatikës dhe i shkëputur nga dy të parët, pavarësisht se në gjuhën angleze shprehet me të njëjtën fjalë. Ndeshen gjithsesi raste ku ky kuptim shprehet me fjalët aplikim si p.sh. te [34] f. 79 dhe te [35] f. 71 ose zbatim te [31] f. 4. Në rastet e tjera si te [41] f. 46, te [19] f. 9 etj. ndeshim fjalën aplikacion e cila ndoshta duhet pranuar si fjala e duhur.

combination [,kombi'neishën] **em. mat.** fjala **kombinim** që përdoret si në ligjërimin e përgjithshëm edhe në atë shkencor (specifikisht në matematikë). Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **kombinim** dhe forma ~~kombinacion~~ (it. *combinazione*) duhet shmangur nga përdorimi. Shembuj: *combination of different data types* kombinim i tipave të ndryshëm të të dhënave, *combination of set elements* kombinim i elementeve të bashkësisë.

configuration [kën,figë'reishën] **em.** organizim dhe vendosje e sendeve, pjesëve apo moduleve për një qëllim të caktuar. Ndeshet shpesh në kontekstin e sistemeve softuer, sidomos për të përshkruar mjedisin ku instalohen dhe përdoren. Gjykojmë që përkthimi i duhur i saj është **konfigurim**, pra duhet shmangur forma ~~konfiguracion~~, e cila ndeshet shpesh si në gjuhën e folur edhe te [32] f. 5, te [18] f. 63, te [22] f. 97, te [23] f. 53 etj. Shembuj: *software system configuration* konfigurimi i sistemit softuer, *configuration files* skedarët e konfigurimit.

convolution [,konvë'lu:shën] **em. mat.** veprim matematik mbi dy funksione që krijon një funksion të tretë, i cili tregon se si ndryshon forma e funksionit të parë nga i dyti. Përkthimi i duhur është fjala **thurje**. Hasim shpesh fjalën ~~konvolucion~~ (it. *convoluzione*) e cila duhet shmangur. Shembuj: *convolution of two matrices* thurje e dy matricave, *convolution function* funksion i thurjes.

emulation [,emju'leishën] **em. i.s.** në teknologji informacioni kjo fjalë nënkupton imitimim me përpikëri të sjelljes së një sistemi nga një sistem tjetër i ndryshëm prej tij. Njësoj si në shembujt më sipër, vihet re përdorimi i tepruar dhe i dëmshëm i prapashtesës **-acion**. Sugjerojmë që të shmanget forma ~~emulacion~~ (it. *emulazione*) në favor të **emulim**. Shembuj: *game emulation* emulim i lojrave, *old software emulation* emulim i softuerit të vjetër.

installation [,instë'leishën] **em. sh.t.** kuptimi më i zakonshëm është veprimi i vendosjes së një objekti apo aparature në mënyrën dhe pozicionin e duhur për të funksionuar. Në sistemet kompjuterike i referohet specifikisht shtimit të programeve të caktuara. Një tjetër kuptim është ai i një pajisjeje apo

aparature të vendosur në një godinë apo mjedis të caktuar. Për secilin rast, fjala e duhur në gjuhën shqipe është **instalim** dhe jo ~~instalacion~~ (it. *installazione*). Shembuj: *installation expenses* shpenzimet e instalimit, *installation of a new program* instalim i një programi të ri.

modulation [,modjë'leishën] **em. tel.** procesi i ndryshimit të një sinjali të quajtur mbartës, në përputhje me karakteristikat e një sinjali tjetër që transmetohet. Edhe në këtë rast kemi teprim me prapashtesën **-acion** dhe qëllon që ta hasim këtë fjalë të përkthyer ~~modulacion~~ (it. *modulazione*). Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **modulim**. Shembuj: *frequency modulation* modulim në frekuencë, *phase modulation* modulim në fazë.

radiation [,reidi'eishën] **em. sh.t.** emetim i valëve apo rrezeve elektromagnetike. Vihet re përsëri përdorim i tepruar i prapashtesës **-acion** duke dhënë ~~radiaçion~~ (it. *radiazione*) që haset te [26] f. 71. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **rrezatim** dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *electromagnetic radiation* rrezatim elektromagnetik, *ultraviolet radiation* rrezatim ultravjollcë.

simulation [,simju'leishën] **em. sh.t.** krijim i një paraqitjeje virtuale dhe të përafërt të një objekti apo procesi për ta studiuar atë paraprakisht, përpara ndërtimit apo fabrikimit. Edhe në këtë rast haset shpesh përkthimi ~~simulacion~~ (it. *simulazione*) që duhet shmangur në favor të **simulim**. Shembuj: *simulation language* gjuhë simulimesh, *engineering simulation* simulim inxhinierik.

telecommunication [,telikë,mju:ni'keishën] **em. tel.** është fjalë me përdorim të gjerë në ditët e sotme. Në shumicën e rasteve përkthehet me përtesë në formën ~~telekomunikacion~~ (ita. *telecomunicazione*), p.sh. te [17] f. 83, [29] f. 48, [14] f. 106 etj. Forma e duhur në gjuhën shqipe është **telekomunikim** e cila ndeshet te [32] f. 12. Shembuj: *telecommunication student* student telekomunikimi, *telecommunication company* kompani telekomunikimi.

transformation [,transfër'meishën] **em. sh.t.** është fjala **transformim** (ose shndërrim) që përdoret në kontekste të ndryshme. Megjithëse rrallë, haset edhe forma ~~transformacion~~ (it. *trasformazione*) e cila është jo vetëm e gabuar, por edhe qesharake dhe duhet shmangur. Shembuj: *transformation function* funksion i transformimit, *transformation procedure* procedurë transformimi.

Problemi i teprimit me prapashtesën **-acion** është aq serioz sa po shtrembërohen edhe fjalë shqipe të përdorimit të përgjithshëm. Një rast i tillë është fjala **komunikim** që te [9] f. 41 dhe [9] f. 46 shkruhet ~~komunikacion~~, çka përbën një absurditet. Duhet theksuar gjithsesi se prapashtesa **-acion** haset deri diku edhe në fjalë të ligjërimit të përditshëm apo në huazime të disiplinave të ndryshme shkencore te të cilat nuk përbën problem. Mund të përmendim fjalët **dokumentacion**, **agjitacion**, **emigracion** etj. që gjenden dhe shpjegohen në

FGJSSH.

3.1.7 Prapashtesa TIVE

Kjo parashtesë haset në gjuhën angleze por edhe në gjuhën shqipe, zakonisht në fjalë të ligjërimin të përgjithshëm. Shumica e fjalëve shqipe që mbarojnë me **-tiv** ose **-tive** (sipas gjinisë) kanë një formë tjetër me **-ues** ose **-uese** që është njësoj e vlefshme. Kjo vihet re në shembuj si informativ dhe informues, provokativ dhe provokues, edukativ dhe edukues etj., të gjitha të shpjeguara në FGJSSH. Problem përbëjnë disa fjalë angleze me **-tive** të cilat përdoren edhe në shqip pa asnjë përkthim apo përshtatje. Disa shembuj të tillë jepen në vazhdim.

additive [ˈaditiv] **mb. mat.** cilëson diçka që gëzon vetinë e mbledhjes, pra që pranon njësi shtesë. Kjo fjalë duhet përkthyer **mbledhës**, **shtues** dhe jo **aditiv**. Shembuj: *additiv unit* njësi mbledhëse, *additive circuit* qark mbledhës.

communicative [kəˈmju:nikətiv] **mb.** që ka aftësi për të komunikuar apo shkëmbyer informacion. Kjo fjalë duhet të përkthehet **komunikues**, **komunikuese** dhe jo **komunikativ** siç e hasim te [29] f. 50. Shembuj: *communicative skills* aftësi komunikuese, *communicative units* njësi komunikuese.

multiplicative [ˌmɛltiˈplikətiv] **mb. mat.** në përgjithësi cilëson diçka që gëzon vetinë e shumëzimit, pra që shfaqet si faktor i një prodhimi. Kjo fjalë duhet të përkthehet **shumëzues**, **shumëfishues** dhe jo në formën **multiplikativ**. Shembuj: *multiplicative unit* njësi shumëzuese, *multiplicative circuit* qark shumëzues.

Rast të veçantë përbëjnë fjalët *conjunctive* dhe *disjunctive* të cilat përdoren në matematikë dhe logjikë, përveçse në ligjërimin e përgjithshëm në të cilin mund të shprehen nga fjalët shqipe lidhës dhe ndarës. Gjykojmë që huazimet konjuktiv dhe disjunktiv janë të nevojshme për të shprehur kuptimet specifike të matematikës dhe logjikës.

3.1.8 Prapashtesa ICIEN

Kjo prapashtesë është fare e huaj në gjuhën shqipe. Haset vetëm në disa forma të gabuara fjalësh, si p.sh. **matematicien** që ndeshet te [25] f. 40, te [14] f. 6 etj., **informaticien** që ndeshet te [19] f. 8, **logjicien** dhe **statisticien**. Ka të ngjarë që përdorimi i këtyre formave të ndikohet nga mënyra si shkruhen fjalët në gjuhën frënge, përkatësisht *mathématicien*, *informaticien* *logicien*, *statisticien*. Fjalët e duhura për këto raste janë përkatësisht **matematikan**, **informatikan** që shkruhet saktë te [34] f. 75, **logjist** dhe **statistikan**. Të tjera fjalë që shkruhen gabimisht me **-icien** përmendim **teknicien** dhe **elektronicien** që ndeshen te [15] f. 231 ku lexojmë “të jesh teknicien shërbimi dhe riparimi do të thotë të jesh një elektronicien i aftë”. Në vend të tyre duhen përdorur fjalët **teknik** dhe **specialist elektronike**. Si

shembuj të tjerë fjalësh për profesione apo specialitete që mbarojnë me **-kan** ose **-ist** dhe që përputhen me traditën tonë fjalëformuese përmendim **gramatikan** që ndeshet te [36] f. 34, **sinoptikan**, **algjebriçist**, **elektriçist** etj. Ndërkohë, prapashtesa **-icien** gjendet edhe në ndonjë fjalë tjetër të huaj të futur pa përshtatje, si p.sh. **prakticiein** e cila është fare e papranueshme. Në vend të saj duhet të përdoret fjala **praktikant** duke iu referuar dikujt që praktikon diçka. Kjo prapashtesë ndeshet edhe në ndonjë fjalë të përgjithshme si **teoricien** e cila gjendet në FGJSSH dhe përdoret gjerësisht pa përbërë problem.

3.2 Shtrembërime fonetike

Nuk mungojnë as problemet që lidhen me ngatërrimin e fonemave në fjalë të ndryshme, pra shkrimin apo shqiptimin e gabuar të atyre fjalëve kundrejt një shkronje apo foneme. Rast tipik përbëjnë c-ja me ç-në të cilat ngatërrohen shpesh. Një tjetër çështje e rëndësishme në këtë pikë është edhe përshtatja e duhur fonetike e fjalëve angleze që përmbajnë shkronjën *w*. Në vijim jepen shembuj të ndryshëm prurjesh të gabuara dhe korrigjimet përkatëse.

3.2.1 Ngatërrime të c-së me ç-në

Veç problemit të shmangies së shkronjës **ç** (pra kur në vend të saj përdoret shkronja **c** e cila shtypet lehtësisht në tastierë) që u trajtua në seksionin 2.3, vihen re shpesh dhe disa raste fjalësh ku shkronja **ç** përdoret gabimisht në vend të **c**-së. Më poshtë po japim disa shembuj tipikë që ndeshen më shumë në ligjërimin e përditshëm, por shpeshherë edhe në bibliografi.

Fjala **procedurë** përdoret shpesh në ligjërimin teknik apo në atë të programimit. Çuditërisht jemi mësuar ta shkruajmë e shqiptojmë këtë fjalë në formën e gabuar **prøçedurë**.

Fjala **proces** ka përdorim të gjerë në ligjërimin e përgjithshëm, në disiplina tekniko-shkencore, por edhe më specifikisht në terminologjinë e sistemeve operative. Edhe këtë fjalë e dëgjojmë shpesh në formën e gabuar **prøçes** dhe e ndeshim në këtë formë të gabuar edhe te [37] f. 42, te [38] f. 102, te [23] f. 57 etj.

Fjalët **certifikatë**, **certifikoj**, **certifikim** përdoren gjithashtu si në ligjërimin e përgjithshëm edhe në atë të teknologjisë së informacionit, veçanërisht në çështje të sigurisë kibernetike. Në shumicën e rasteve, këto fjalë i hasim në format e gabuara **çertifikatë**, **çertifikoj**, **çertifikim**.

Fjalët **licensë**, **licensim**, **licensoj**, përdoren shpesh për të qartësuar të drejtat dhe detyrimet që kërkohen për përdorimin e programeve kompjuterike apo të burimeve të tjera. Në shumicën e rasteve jemi mësuar që këto fjalë t'i hasim

në format e gabuara ~~licensë~~ si te [29] f. 67 ose ~~liceneë~~ si te [14] f. 26, ~~licensim~~ si te [22] f. 128 dhe ~~licensoj~~.

Fjala **koeficient** ka përdorim të gjerë në të gjitha disiplinat tekniko-shkencore, ekonomi, teknologji informacioni e më gjerë. Duhet pranuar se kjo fjalë ndeshet më shpesh në formën e gabuar ~~koefieent~~.

Fjalët **eficient** dhe **eficiencë** janë huazuar gjithashtu nga gjuhët neolatine, njësoj si fjala ~~koeficient~~. Në analogji me të, edhe këto fjalë ndeshen më shpesh në format e gabuara ~~efieent~~ dhe ~~efieeneë~~, p.sh. te [30] f. 30.

Fjalët **deficit** dhe **deficitar** përdoren më tepër në terminologjinë e financës, por ndonjëherë edhe në atë inxhinierike. Edhe këto fjalë ndeshen në format e gabuara ~~defieit~~ dhe ~~defieitar~~.

Të gjitha fjalët e mësipërme gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH në formën e tyre të saktë, pra me shkronjën **c**. E njëjta formë shkrimi duhet ndjekur edhe në artikuj, libra, dhe shkrime të tjera.

3.2.2 Shtrembërimet e fonemës GJ

Vihen re gjithashtu shtrembërimet e shpeshta të fonemës gj në xh, veçanërisht te fjalë që përmbajnë *gi* apo *ge*, të cilat shqiptohen *xhi/xhe* në italishte dhe *zhi/zhe* në frëngjishte. Më poshtë po japim disa shembuj konkretë.

agenda [ə'xhendə] **em. p.f.** kuptimi i parë është plan veprimesh të shtrira në kohë, ndërsa i dyti pajisje elektronike që ndihmon në hartimin dhe mbajtjen mend të planit të veprimeve. Fjala e duhur është **agjendë**. Duhet shmangur nga përdorimi forma ~~axhendë~~ e cila dëgjohesh shpesh dhe haset te [23] f. 13. Shembuj: *personal agenda* agjendë vetjake, *digital agenda* agjendë digjitale.

digital [ˈdixhitəll] **mb. sh.t.** fjalë me përdorim të shpeshtë që tregon natyrën e një njësie informacioni, aparati, shërbimi, procesi etj. Përshtatja e duhur është forma **digjital** që ndeshet e shkruar saktë te [30] f. 3, te [31] f. 92, te [26] f. 64 etj., si edhe fjalë të tjera si **numerik**, **shifror** që janë gjithashtu të përshtatshme. Duhet shmangur në çdo rast forma ~~dixhitale~~ e cila haset te [21] f. 130, te [31] f. 67, te [23] f. 13 etj., si dhe forma ~~digital~~ që ndeshet te [15] f. 232. Shembuj: *digital photography* fotografi digjitale, *digital device* pajisje digjitale.

digitalize [ˈdixhitəlaiz] **fol. sh.t.** folja që shpreh veprimin e kthimit të një objekti apo njësie informacioni nga paraqitja analoge apo fizike në atë digjitale. Fjala e duhur është **digjitalizoj** e cila duhet përdorur duke shmangur formën e pasaktë ~~dixhitalizoj~~. Shembuj: *digitalize an archive* digjitalizoj një arkivë, *digitalize the rare scripts* digjitalizoj shkrimet e rralla.

digitalization [ˌdixhitələˈzeishən] **em. sh.t.** emër që shpreh veprimin apo

procesin e kthimit të një objekti apo njësie informacioni nga paraqitja analoge apo fizike në atë digjitale. Në gjuhën shqipe fjala e duhur është **digjitalizim** dhe duhet shmangur emri ~~digitalizim~~. Shembuj: *libraty digitalization* digjitalizim i bibliotekës, *photo album digitalization* digjitalizim i albumit të fotografive.

tangent [ˈtɛnxhɛnt] **em. mat.** koncept nga matematika që në shqip është emërtuar historikisht **tangjent** ose **tangjente** (kur përdoret si mbiemër) prej të paktën 50 vjetësh, duke qenë se gjendet te [1] f. 185. Fatkeqësisht, vitet e fundit po shkruhet ~~tangent~~, pra njësoj si në gjuhën angleze. Shembuj: *tangent lines* vija tangjente, *the curbe tangent* tangjenti i lakores.

Problemët me fonemën gj vihen re edhe në fjalë të tjera përtej teknologjisë së informacionit apo terminologjisë librore, si p.sh. tek fjala **agjenci**. Ndodh shpesh përdorimi i kësaj fjale në formën ~~axhenei~~. E njëjta gjë ndodh me fjalën **gjirafë** e cila haset shpesh në formën ~~xhirafë~~. Një tjetër lloj shtrembërimi i fonemës gj vihet re në rastet kur në vend të saj përdoret fonema g. Disa shembuj janë fjala **gjen** që haset në formën ~~gen~~ si dhe **gjenetikë** që shtrembërohet në ~~genetikë~~. Format e sakta të këtyre shembujve gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH.

3.2.3 Prurjet me shkronjën W

Problem më vete janë huazimet nga anglishtja që përmbajnë shkronjën **w**. Tri nga fjalët kryesore të kësaj kategorie bazuar te shpeshësia e përdorimit janë **hardware** (elementet apo pjesët fizike të sistemeve kompjuterike), **software** (elementet skematike, logjike e konceptore të tyre si p.sh. programet dhe dokumentimi), **web** (hapësira virtuale e programueshme që mundëson identifikimin, lidhjen dhe shpërndarjen e burimeve digjitale në internet). Tri fjalët e mësipërme hasen shpesh pa asnjë përshtatje, pra ~~hardware~~ si te [17] f. 82, ~~software~~ si te [29] f. 51, dhe ~~web~~ si te [22] f. 6. Disa forma të tjera të tyre janë ato me shkronjën **w** të kthyer në **v**, si ~~hardver~~ apo ~~hardverik~~, ~~softver~~ apo ~~softverik~~ që ndeshet te [39] f. 2, ndoshta të ndikuara nga shqiptimet përkatëse të tyre në gjuhën gjermane në të cilën shkronja **w** shqiptohet si **v**-ja në gjuhën shqipe. Këto forma përbëjnë devijime të konsiderueshme fonetike nga fjalët në gjuhën burimore, ndaj gjykojmë se janë jo të përshtatshme.

Në traditën e përkthimeve nga anglishtja, fjalët me shkronjën **w** janë përshtatur në gjuhën shqipe duke e kthyer atë në **u**. Ky rregull përbën në shumicën e rasteve përafrimin më të mirë fonetik të fjalëve që hyjnë te kjo kategori. Disa shembuj që mund të japim janë *Walt Whitman* – Uollt Uitman, *Washington* – Uashington, *William* – Uiliam, *Newton* – Njuton, *Stewart* – Stjuart, *Swift* – Suift etj. Në të njëjtën mënyrë, gjykojmë që përshtatjet e duhura për fjalët e kësaj kategorie janë **harduer** siç ndeshet te [40] f. 186, **softuer** si te [29] f. 50 dhe **ueb** si te [22] f. 132. Po njësoj vepohet edhe me mbiemrat, pra shkruhet

harduerik si te [18] f. 32 dhe **softuerik** si te [31] f. 67. Duhet bërë gjithashtu kujdes me fjalën web e cila në përdorimin si emër shkruhej dikur me nistore të madhe, pra Web. Vitet e fundit po trajtohet gjithnjë e më shpesh si një emër i përgjithshëm i shkruar web, por mund të ndeshet në ndonjë rast edhe Web. Në secilin rast duhet përkthyer e shkruar në formën ueb. Në përdorimin si mbiemër, kjo fjalë ndeshet gjithnjë web dhe përkthehet ueb.

3.3 Mospërkthime të fjalëve e shprehjeve

Një nga problematikat më të mprehta është mospërkthimi i fjalëve ose huazimi i tyre pa përshtatjen e duhur dhe pa marrë parasysh strukturën dhe traditën fjalëformuese të shqipes. Në këtë kategori hyjnë shumë fjalë dhe shprehje angleze për të cilat mund të gjenden fjalë të përshtatshme të gjuhës shqipe, por duket qartë që nuk bëhen përpjekjet e duhura për këtë gjë. Në rastin e shprehjeve kemi të bëjmë shpesh me emërtime të drejtmeve studimore të cilat duhen përkthyer saktë në çdo rast. Cilësia e përkthimeve të tyre merr një rëndësi të veçantë, sepse këto shprehje shfaqen shpesh në tituj diplomash, artikujsh, librash etj. Më poshtë jepen disa raste fjalësh e shprehjesh të rëndësishme:

Adversarial Machine Learning (shkurt. *AML*) është një fushë zbatimi e inteligjencës artificiale që përdor modele inteligjente për të sulmuar apo thyer sisteme informatike, ose për të kundërtën, pra për t'i dalluar e bllokuar rreziqet apo sulmet kundër tyre. Kjo shprehje nuk ndeshet shpesh duke qenë specifike dhe e viteve të fundit. Bazuar edhe te praktika italiane e përkthimit të saj (it. *apprendimento in ambiente ostile*) gjykojmë që përkthimi i duhur në gjuhën shqipe do të ishte **mësim në mjedis armiqësor**.

agglomerative hierarchical clustering përfshin një grup algoritmesh grupimi që i grumbullojnë kampionët e të dhënave në hapa të ndryshëm, pra në mënyrë hierarkike. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe gjykojmë që është **grupim hierarkik grumbullues**.

anchor [’engkër] **em. h.u.** mekanizëm i gjuhës HTML që shërben për të krijuar hiperlidhje të cilat na çojnë nga faqja aktuale në faqe të tjera. Në vend që të përdoret e papërkthyer, kjo fjalë duhet të përkthehet **spirancë**, njësoj si kuptimi i objektit konkret, siç ndeshet te [31] f. 43.

background [’bekgraund] **em. 1) graf.** një nga kuptimet është pjesa e prapme e një skene, imazhi, fotografie etj., e cila ndodhet pas objekteve që skicohen, vendosen apo projektohen. Ky kuptim shprehet nga fjala **sfond** e cila gjendet e përdorur saktë te [38] f. 49, te [19] f. 37 etj. Duhet shmangur rastet e shkrimit ~~background~~ siç ndodh te [35] f. 71, te [24] f. 41, te [19] f. 46 etj. Shembuj: *background color* ngjyra e sfondit, *background elements* elementet e sfondit.

background [ˈbɛk,graʊnd] **em. 2)** s.o. ky kuptim është më i rrallë dhe specifik; ndeshet vetëm në terminologjinë e sistemeve operative ku i referohet mënyrës së ekzekutimit të një procesi apo detyre, pa ndërhyrje apo ndërveprim nga operatori. Duhet shmangur fjala ~~background~~ e cila dëgjohet shpesh. Fjalët e duhura në gjuhën shqipe janë **prapaskenë**, **prapavijë**. Shembuj: *background job* punë e prapaskenës, *background job execution* kryerje në prapaskenë e punëve.

backslash [ˈbɛkslɛʃ] **em. graf.** simboli \ që përdoret në kontekste të ndryshme të informatikës për t'u dhënë kuptim specifik simboleve apo shprehjeve të tjera simbolike. Kjo fjalë nuk përkthehet dhe shpesh lexojmë fjalën ~~backslash~~. Përkthimet e duhura janë **kundërthyesë**, **kundërfraksion**. Shembuj: *backslash key* tasti i kundërthyesës, *use backslash to escape the special meaning of the symbols* përdor kundërthyesën për të shmangur kuptimin e veçantë të simboleve.

back-door [ˌbɛkˈdoːr] **em. sig.** mekanizëm që mundëson hyrjen në një sistem kompjuterik në mënyrë të fshehtë duke anashkaluar sistemin e tij të mbrojtjes. Kjo fjalë nuk haset ndonjëherë e përkthyer. Lexojmë rëndom fjalën ~~back-door~~ ose ~~back-door~~, si p.sh. te [29] f. 63. Një fjalë e përshtatshme që e mbart konceptin do të ishte **deriçkë** e cila gjendet në FGJSSH. Shembuj: *scan the system for back-doors* skanoj sistemin për deriçka, *back-door attack* sulm i deriçkës.

badge [bɛxh] **em. p.f.** pjesë metalike apo plastike me gdhendje apo shkrime që mbahet nga një person për të treguar që bën pjesë në një organizatë apo që ka një pozitë a funksion të caktuar. Për këtë koncept po hasim gjithnjë e më shpesh forma që i ngjajnë fjalës angleze si ~~badge~~, ~~baxh~~, ~~bexh~~, etj. Gjykojmë që fjala më e përshtatshme në gjuhën shqipe është **distinktiv** e cila, edhe pse me origjinë të huaj (it. *distintivo*), ka hyrë prej kohësh në FGJSSH dhe ka njëfarë përdorimi. Shembuj: *please show your badge* të lutem trego distinktivin, *security personel badge* distinktivi i personelit të sigurisë.

bandwidth [ˈbɛnd,wɪdθ] **em. tel.** gjerësi e bandës së frekuencave në një linjë teletransmetimi ose kapacitet transmetues i një linje kabllore. Shpesh herë kjo fjalë nuk përkthehet, pra hasim ~~bandwidth~~ si p.sh. te [26] f. 8. Përkthimet e duhura varen nga shembulli konkret i përdorimit, por për shumicën e rasteve kanë vend shprehjet **gjerësi bande**, **gjerësi brezi**, **kapacitet** (i transmetimit). Shembuj: *transmission bandwidth* gjerësia e brezit të transmetimit, *high bandwidth interconnection* ndërlidhje me gjerësi të lartë brezi.

barcode [ˈbɑːrkəʊd] **em. kod.** kod që përdoret masivisht si identifikues i artikujve dhe që e paraqet numrin e identifikimit si një seri vijash vertikale dhe paralele me gjerësi dhe lartësi të ndryshme nga njëra-tjetra. Kjo fjalë nuk përkthehet thujtë asnjëherë dhe haset në formën ~~barcode~~, p.sh. te [9] f. 43, te [14] f. 99 etj. Përkthimi i duhur është **kod vijor**. Shembuj: *barcode reader* lexues i kodit vijor, *product barcode* kodi vijor i produktit.

batch [beç] **em. sh.t.** një bashkësi sendesh apo objektësh që trajtohen bashkarisht si një grup. Ky kuptim i fjalës angleze mbartet shumë mirë nga fjalët **tufë**, **grumbull**, por ndodh shpesh që këtë fjalë ta ndeshim të shkruar **batëh**, si p.sh. te [21] f. 78. Shembuj: *batch of records* tufë regjistrimesh, *batch size* madhësia e tufës, *batch processing* përpunim në tufa.

bookmark [ˈbukma:rk] **fol. h.u.** si folje shpreh shënimin nga përdoruesi të adresës së një faqeje ueb në shfletues, me qëllim që ta hapë atë faqe lehtësisht në të ardhmen. Ndodh shpesh të dëgjojmë shprehje si **bëj bookmark**. Përkthime të mundshme të kësaj fjale kur përdoret si folje janë **shënoj**, **ruaj**. Shembuj: *bookmark the address of that profile* ruaje adresën e atij profili, *bookmark every web page you will need later* ruaj çdo faqe ueb që do të të duhet më vonë.

bookmark [ˈbukma:rk] **em. 1) h.u.** si emër nënkupton në shumicën e rasteve mekanizmin e shënimit të adresave të faqeve ueb nga përdoruesi në programin shfletues, për një gjetje të lehtë të tyre në të ardhmen. Ky mekanizmi i shënimit të adresave ueb është analog me atë të shënimit të faqeve në një libër me anë të një fijeje. Në raste të ndryshme si te [31] f. 43 gjejmë **bookmark**, pa asnjë përkthim a përshtatje. Disa përkthime të mundshme në gjuhën shqipe janë **faqeruajtës**, **fletëshënues**. Shembuj: *organize the bookmarks* organizoji faqeruajtësit, *this bookmark does not work* ky faqeruajtës nuk funksionon.

bookmark [ˈbukma:rk] **em. 2) h.u.** përdoret edhe emri që nënkupton në disa raste edhe veprimin sipas kuptimit të foljes përkatëse, pra shënimin e adresave të faqeve ueb nga përdoruesi në programin shfletues, për një gjetje të lehtë e të shpejtë të tyre në të ardhmen. Edhe në këtë rast ndeshim shpesh **bookmark**. Disa përkthime të mundshme në gjuhën shqipe për këtë rast përdorimi të emrit janë **shënim i faqes**, **ruajtje e faqes**.

boot [bu:t] **fol. sh.t.** veprimi i nisjes, ndezjes apo vënies në punë të sistemit kompjuterik. Në përditshmëri dëgjojmë **butoj**, **butohet** apo **butim**. Këto forma ndeshen edhe në bibliografi, p.sh. te [35] f. 37. Fjalët e dhura janë **nis**, **ndez**, **vë në punë**, prej të cilave mund të zgjidhet ajo që tingëllon më mirë në rastin specifik. Duhet bërë kujdes që të përdoren sipas këtij kuptimi vetëm për sistemin kompjuterik, dhe jo në kontekste të tjera. Shembuj: *boot the computer* ndez kompjuterin, *your computer boots slowly* kompjuteri yt ndizet ngadalë.

boot [bu:t] **em.** emër foljor që vjen nga folja më sipër dhe i referohet ndezjes apo vënies në punë të sistemit kompjuterik. Në përditshmëri e sidomos në gjuhën e folur përdoren fjalë si **butim**. Fjalët e dhura shqip janë **nisje**, **ndezje**, **vënie në punë**, prej të cilave mund të zgjidhet ajo që tingëllon më mirë në rastin konkret të përdorimit. Njësoj si më sipër, duhet bërë kujdes që këto fjalë të përdoren sipas këtij kuptimi vetëm në lidhje me sistemin kompjuterik, dhe jo në kontekste të tjera. Shembuj: *fast boot* ndezje e shpejtë, *boot block* blloku i

nisjes, *boot sector* sektori i nisjes, *boot failure* dështim në nisje.

bridge [brɪxh] **em. p.f.** bëhet fjalë për urën si pajisje fizike ose si mekanizëm softuer që përdoret për ndërlidhjen e makinave dhe rrjeteve. Kjo fjalë duhet të shkruhet **urë**, siç ndeshet te [17] f. 82 apo në botime edhe më te hershme si te [3] f. 135 ku gjejmë “urë induktive”, “urë kontakti”, “urë matëse” etj. Fatkeqësisht, po ndodh shpesh që fjala të ndeshet *bridge*, p.sh. te [22] f. 98. Shembuj: *virtual bridge* urë virtuale, *bridge connection* lidhje me urë.

browser [ˈbrauzər] **em.** program që përdoret për të shfletuar skedat e sistemit kompjuterik, faqet në internet etj. Për fat të keq nuk përkthehet (sidomos në gjuhën e folur) dhe përdoren rëndom *brauzer*, *brauzër*, *brouzer* apo *browser*, p.sh. te [21] f. 159, te [19] f. 37, te [17] f. 89, te [30] f. 12 etj. Përkthimi i duhur është **shfletues** siç shkruhet te [31] f. 11, te [24] f. 86, te [21] f. 171 etj. Shembuj: *graphical file browser* shfletues grafik i skedarëve, *fast browser* shfletues i shpejtë.

buffer [ˈbafər] **em. sh.t.** kujtesë e shpejtë që përdoret për të mbajtur përkohësisht të dhëna dhe për të zbutur diferencën në shpejtësi përpunimi apo komunikimi midis pajisjeve të ndryshme. Edhe kjo fjalë nuk përkthehet, ndaj shpesh ndeshim *buffer* ose *bufer* si te [40] f. 72. Përkthimi i duhur varet nga rasti specifik, por disa shembuj të saktë janë **parakujtesë** si te [28] f. 127, **tampon** si te [40] f. 155 apo **kujtesë tampon** si te [40] f. 158. Shembuj: *small buffer memory* kujtesë e vogël tampon, *buffer size* madhësia e tamponit.

build [bɪld] **em. i.s.** modul softuer me një version të caktuar, që funksionon si një i tërë dhe që përbën një prototip të një programi apo sistemi. Kjo fjalë haset shpesh në lajme për prezantimin e versioneve të reja të softuerëve të njohur dhe nuk përkthehet. Gjykojmë si të përshtatshme fjalën **konstrukt**. Shembuj: *Linux kernel build 4.18.0* konstrukt i kernelit Linux, *software system build update* përditësim i konstruktit të sistemit softuer.

built-in [ˌbɪltˈɪn] **mb. sh.t.** që është vendosur në brendësi të një njësie tjetër më të madhe, si pjesë e pandashme e saj. Për këtë koncept përdoret kryesisht fjala angleze, pra ndeshim *build-in*, p.sh. te [31] f. 59. Në gjuhën shqipe vlejné fjalë si i,e **trupëzuar** ose i,e **integruar**, siç paraqitet e sqaruar në kllapa te [26] f. 9. Shembuj: *built-in function* funksion i trupëzuar.

calculator [ˈkɛlkjuleitər] **em. p.f.** pajisje që mbahet në dorë apo në xhep dhe përdoret për të kryer veprime aritmetike. Edhe kjo fjalë nuk para përkthehet dhe ndeshim shpesh forma të ngjashme me fjalën angleze si *kalkulator* te [39] f. 100. Fjala e duhur varet nga rasti specifik. Disa mundësi janë **llogaritës**, **makinë llogaritëse**, **llogaritës dore** ose **llogaritës xhepi**. Shembuj: *electronic calculator* makinë llogaritëse elektronike, *pocket calculator* llogaritës xhepi.

caption [ˈkɛpshən] **em. graf.** këtu kemi të bëjmë me sqarimin në formën e

një tekst të shkurtër që jepet poshtë elementeve të një libri, si figurat ose tabelat dhe qartëson përmbajtjen e tyre. Për këtë koncept është huazuar prej kohësh nga italishtja fjala **diçiturë**, e cila përdoret saktësisht te [29] f. 12. Në raste të tjera si te [41] f. 31 dhe [38] f. 36 ndeshim përkthime fjalë për fjalë, përkatësisht etiketë **imazhi** dhe **përshtëshënim**. Shembuj: *caption the figure* vendos diçiturën e figurës, *short figure caption* diçiturë e shkurtër e figurës.

cluster ['klastër] **fol. sh.t.** shpreh procesin e grupimit të njësisve të ngjashme të një bashkësie në grupe të veçanta. Kjo fjalë ndeshet e papërkthyer në formën **klaster** si te [35] f. 38, ose në formën **eluster** si te [15] f. 50. Përkthimi i duhur për foljen është **grupoj**, siç përdoret te [18] f. 33. Shembuj: *cluster the objects* grupoj objektet, *cluster the data points* grupoj pikat e të dhënave.

cluster ['klastër] **em. sh.t.** emërtim i grupeve me objekte të ngjashme që merren pasi zbatohet procesi i grupimit. Njësoj si dhe folja më sipër, ndeshet i papërkthyer në format **klaster** ose **eluster**. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **grup**. Shembuj: *cluster of similar objects* grup objektësh të ngjashme, *cluster of data points* grup i pikave të të dhënave.

clustering ['klastëring] **em. sh.t.** shpreh procesin e grupimit dhe përdoret shpesh për të përshkruar metodat e ndryshme me të cilat kryhet. Veç emrit **grupim** sipas foljes dhe emrit më sipër, te [42] f. 68 ndeshim emrin **fqinjëzim** që ndoshta mund të përdoret sinonimisht. Shembuj: *clustering algorithm* algoritëm grupimi, *data clustering time* koha e grupimit të të dhënave.

code word i referohet një kombinimi simbolesh nga një kod standard, që paraqet një njësi informacioni nga një kod tjetër ose nga gjuha natyrore. Këtë shprehje e ndeshim shpesh në forma si **fjalë-kod**, p.sh. te [28] f. 9 dhe [14] f. 113, **fjalë-kod** te [28] f. 17 dhe **fjalë-kodike** te [27] f. 60. Për mendimin tonë, forma më e thjeshtë dhe e saktë është **fjalë kodi**, **kodfjalë**, duke qenë se njësia e referuar është fjala sipas një kodi të caktuar dhe jo kodi sipas fjalës.

Computer Graphics (shkurt. **CG**) i referohet degës së informatikës që përdor sisteme dhe metoda kompjuterike për prodhim e përpunim imazhesh dhe lidhet ngushtësisht me përpunimin e fotografive digjitale, krijimin e lojërave kompjuterike, filmave vizatimorë etj. Kjo shprehje nuk po përkthehet vitet e fundit. Përkthimi i duhur i saj është **grafikë kompjuterike**, **infografi**.

Computer Vision (shkurt. **CV**) është dega e informatikës që përdor sisteme dhe metoda kompjuterike për të analizuar imazhet dhe për të automatizuar detyra të ndryshme të shikimit njerëzor. Edhe kjo shprehje nuk po përkthehet vitet e fundit, ndaj haset shpesh si në gjuhën angleze. Në disa botime si p.sh. te [18] f. haset në formën **vizion kompjuterik**, që nuk përbën shqipërim të plotë. Përkthimi i saktë i saj në gjuhën shqipe është **shikim kompjuterik**.

connected [kë'nektid] **mb. sh.t.** që është lidhur me diçka tjetër për të shkëmbyer informacion. Përkthehet fare mirë i.e **lidhur**, i.e **ndërlidhur**. Ndeshim ndonjëherë fjalë qesharake si ~~konektuar~~ te [29] f. 53. Shembuj: *connected to the network* i lidhur me rrjetin, *continuously connected* vazhdimisht i lidhur.

controller [kën'trëullër] **em. sh.t.** pajisje që kontrollon a rregullon punën e një makine ose të një mekanizmi elektrik apo elektronik. Kjo fjalë haset ose e papërkthyer ose me njëfarë përshtatje fonetike gjysmake, pra lexojmë e dëgjojmë shpesh ~~controller~~, ~~kontroller~~, ~~kontrollër~~. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është fjala **kontrollor**, e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH si dhe në bibliografi te [15] f. 210 etj. Shembuj: *disk controller* kontrollori i diskut, *temperature controller* kontrollor temperature.

cracker ['krakër] **em. sig.** person që kryen thyerje të sistemeve informatike në shkelje të ligjeve dhe për qëllime keqdashëse. Kjo fjalë përdoret ose pa asnjë përkthim ose me njëfarë përshtatje fonetike, pra haset në format ~~eracker~~, ~~krekër~~, ~~kraker~~. Sugjerojmë që të përdoren si përkthime të sakta fjalët **thyerës**, **pirat** të cilat gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH. Shembuj: *bank card cracker* thyerës i kartave bankare, *agile cracker* pirat i shkathët.

cybersecurity [,saibërsi'kjurëti] **em. sig.** siguri e sistemeve dhe e rrjeteve kompjuterike nga hyrjet e paautorizuara për qëllime keqdashëse. Edhe kjo fjalë përdoret pa asnjë përkthim, pra dëgjojmë vazhdimisht ~~eybersecurity~~, ~~sajbersikjuritë~~. Përkthimi i saktë në gjuhën shqipe është **siguri kibernetike**. Shembuj: *cybersecurity importance is growing* siguria kibernetike po bëhet e rëndësishme, *cybersecurity training* trajnim në siguri kibernetike.

deadlock ['dedlok] **em. s.o.** fjalë që përdoret në ligjërimin e sistemeve operative për të treguar ngecjen në një pikë pa rrugëdalje. Kjo ndodh kur secili prej dy a më shumë proceseve që zotërojnë disa burime kërkon ndonjë burim nga proceset e tjera që të vazhdojë punën dhe nuk lëshojnë burimin apo burimet e veta. Në shumicën e rasteve nuk përkthehet, pra e gjejmë edhe në gjuhën shqipe të shkruar ~~deadlock~~. Disa përkthime të mundshme janë **ngërç**, **qorrsokak**, **rrugë qorre**. Shembuj: *deadlock prevention techniques* teknika të parandalimit të ngërçit, *frequent system deadlock* ngërç i shpeshtë i sistemit.

decision tree përfshin një bashkësi algoritmesh të mësimit automatik që e strukturojnë hapësirën e mundësive në formën e një peme dhe marrin vendime në çdo degëzim të saj për të dhënë parashikimet përfundimtare. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **pemë vendimesh**, si te [45] f. 13.

Deep Learning (shkurt. **DL**) është një drejtimi i inteligjencës artificiale ose më specifikisht mësimit automatik, që kryen parashikime apo analiza inteligjente të të dhënave duke përdorur rrjete nervore artificiale me shumë shtresa, pra të

thellë. Një përkthim të saj e gjejmë te [18] ku jepet në formën të mësuarit në mënyrë të thellë dhe të strukturuar e cila ndoshta qëndron, por nuk është praktike apo e përmbledhur. Propozimi ynë është shprehja **mësim i thellë**.

Deep Machine Learning (shkurt. *DML*) është një paraqitje më e plotë e shprehjes *Deep Learning*, por që në gjuhën angleze përdoret më rrallë. Nisur nga shembujt e shprehjeve më sipër, përkthimi i duhur i saj në gjuhën shqipe do të ishte **mësim automatik i thellë**.

Deep Neural Network (shkurt. *DNN*) është rrjetet nervor me shumë shtresa të vendosura midis hyrjes dhe daljes. Shprehja e duhur në gjuhën shqipe është **rrjetet nervor i thellë**. Shprehja ~~rrjetet i thellë neural~~ që ndeshet te [18] f. 15 nuk përbën një shqipërim të plotë, ndaj sugjerojmë që të shmanget.

deep structured learning është një emërtim tjetër për *Deep Learning* që e vendos theksin te strukturat apo arkitekturat specifike të rrjeteve nervore që përdoren për qëllime apo detyra të ndryshme. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **mësim i thellë dhe i strukturuar**.

default [di'fo:llt] **mb.** vlerë, përcaktim apo mënyrë funksionimi që është **paraprake**, i.e **paracaktuar** siç emërtohet te [23] f. 76. Përkthime të tjera të vlefshme janë edhe i.e **paravendosur**, i.e **vendosur paraprakisht**, bazuar te shpjegimi që jepet te [33] f. 85. Edhe kjo fjalë, që në fakt është e vështirë (sepse përkthimi i duhur varet shumë nga konteksti dhe rasti specifik), nuk para përkthehet, ndaj dëgjojmë shpesh në të folur fjalën ~~default~~ ose e lexojmë të shkruar ~~default~~, si p.sh. te [17] f. 89, te [15] f. 136 etj. Shembuj: *default parameter* parametri paraprak, *default action* veprimi i paracaktuar.

default [di'fo:llt] **ndaj.** njësoj si mbiemri i mësipërm, kjo ndajfolje mund të përkthehet **paraprakisht**, duke shmangur edhe një herë nga përdorimi fjalët ~~default~~, ~~default~~ ose ~~by default~~. Kjo e fundit ndeshet gabimisht në bibliografi, p.sh. te [41] f. 23, te [26] f. 96, te [25] f. 14 etj. Shembuj: *selected by default* përzgjedhur paraprakisht, *set by default* vendosur paraprakisht.

dimensionality reduction përfshin një bashkësi teknikash matematike që bëjnë të mundur transformimin e të dhënave nga paraqitja në një hapësirë shumëpërmasore në një paraqitje tjetër me më pak përmasa. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **reduktim i përmasave**.

drag and drop është veprimi i zhvendosjes së një objekti virtual nga përdoruesi nëpër ekranin e kompjuterit, duke e tërhequr me shenjën e miushit të mbajtur shtypur përmbi të. Një përkthim i thjeshtë (por ndoshta jo i vetmi) për këtë shprehje do të ishte **tërhiq dhe lësho**. Disa shprehje të tjera nga bibliografia si “tërheqja dhe ulja” te [29] f. 17, “tërhiq mausin, duke e mbajtur atë të shtypur” te [31] f. 72, “zhvendos dhe vendos” te [41] f. 23 apo “vendos &

zhvendos” te [26] f. 42 na duken jo të përshtatshme.

drive [draiv] **fol.** kuptimi i përgjithshëm dhe më i zakonshëm i kësaj fjale është ngas, drejtoj (p.sh. një mjet rrugor). Në fushën e teknologjisë së informacionit, përkthimet e duhura që shmangin keqkuptimet janë **pilotoj**, **manovroj**. Shembuj: *drive the disk* pilotoj diskun, *drive the electric current* pilotoj rrymën elektrike.

drive [draiv] **em. p.f.** si emër i referohet një njësie apo pajisjeje fizike të lidhur në një sistem elektronik apo kompjuterik. Emërtimi i duhur në gjuhën shqipe është **njësi**. Fatkeqësisht ndeshim shpesh forma të pasakta apo të papërkthyer si ~~drive~~ te [41] f. 77 dhe te [43] f. 19 ose ~~draiv~~ si te [23] f. 22. Shembuj: *hard disk drive* njësia e diskut të fortë, *shared drive* njësia e përbashkët.

driver [ˈdraivər] **em. s.o.** mekanizëm ose softuer që piloton apo komandon një pajisje fizike. Kjo fjalë për fat të keq nuk përkthehet dhe haset masivisht forma ~~drajver~~ në të folur dhe ~~driver~~ në të shkruar, p.sh. te [29] f. 70, te [19] f. 14 etj. Përkthimi i duhur është **pilot**, **manovrues**. Shembuj: *disk driver* manovruesi i diskut, *printer driver* piloti i gjurmështypësit.

dual-core [ˈdju:əl ko:r] **mb. a.p.** që është i përbërë nga dy bërthama përpunimi, të cilat mund të funksionojnë njëkohësisht dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Kjo fjalë nuk përkthehet fare, pra dëgjojmë shpesh ~~dual-kor~~ dhe lexojmë *dual-core*. Përkthimi i duhur është mbiemri **dybërthamësh** që gjendet në FGJSSH. Mund të përdoret edhe shprehja **me dy bërthama** si te [14] f. 12. Shembuj: *dual-core procesor* procesor dybërthamësh, *dual-core hardware configuration* konfigurim dybërthamësh i harduerit.

duplex [ˈdu:pleks] **mb. tel.** është fjala për linjat e transmetimit që mundësojnë komunikim të dyanshëm, ose për gjurmështypësit që shtypin faqet në të dyja anët e fletës. Kjo fjalë ndeshet shpesh pa ndonjë përshtatje, pra *dupleks* në të folur dhe *duplex* ose *dupleks* në të shkruar, p.sh. te [15] f. 206. Përkthime të mundshme janë **dyanësh**, **dyanësor**. Shembuj: *duplex printer* gjurmështypës dyanësh, *duplex communication line* linjë dyanësore komunikimi.

embedded [imˈbedid] **mb. a.p.** që është fiksuar mirë në një strukturë duke formuar një pajisje apo sistem, pra i referohet sistemeve të përbëra nga pjesë të ndryshme elektronike të fiksuara mirë me njëra-tjetrën. Në përditshmëri kjo fjalë nuk përkthehet dhe qëllon shpesh të dëgjojmë fjalë si *embedid* apo *imbedid* ose të lexojmë *embedded*. Në gjuhën shqipe ky kuptim shprehet mjaft mirë nga mbiemrat i.e **ngulitur** ose i.e **ndërfutur**, siç ndeshen përkatësisht te [20] f. 24 dhe te [14] f. 124. Shembuj: *embedded systems* sistemet e ngulitura, *embedded processor system* sistem me përpunues të ndërfutur.

ensemble learning i referohet një grupi metodash të mësimit automatik

të cilat trajtojnë disa apo shumë modele parashikuese dhe bashkojnë rezultatet e tyre për të marrë parashikime më të sakta se secili parashikim i marë veçmas. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **mësim në ansambël**.

event [i'vent] **em. sh.t.** është fjala për një ngjarje që ndryshon apo përcakton ecurinë e një procesi apo dukurie. Në ligjërimin e përgjithshëm ka kuptimin e aktivitetit ndërsa në atë teknik mbartet mjaft mirë nga fjala **ngjarje**, siç ndeshet te [31] f. 56, te [19] f. 99, te [20] f. 40 etj. Duhet shmangur pra fjala **event**, e cila ndeshet shpesh në gjuhën e folur. Shembuj: *unexpected event* ngjarje e papritur, *system failure event* ngjarje e dështimit të sistemit.

feature selection është procesi që përzgjedh tiparet apo cilësitë më të mira nga një bashkësi të dhënash, të cilat përdoren më pas për të trajnuar modele parashikuese prej atyre të dhënave. Kjo shprehje mund të përkthehet **përzgjedhje e tipareve, përzgjedhje e cilësive**.

fixed access network përfshin një bashkësi rrjetesh telekomunikimi qasje të të cilët kryhet në pika fikse. Duhet bërë kujdes që kjo shprehje të përkthehet **rrjet me qasje fikse**.

file [fail] **em. s.o.** koncept themelor i lidhur me sistemet operative, që i referohet një njësie të emërtuar e cila mban të dhëna të strukturuar rreth një objekti apo entiteti dhe ruhet në një sistem skedarësh. Kjo fjalë është përkthyer tradicionalisht **skedar**, siç ndeshet te [38] f. 50, te [34] f. 56 etj. Vihen re fatkeqësisht mospërkthime, pra ndeshim **file**, p.sh. te [29] f. 52 dhe te [19] f. 64. Ndeshen gjithashtu përshtatje të pjesshme fonetike si **fajll** te [39] f. 2 që e gjykojmë jo të vlefshme, duke qenë se bie në kundërshtim me fjalën **skedar** që është më e hershme dhe më e përhapur në bibliografi. Shembuj: *private file* skedar privat, *binary file* skedar binar, *an image file* një skedar imazhi.

floppy disk i referohet një diskete elastike që përdorej dikur te kompjuterat personal për ruajtje dhe mbartje të informacionit. Këtë shprehje e ndeshim shpesh të papërkthyer, si p.sh. në formën ~~floppy disk~~ te [35] f. 39. Përkthimet disketë dhe disketë e butë që ndeshen te [40] f. 153 dhe [40] f. 184 janë deri diku të pranueshme, por gjykojmë që përkthimi më i plotë është **disketë elastike**.

folder ['fo:lldër] **em. s.o.** tjetër koncept themelor nga sistemet operative, që i referohet një skedari me përmbajtje adresa të skedarëve të tjerë. Nga pikëpamja e përdoruesit paraqitet si një dosje brenda të cilës vendosen dokumente apo objekte të tjera virtuale. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **dosje**, siç shkruhet te [29] f. 20, te [24] f. 58, te [19] f. 53 etj. Vihet re shpesh përtësë në përkthimin e fjalës, pra ndeshim gabimisht **folder** te [26] f. 13, te [41] f. 56, te [19] f. 38 etj. Shembuj: *private folder* dosje private, *shared folder* dosje e bashkëndarë.

foreground ['fo:rgraund] **em. graf.** pjesa e përparme dhe më e dukshme

e një pikturë, imazhi apo mjedisi. Ky kuptim mbulohet fare mirë nga fjalët **ballinë**, **fasadë**, **plan i parë** të cilat gjenden të shpjeguara në FGJSSH dhe mund të përdoren sipas rastit. Duhet të shmangët pra, fjala angleze *foreground* e cila ndeshet p.sh. te [31] f. 71. Shembuj: *foreground view* pamja e planit të parë, *image foreground* ballina e imazhit.

frame [freim] **em. sh.t.** fjalë me disa kuptime të cilat varen nga konteksti dhe rasti konkret i përdorimit. Kur është fjala për rifreskimin e pamjeve në ndonjë ekran ose për ndër pamje që skicohen me programe grafike, kjo fjalë duhet përkthyer **kuadro**, siç gjendet te [44] f. 7, te [31] f. 96 etj. Kur është fjala për njësi diskrete informacioni që transmetohen në rrjet, mund të përdoret fjala **kornizë** e cila gjendet te [14] f. 112. Duhet shmangur në çdo rast forma e papërkthyer *frame* që ndeshet te [30] f. 38, te [19] f. 36 etj. Shembuj: *retransmission of lost frames* ritransmetimi i kornizave të humbura, *frame refresh rate* shpejtësia e rifreskimit të kuadrove.

Generative Adversarial Network (shkurt. **GAN**) përfshin një klasë modelesh të mësimin automatik të përbërë nga dy rrjete nervore të cilët i kundërvihen njëri-tjetrit. Njëri prej tyre i quajtur gjeneruesi mëson nga një bashkësi trajnimit për të prodhuar kampione të dhënash në dukje sa më autentike. Rrjeti tjetër i quajtur diskriminuesi përpiket të dallojë nëse kampionet e të dhënave që jep gjeneruesi janë sintetike (artificiale) apo autentike (origjinale). Edhe kjo shprehje nuk haset shpesh, për shkak se është shumë specifike dhe e viteve të fundit. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe do të ishte **rrjet gjenerues kundërvënës**, siç ndeshet te [18] f. 138.

handle [ˈhendəl] **fol.** veprimi i zgjidhjes së një problemi apo trajtimit të një çështjeje. Përkthimi i duhur është **trajtoj**, siç ndeshet në raste të ndryshme te [21], te [40] etj. Shembuj: *handle the interrupt* trajtoj ndërprerjen, *handle a system call* trajtoj një thirrje sistem.

handler [ˈhendlɚ] **em.** njësia, metoda apo programi përgjegjës për të kryer punë apo për të trajtuar ngjarje ose probleme të ndryshme. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **mbarëvajtës**, **trajtuës**, siç ndeshet te [20] f. 40. Shembuj: *event handler* trajtuës i ngjarjeve, *disk handler* mbarëvajtësi i diskut.

handling [ˈhændɪŋ] **em.** emri foljor që lidhet me veprimin e foljes më sipër. Përshtatja e duhur është **mbarëvajtje**, **trajtim**, siç ndeshet te [21]. Shembuj: *event handling* trajtimi i ngjarjeve, *disk handling* mbarëvajtja e diskut.

hard-copy [ˌhɑːrdˈkopi] **em.** kjo fjalë haset gjithashtu në format *hardcopy*, *hard copy* dhe si emër nënkupton një kopje fizike të një dokumenti, libri apo objekti tjetër digjital, zakonisht të shtypur në letër. Haset masivisht e papërkthyer, pra ndeshim shpesh ~~hard-copy~~ edhe në gjuhën shqipe. Sugjerojmë që

kjo fjalë të përkthehet **kopje e shtypur** kur është fjala për dokumente, libra apo objekte që shtypen në letër. Për objekte të tjera fizike mund të përkthehet **kopje fizike**. Përkthimi “kopje e fortë” që ndeshet te [15] f. 47 nuk na duket i përshtatshëm. Shembuj: *send the hardcopy by mail* dërgoje kopjen fizike me postë, *hard-copy delivery* shpërndarje e kopjes fizike.

hard-copy [,ha:rd'kopi] **mb.** si mbiemër nënkupton cilësinë e të qenit fizik apo në trajtë materiale, veçanërisht për objektet që paraqiten edhe në version digjital. Sugjerojmë që të përkthehet i,e **shtypur, fizik**. Shembuj: *hard-copy manual* udhëzues i shtypur, *hard-copy version* versioni fizik.

hard disk që ndeshet edhe *hard-disk* është pajisje që shërben si kujtesë dytësore dhe ruan në mënyrë të përhershme të dhënat në sistemet kompjuterike. Na ndodh shpesh ta ndeshim të papërkthyer, pra në format ~~hard-disk~~ ose ~~hard-disk~~, jo vetëm në ligjërimin bisedor, por edhe në tekste si te [35] f. 58, te [17] f. 7, te [43] f. 10 etj. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **disk i fortë, disk i ngurtë** që përdoren saktësisht te [40] f. 153, te [19] f. 116 etj.

high-definition [,hai:de:fi'nishën] **mb. graf.** fjalë që i referohet kryesisht cilësisë së figurës (por ndonjëherë edhe zërit) në pajisjet elektronike të viteve të fundit si dhe transmetimeve me atë cilësi. Në shumicën e rasteve kjo fjalë nuk përkthehet, pra edhe në gjuhën shqipe haset ~~high-definition~~. Në disa raste haset përkthimi i gabuar me ~~definicion të lartë~~. Përkthimi i saktë është **me qartësi të lartë**. Shembuj: *high-definition transmission* transmetim me qartësi të lartë, *high-definition screen* ekran me qartësi të lartë, *high-definition video* video me qartësi të lartë, *high-definition sound* zë me qartësi të lartë.

hub [hab] **em. rrj.** pikë qendrore në një rrjet me topologji yll në të cilën kryhet ndërlidhja midis të gjitha pikave të tjera të rrjetit. Kjo fjalë nuk përkthehet, ndaj në gjuhën e folur dëgjojmë shpesh ~~hæb~~ dhe në tekste ndeshim ~~hæb~~, p.sh. te [17] f. 82, te [19] f. 19 etj. Përkthimi i duhur në është **vatër, qendër**. Shembuj: *a network hub* një vatër rrjeti, *the hub is off* vatra është e fikur.

insert [in'sært] **fol.** kuptimi më i zakonshëm i kësaj fjale është **fut, ndërfit**. Disa forma të papërkthyer si ~~insertøj~~ që ndeshen te [37] f. 44, te [39] f. 12 etj. janë fare të panevojshme dhe madje qesharake. Shembuj: *insert an element in the stack* fut një element në stivë, *insert the packages at the head of the source file* futi paketat te kreu i skedarit burimor.

interrupt [,intë'rapt] **em. sh.t.** veprim i sinjalizimit të nevojës për të trajtuar një problem apo ngjarje në sistem. Kjo fjalë duhet përkthyer **ndërprerje**, siç ndeshet te [21] f. 65, te [14] f. 22 etj. Forma e papërkthyer ~~interrupt~~ duhet shmangur. Shembuj: *interrupt handler* trajtuesi i ndërprerjeve, *interrupt request* kërkesë për ndërprerje.

job [xhob] **em. s.o.** një bashkësi programesh dhe të dhënash që përpunohen, të cilat ekzekutohen nga sistemi kompjuterik për të përmbushur një qëllim të caktuar. Edhe kjo fjalë nuk përkthehet në shumë raste, duke u shkruar ~~жоб~~ ose ~~јоб~~. Përkthimi i duhur është **punë, detyrë**. Shembuj: *job monitoring* mbikëqyrje e punëve, *user jobs* punët e përdoruesit.

joystick [ˈxhoi, stik] **em. p.f.** pajisje që përdoret për të komanduar kursorin apo ndonjë element grafik në ekran, veçanërisht në sistemet e lojërave elektronike. Sugjerojmë që kjo fjalë të mos përdoret si në gjuhën angleze por të përkthehet **dorezë, levë**, siç gjendet te [23] f. 29, te [15] f. 45 etj. Shembuj: *joystick gaming system* sistem lojërash me doreza, *broken joystick* levë e thyer.

layout [ˈlei, aut] **em. 1) graf.** pamje skematike e parë nga sipër që tregon shpërndarjen apo vendosjen e elementeve në një objekt apo pajisje. Sugjerojmë që kjo fjalë të përkthehet **planvendosje, planpamje** sipas rastit të përdorimit. Duhet të shmanget në çdo rast fjala e papërkthyer *layout*. Shembuj: *keyboard layout* planpamje e tastierës, *motherboard layout* planvendosje e pllakës amë.

layout [ˈlei, aut] **em. 2) graf.** në këtë kuptim i referohet mënyrës së vendosjes së faqeve njëra pas tjetrës në një libër. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **faqosje** si te [24] f. 72, te [21] f. 145, te [29] f. 6 etj. Përkthimi ~~faqe e rregulluar~~ që ndeshet te [38] f. 52 nuk na duket i përshtatshëm. Shembuj: *book layout* faqosje e librit, *standard layout* faqosje standarde.

logistic regression teknikë parashikimi që modelon probabilitetin e një ngjarjeje bazuar te kampionët e një bashkësie të dhënash me të cilat ajo ngjarje lidhet. Përkthimi i duhur është **regres logjistik** që ndeshet te [45] f. 31.

Machine Learning (shkurt. **ML**) është degë e inteligjencës artificiale e cila ndërton programe apo modele që mësojnë të japin parashikime gjithnjë e më të sakta nga përvoja, të dhënat apo shembujt me të cilët trajnohen. Kjo shprehje po haset pa përkthim nëpër shkrime, artikuj, tema diplomash etj. Te [18] f. ndeshet e përkthyer në formën të mësuarit automatik e cila qëndron por nuk është praktike apo e përmbledhur. Propozimi ynë është shprehja **mësim automatik**, siç ndeshet te [45] f. 13.

Machine Translation (shkurt. **MT**) i referohet një dege të inteligjencës artificiale dhe gjuhësisë kompjuterike që zhvillon modele inteligjente për përkthime automatike të teksteve nga një gjuhë njerëzore në një tjetër. Përkthimi i saktë i saj në gjuhën shqipe është **përkthim automatik** dhe ndeshet te [18] f. 20.

malicious [məˈlishës] **mb. sig.** fjalë që përdoret veçanërisht në fushën e sigurisë kompjuterike për të cilësuar viruset dhe programet apo përdoruesit që sulmojnë sistemet dhe rrjetet. Mund të përkthehet **keqdashës** ose **dashakeq**. Shembuj: *malicious software* softuer keqdashës, *malicious network activity*

aktivitet keqdashës në rrjet.

motherboard [ˈmadhërbo:rd] **em. p.f.** struktura e një kompjuteri në të cilën nguliten apo vendosen pjesë të ndryshme si mikroprocesori, kujtesa dhe pajisje të tjera periferike duke u lidhur me linjat komunikuese. Në shumicën e rasteve kjo fjalë nuk përkthehet, pra ndeshim **motherboard** si te [41] f. 10, ose **matherboard** si te [23] f. 9. Dy përkthime të mundshme janë **pllaka amë** ose **bordi mëmë** që ndeshet te [23] f. 14. Shembuj: *this motherboard price is very high* çmimi i kësaj pllake amë është shumë i lartë, *asiatic motherboard manufacturers are very successful* fabrikuesit aziatikë të bordeve mëmë janë shumë të suksesshëm.

mouse [maus] **em. p.f.** pajisje elektronike që lidhet me kompjuterin dhe rrëshqitet në një sipërfaqe të rrafshhtë për të komanduar shënjesin në dritaret grafike me të cilat ndërvepron përdoruesi. Kjo fjalë përkthehet **miush** dhe fatmirësisht ka hyrë së fundmi me këtë kuptim edhe në FGJSSH. Fatkeqësisht, në të folurën e përditshme dhe në bibliografi mbizotëron fjala angleze **mouse** të cilën e gjejmë te [38] f. 20, te [17] f. 9, te [41] f. 6 etj. Edhe përkthimi **miu** që ndeshet te [23] f. 14, te [15] f. 45, te [39] f. 3 etj. nuk është i përshtatshëm. Shembuj: *optical mouse* miush optik, *laser mouse* miush me lazer.

multitasking [ˌmalltiˈta:sking] **mb. s.o.** sistem kompjuterik që mundëson ekzekutimin e njëkohshëm të shumë punëve në formë pseudoparalelizmi ose paralelizmi real. Sugjerojmë **shumëpunësh** si përkthim të përshtatshëm. Shembuj: *Unix systems are multitasking* sistemet Unix janë shumëpunësh, *multitasking computation platform* platformë përlllogaritëse shumëpunëshe.

namespace [ˌnejmˈspejs] **em. prog.** bashkësi emrash që formohen nga një alfabet sipas disa rregullave të caktuara dhe që përdoren për të emërtuar objekte të të njëjtit tip. Edhe kjo fjalë shpesh nuk përkthehet. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **hapësirë emërtimesh**, **hapësirë emrash**. Shembuj: *variable namespace* hapësira e emërtimeve të ndryshoreve, *function namespace* hapësira e emrave të funksioneve.

nest [nest] **fol. prog.** në kontekstin e programimit, vendos një strukturë apo bllok një nivel më poshtë (ose më në brendësi) një strukture apo blloku të ngjashëm. Sugjerojmë që kjo folje të përkthehet **ndërfut**, **nënvendos**. Shembuj: *nest a block of code* ndërfut një bllok kodi, *nest a for loop* ndërfut një cikël for.

nested [nestid] **mb. prog.** strukturë apo bllok i vendosur një nivel më poshtë (ose më në brendësi) një strukture apo blloku të ngjashëm. Njësoj si më sipër, për këtë mbiemër sugjerojmë përkthimin i,e **nënvendosur**, i,e **ndërfutur** që ndeshet te [29] f. 34, te [14] f. 45 etj. Mbiemri i,e ndërthurur që ndeshet te [34] f. 63 dhe te [39] f. 151 nuk na duket bindës, sepse jep idenë sikur kombinohen struktura të ndryshme. Edhe varianti i,e shtërënguar që ndeshet te [15] f. 103 duket jo i

qartë. Shembuj: *nested block of code* bllok i ndërfutur kodi, *nested for loop* cikël for i ndërfutur.

network [ˈnetuë:rk] **em. rrj.** shpreh konceptin e rrjetit në përgjithësi dhe atë kompjuterik në shumicën e rasteve. Shpeshherë nuk përkthehet dhe shkruhet *network*, p.sh. te [29] f. 52, te [41] f. 71 etj. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **rrjet**, **rrjeti**, **rrjete**, **rrjetet** që ndeshet p.sh. te [19] f. 161 dhe te [20] f. 15. I dhamë të katërta format e emrit, sepse ndodh shpesh që të përdoret gabimisht fjala *rrjetë*, *rrjeta*, *rrjetat* që ndeshet p.sh. te [32] f. 12, te [24] f. 82, te [22] f. 96 etj. Kjo fjalë përfaqëson emra të tjerë (rrjeta e peshkatarit, merimangës, etj.) dhe nuk ka lidhje me fjalën angleze *network*. Shembuj: *computer network* rrjet kompjuterik, *network communication* komunikim në rrjet.

networking [ˈnetuë:rking] **em. rrj.** shpreh lidhje të njësive për të komunikuar me njëra-tjetrën ose njohje të njerëzve nëpër rrjete shoqërore. Kjo fjalë mund të përkthehet **lidhje në rrjet** ose **rrjetëzim** si te [21] f. 172. Shembuj: *networking software* softuer rrjetëzimi, *professional networking platform* platformë për rrjetëzim profesional.

network security vulnerability që i referohet ndonjë dobësie në rrjet, e cila mund të bëhet shkak për thyerje të sigurisë. Përkthimi i duhur për këtë shprehje është **dobësi e sigurisë së rrjetit**.

Neural Network (shkurt. **NN**) i referohet një strukture nyjash të vendosura në shtresa të njëpasnjëshme dhe lidhjesh midis tyre, që përdoret për trajnimin e modeleve parashikuese. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **rrjet nervor** si te [45] f. 15. Përkthimi *rrjet neural* që ndeshet te [18] f. 13 nuk është i shqipëruar mirë dhe duhet shmangur.

newsletter [ˈnju:zletër] **em.** raport me lajme mbi veprimtaritë e një klubi apo organizate që u dërgohet rregullisht të gjithë anëtarëve të saj. Kjo fjalë nuk po përkthehet vitet e fundit, ndaj po dëgjojmë shpesh *njuzletër*. Sugjerojmë që të përdoret fjala tradicionale **buletin**. Shembuj: *subscribe to our newsletter* pajtohu te buletini ynë, *newsletter of electronics* buletini i elektronikës.

newsroom [ˈnju:zru:m] **em.** zyra e një gazete, radioje apo stacioni televiziv ku merren lajme, të cilat më pas përgatiten për shtyp ose për transmetim publik. Edhe kjo fjalë nuk po përkthehet vitet e fundit, ndaj po dëgjojmë shpesh *njuzrum*. Sugjerojmë që të përdoret fjala tradicionale **redaksi**. Shembuj: *public television newsroom* redaksia e televizionit publik, *weekly newsroom publication* publikim javor i redaksisë.

outline [ˈautlajn] **em.** një kuptim është paraqitja e përmbledhur dhe me pikat kyçe të një diskutimi apo kumtese. Fjala e duhur shqipe është **përvijim** e cila gjendet e sqaruar saktë te [24] f. 72. Te [31] f. 87 e ndeshim pa përkthim

në formën *outline* ndërsa te [24] f. 23 përkthehet gabimisht *kontur*. Shembuj: *presentation outline* përvijim i prezantimit, *grafical outline* përvijim grafik.

output ['autput] **em.** kjo fjalë ka përkthime të ndryshme sipas rastit të përdorimit, por më të zakonshmet janë **dalje**, **rezultat** dhe **prodhim**. Në bibliografi gjejmë përkthime qesharake si *autput* që ndeshet te [31] f. 52 dhe [31] f. 63. Në këto dy raste, përkthimet e sakta do të duhet të ishin përkatësisht **dalje** dhe **rezultat**. Shembuj: *device output* dalja e pajisjes, *arithmetic operation output* rezultati i veprimit aritmetik.

overload [,ëuvër'lëud] **fol. sh.t.** ngarkoj më shumë se norma një njësi informacioni apo përpunimi, çka mund të çojë në humbje të dhënash ose në një mosfunksionim të përshtatshëm të sistemit. Këtë folje ndodh ta dëgjojmë të papërkthyer, pra *overload*. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **mbingarkoj**. Shembuj: *do not overload the disks* mos i mbingarko disqet, *overload the memory only if necessary* mbingarkoje kujtesën vetëm nëse është e domosdoshme.

overloading [,ëuvër'lëuding] **em. sh.t.** në përgjithësi i referohet ngarkimit më shumë se norma të një njësie informacioni apo përpunimi, sipas foljes më sipër. Edhe këtë fjalë ndodh ta dëgjojmë si në anglishte, pra *overloading*. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **mbingarkim**, **mbingarkesë**. Edhe fjala **tejnarkim** që ndeshet te [27] f. 287 është e pranueshme. Shembuj: *avoid memory overloading* shmangni mbingarkimin e kujtesës, *system overload prevention policy* politika e parandalimit të mbingarkesës së sistemit.

overwrite [,ëuvër'rait] **fol.** shkruaj informacion në një njësi mbajtëse, duke prishur apo asgjësuar informacionin e mëparshëm që gjendej në të. Kjo folje ka përdorime në kontekste të shumta, por shpesh dëgjohet *overrajt* ose lexohet *overwrite* si në gjuhën angleze. Përkthimi i duhur i saj është **mbishkruaj**, siç ndeshet te [15] f. 29. Shembuj: *overwrite the text file* mbishkruaj skedarin tekst, *overwrite the register* mbishkruaj regjistrin.

password ['pasuë:rd] **em. sig.** varg shkronjash, numrash apo simbolesh të tjera që mbahet i fshehtë dhe bën të mundur identifikimin e përdoruesit në sisteme apo rrjete të ndryshme informacioni. Hyn te ato fjalë që dikur përktheheshin, por sot nuk po përkthehen nga përtacia, ndaj dhe po dëgjojmë shpesh *pasuord*. Sugjerojmë që të përdoret rregullisht fjala shqipe **fjalëkalim** që ndeshet te [24] f. 38, te [24] f. 84 etj. Shembuj: *user password* fjalëkalim i përdoruesit, *strong password* fjalëkalim i fortë, *weak password* fjalëkalim i dobët.

patch [peç] **em. i.s.** ndryshim në kodin e një softueri për të korrigjuar ndonjë gabim apo për të përmirësuar ndonjë funksion. Edhe kjo fjalë qëllon shpesh të mos përkthehet dhe dëgjojmë shqiptime të ndryshme si *paç* apo *peç*. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **arnë**, **pullë**, **korrigjim**. Shembuj: *important*

security patch arnë e rëndësishme sigurie, *system security patches are mandatory* arnat e sigurisë së sistemit janë të detyrueshme.

patch [peç] **fol. i.s.** kryej një ndërhyrje në kodin e një softueri për të korigjuar gabime që lidhen me sigurinë apo funksionet e tij. Sugjerojmë që të përdoren përkthimet **arnoj**, **korigjoj**. Shembuj: *patch a security breach* arnoj një të çarë sigurie, *patch the graphics module* arnoj modulën e grafikës.

patching [’peçing] **em. i.s.** në këtë rast kemi të bëjmë me emrin foljor, pra veprimin sipas foljes më sipër. Sugjerojmë që kjo fjalë të përkthehet **arnim**, **korigjim**. Shembuj: *software patching is not an easy proces* arnimi i softuerit nuk është një proces i lehtë, *periodic software patching is important* arnimi periodik i softuerit është i rëndësishëm.

point-to-point [point,tu,point] **ndajf. sh.t.** lidhje komunikimi direkte midis dy nyjave apo entiteteve komunikuese. Kjo fjalë nuk po përkthehet, sidomos në gjuhën e folur. Dëgjojmë shpesh të thuhet ~~point-tu-point~~ dhe të shkruhet ~~point-to-point~~. Përkthimi i duhur është **pikë-me-pikë**, siç ndeshet saktësisht te [22] f. 112 dhe te [23] f. 153. Shembuj: *point-to-point interconnection* ndërlidhje pikë-me-pikë, *point-to-point protocol* protokoll pikë-me-pikë.

pointer [’pointër] **em. graf.** element grafik që përdoret për të shënjuar objekte në ekran ose vlerë që tregojnë adresën e një ndryshoreje apo strukture të dhënash në kujtesë. Kjo fjalë nuk përkthehet në asnjë nga dy kuptimet, ndaj dëgjojmë shpesh ~~pointer~~ në gjuhën e folur dhe lexojmë ~~pointer~~ në bibliografi, p.sh. te [15] f. 153. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **shënjuës** për secilin rast dhe gjendet te [40] f. 32. Duhet bërë kujdes të shmangët fjala *shënjuës* e cila përfaqëson një koncept tjetër dhe ndeshet gabimisht te [34] f. 88, te [21] f. 61 etj. Shembuj: *calibrate the mouse pointer* kalibro shënjuësin e miushit, *a pointer of four bytes* një shënjuës prej katër bajtesh.

preview [’pri:vju:] **em. graf.** shfaqje e pamjes apo e karakteristikave të tjera të një entiteti përpara përpunimit, shtypjes, emetimit apo hedhjes së tij në treg. Mospërkthimi i kësaj fjale bën që të dëgjojmë shpesh të thuhet ~~privju~~. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **parashfaqje**, **parapamje**. Në bibliografi ndeshet e përkthyer në forma të ndryshme si “shikim para shtypjes” te [35] f. 103, “shikim paraprak” te [38] f. 52 apo “shikim” te [25] f. 76, të cilat edhe pse jo të gabuara, nuk janë shumë të qarta. Shembuj: *print preview* parachfaqje e shtypjes, *preview of the product prototype* parapamje e prototipit të produktit.

preview [’pri:vju:] **fol. graf.** folje që shpreh veprimin e shfaqjes paraprake të një entiteti përpara përpunimit, shtypjes, emetimit apo hedhjes në treg. Njësoj si më sipër, edhe për foljen dëgjojmë të thuhet ~~privju~~ ose ~~bëj-privju~~. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **parashfaq**. Shembuj: *preview the*

document before printing parashfaq dokumentin përpara shtypjes, *preview the final model* parashfaq modelin përfundimtar.

qualitative ['kuolitëtiv] **mb. sh.t.** që lidhet me vlerën apo cilësinë e diçkaje, pra duhet përkthyer **cilësor** në çdo rast. Fjala **kualitativ** që ndeshet te [29] f. 51, te [15] f. 187 etj. duhet shmangur. Shembuj: *qualitative product analysis* analiza cilësore e produktit, *qualitative differences* dallime cilësore.

quantitative ['kuontitëtiv] **mb. sh.t.** që lidhet me sasinë e diçkaje, pra duhet përkthyer **sasior** në çdo rast. Fjala **kuantitativ** duhet shmangur. Shembuj: *quantitative analysis* analiza sasiore, *quantitative differences* dallime sasiore.

random ['rëndëm] **mb. sh.t.** entitet apo proces pa ndonjë rend të paracaktuar apo që ndodh në mënyrë të çrregullt dhe të papërsëritshme. Ndeshet shpesh e papërkthyer dhe dëgjojmë **rëndëm**, ndërkohë që fjalët përkuese janë **rastësor**, **i rastësishëm**, **i rastit**. Shembuj: *random number* numër i rastit, *random sampling* kampionim i rastësishëm, *random variable* ndryshore e rastit.

random forest përfaqëson një bashkësi teknikash të mësimit të mbikëqyrrur që bashkojnë parashikimet e shumë pemëve të vendimeve për të arritur një parashikim të përgjithshëm me një saktësi më të lartë. Përkthimi i duhur për këtë shprehje është **pyll rastësor**.

Recurrent Neural Network (**shkurt. RNN**) është familje rrjetesh nervore me lidhje midis nyjave që formojnë një graf përgjatë një vargu kohor. Përkthimi i duhur për këtë shprehje është **rrjet nervor rekurent**.

redundancy [ri'dandënsi] **em. sh.t.** caktim mbi masën e domosdoshme të një-sive përlllogaritëse apo mbajtëse në një sistem me qëllim shmangien e gabimeve, defekteve apo keqfunksionimit. Një formë pa përkthim është **redundancë** që ndeshet te [36] f. 110 dhe duhet shmangur në çdo rast. Përkthimi i duhur është **tepri**, **tepricë**, siç ndeshet te [28] f. 8, te [14] f. 84 etj. Fjala bollëk që haset te [18] f. 70 nuk është e gabuar, por paraqitet jo shumë e përshtatshme për ligjërimin teknik, duke pasur parasysh kuptimin e përgjithshëm të saj. Shembuj: *memory redundancy* tepria e kujtesës, *redundancy check* kontrolli i tepricës.

redundant [ri'dandënt] **mb. sh.t.** që jepet në një masë më të madhe sesa duhet, pra që përfshin përsëritje. Edhe kjo fjalë rastis të mos përkthehet dhe të shkruhet **redundant**, p.sh. te [36] f. 110. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është mbiemri i.e **tepërt**. Shembuj: *redundant records* regjistrime të tepërta, *redundant list elements* elemente të tepërta në listë.

Reinforcement Learning (**shkurt. RL**) përfshin teknika të inteligjencës artificiale që trajnojnë agjentë softuer për të marrë vendime të mençura dhe për të optimizuar detyra. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe për këtë shprehje është **mësim përforcues** dhe ndeshet te [45] f. 17. Shprehja të mësuarit e përforeuar

që ndeshet te [18] f. 36 është disi e paqartë, ndaj sugjerojmë që të shmanget.

refresh [ri'fresh] **em. sh.t.** përditësim i vazhdueshëm i gjendjes së një sistemi për të garantuar funksionimin e tij brenda parametrave të duhur. Edhe kjo fjalë nuk përkthehet thujtë asnjëherë, ndaj dëgjojmë të thuhet ~~rifresh~~ edhe në gjuhën shqipe. Përkthime të mundshme janë **freskim**, **rifreskim**, **përtëritje** që gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH. Shembuj: *high screen refresh rate* shpejtësi e lartë rifreskimi e ekranit, *refresh of memory cell charges* përtëritje e ngarkesave në qelizat e kujtesës.

refresh [ri'fresh] **fol. sh.t.** përditësoj gjendjen e një sistemi për të garantuar funksionimin e tij brenda parametrave të duhur. Edhe për foljen dëgjojmë të thuhet ~~bëj-rifresh~~ në vend që të përkthehet **freskoj rifreskoj**, **përtërij**. Shembuj: *refresh the knowledge base* rifreskoj bazën e njohurive, *refresh the web page* rifreskoj faqen ueb.

remote [ri'mëut] **mb. sh.t.** që ndodhet në largësi të madhe nga një sistem tjetër, me të cilin komunikon apo ndërvepron. Nuk ka asnjë arsye që kjo fjalë të mos përkthehet, pra nuk duhet të përdoret fjala ~~remote~~ edhe në gjuhën shqipe. Mbiemri i.e **largët** e zëvendëson atë më së miri. Shembuj: *remote connection* lidhje e largët, *remote processing capacities* kapacitete të largëta përpunimi.

remotely [ri'mëutli] **ndajf. sh.t.** ndajfolja mbart kuptim të ngjashëm me atë të mbiemrit më sipër, pra cilëson një aktivitet që kryhet në largësi të madhe nga njësia në të cilën veprohet. Përsëri duhet shmangur fjala e huaj **remotely** me përkthimin e saktë në gjuhën shqipe, që është **nga larg**, **së largmi**. Shembuj: *remotely controlled* i kontrolluar nga larg, *work remotely* punoj nga larg.

research ['ri:së:rç] **em.** kjo është fjalë e ligjëritimit të përgjithshëm që ka të bëjë me veprimtarinë hulumtuese, studimore apo kërkimore. Fatkeqsisht nuk përkthehet në shumicën e rasteve, pra dëgjojmë edhe në gjuhën shqipe *risërç*. Propozimi ynë është që kjo fjalë të përkthehet **hulumtim**, **punë hulumtuese**. Shembuj: *research work* punë hulumtuese, *strategic research direction* drejtim strategjik i hulumtimit.

research ['ri:së:rç] **fol.** kryej hulumtim, kërkim apo studim të kujdesshëm për një çështje, temë apo drejtim. Sugjerojmë që kjo folje të përkthehet **hulumtoj**, **kryej hulumtim**. Shembuj: *research on a new topic* hulumtoj në një temë të re, *we do research on computational linguistics topics* ne hulumtojmë tema të gjuhësisë kompjuterike.

researcher ['ri:së:rçër] **em.** personi që kryen veprimtari hulumtuese. Po e hasim të papërkthyer, pra dëgjojmë *risërçër*. Sugjerojmë që të përkthehet **hulumtues** duke plotësuar familjen e fjalëve, bashkë me foljen dhe emrin më sipër që gjenden të gjitha në FGJSSH. Shembuj: *computational linguistics researcher*

hulumtues i gjuhësisë kompjuterike, *renowned researcher* hulumtues i njohur.

review [ri'vju:] **fol. 1)** kryej vlerësimin e një vepre artistike, punimi shkencor etj., por vitet e fundit edhe produkti apo shërbimi në internet, duke vënë në dukje të mirat dhe të metat. Kjo fjalë ka filluar të mos përkthehet, pra dëgjojmë shpesh *ri'vju* edhe në gjuhën shqipe. Përkthimi i duhur është fjala **recensoj** që gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *review a scientific paper* recensoj një artikull shkencor, *review the theatre play* recensoj pjesën teatrore.

review [ri'vju:] **em. 1)** veprimi sipas kuptimit të parë të foljes *review* dhënë më sipër, pra vlerësim kritik me shkrim për një punim shkencor, vepër artistike, shfaqje, produkti të blerë në internet etj. Njësoj si folja, edhe ky emër vazhdon të mos përkthehet. Përkthimi i duhur është fjala **recensim**. Shembuj: *the review process takes time* procesi i recensimit kërkon kohë, *the article review will be finished soon* recensimi i artikullit do të përfundojë së shpejti.

review [ri'vju:] **em. 2)** rezultati i procesit të recensimit që paraqitet si një vlerësim kritik i një artikulli, libri, vepre arti, produkti të blerë në internet etj., i shkruar në një dokument, libër, apo si koment dhe vlerësim me pikë. Fjalët e duhura për këtë kuptim janë **recensë**, **recension** që gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH. Ndodh që kjo fjalë të mos njihet dhe në vend të saj të ndeshim shpjegime të konceptit me shprehje të gjata dhe të papërshtatshme si “analizat online të përdoruesve”, p.sh. te [25] f. 55. Shembuj: *a highly positive review* një recension shumë pozitiv, *the novel review was objective and fair* recensa e romanit ishte objektive dhe e drejtë.

review [ri'vju:] **fol. 2)** kryej një analizë dhe shqyrtim të hollësishëm të karakteristikave dhe të funksioneve të një malli, produkti, shërbimi, etj. Ky kuptim i fjalës është disi i ngjashëm me atë më sipër, por ka të bëjë më shumë me produktet apo pajisjet që blihen. Përkthimet e duhura janë **shqyrtoj**, **rishqyrtoj**, **inspektoj** që gjenden në FGJSSH dhe mund të përdoren sipas rastit. Shembuj: *review a new computer model* shqyrtoj një model të ri kompjuteri, *review the device in details* shqyrtoj në detaje pajisjen.

review [ri'vju:] **em. 3)** ky kuptim i tretë i emrit lidhet me kuptimin e dytë të foljes, pra nënkupton një analizë apo shqyrtim të detajuar të një malli, produkti, shërbimi, apo edhe të ndonjë dokumenti a të literaturës së një fushe të caktuar. Përkthimet e duhura janë emrat **shqyrtim**, **rishqyrtim**, **inspektim**. Shembuj: *review of a new computer model* shqyrtim i një modeli të ri kompjuteri, *bibliography review* shqyrtim i bibliografisë.

run [ran] **fol. prog.** ekzekutoj një program, softuer, komandë etj. në një sistem kompjuterik. Kjo fjalë shpesh nuk përkthehet, ndaj dëgjojmë shtrembërime si *jepi ran* apo *ranøje*. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **ekzekutoj**.

Shembuj: *run a command* ekekutoj një komandë, *run the programs in paralel* ekzekutoj programet paralelisht.

run [ran] **em. prog.** interpretim i instruksioneve të një programi apo softueri nga sistemi kompjuterik. Edhe në këtë rast duhen shmangur fjalët ~~ran~~ apo ~~ranim~~ dhe të përdoret përkthimi i saktë **ekzekutim**. Shembuj: *run time* koha e ekzekutimit, *dry run* ekzekutim provë.

scroll bar është element i rëndësishëm i dritareve grafike që i mundëson përdoruesit të zhvendoset vertikalisht apo horizontalisht përgjatë dritares. Fjala e duhur në këtë rast është **ashensor** dhe ndeshet te [35] f. 57, te [22] f. 6 etj.

security breach dobësi në një sistem apo rrjet që mund të bëhet shkak për thyerje të sigurisë. Përkthimi i duhur është **vrinë sigurie, çarje sigurie**.

semi-supervised learning përfshin një bashkësi metodash të mësimin automatik të cilat trajnohen për të kryer parashikime duke përdorur si të dhëna të etiketuara edhe të dhëna të paetiketuara. Shprehja e duhur në gjuhën shqipe është **mësim gjysmë i mbikëqyrur** dhe ndeshet te [45] f. 14.

sequence-to-sequence [ˈsi:kuəns,tu,sɪ:kuəns] **adv. sh.t.** që funksionon duke çiftuar vargje njësisht nga një domen me vargje përkatëse nga një domen tjetër. Sugjerojmë që kjo fjalë të përkthehet **varg-me-varg**. Shembuj: *sequence-to-sequence learning model* model i mësimin varg-me-varg, *sequence-to-sequence matching* përputhje varg-me-varg.

setup [ˈsetap] **fol. 1) sh.t.** rregulloj apo përshtat sipas nevojave specifitime të ndryshme të një sistemi, programi etj. Kjo folje shpesh nuk përkthehet dhe shprehet me shprehje si bëj-~~setap~~. Një fjalë e përshtatshme për shumë raste përdorimi është **ujdis**, fjalë që gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *setup the printing specifications* ujdís specifikat e shtypjes, *setup the system configurations* ujdís konfigurimet e sistemit.

setup [ˈsetap] **em. 1) sh.t.** procesi i lidhjes, vendosjes apo përshtatjes së një programi, pajisjeje apo moduli tjetër në një sistem kompjuterik apo më gjerë. Edhe ky emër nuk po përkthehet, ndaj dëgjojmë shpesh ~~setap~~. Përdoren sipas rastit edhe fjalë të tjera të paqarta si krijimi, ngritja, p.sh. te [35] f. 106. Përkthimi i duhur do të ishte **ujdisje**. Shembuj: *system configuration setup* ujdísja e konfigurimit të sistemit, *default setup* ujdísja paraprake.

setup [ˈsetap] **fol. 2) sh.t.** folje që shpreh veprimin e instalimit apo vendosjes së një pjese fizike ose të një moduli softuer në një sistem më të madh fizik apo në një sistem kompjuterik. Fjala më e përshtatshme për këtë folje është **instaloj**. Shembuj: *setup a program* instaloj një program, *setup the Python interpreter* instaloj interpretuesin e Python-it.

setup [ˈsetap] **em. 2) sh.t.** emri foljor që lidhet me kuptimin e dytë të foljes

që u sqarua më sipër. Edhe në këtë rast ndeshim shpesh formën **setap**, ndërkohë që përkthimi i duhur do të ishte **instalim**. Shembuj: *the operating system setup takes a long time* instalimi i sistemit operativ kërkon shumë kohë, *the setup is fast* instalimi është i shpejtë.

setup [ˈsetap] **em. 3)** i.s. ky kuptim i emrit lidhet me një skedar që përdoret posaçërisht për të instaluar një program në një sistem kompjuterik. Përkthimi i duhur është **skedar instalimi**. Shembuj: *download the setup* shkarkoj skedarin e instalimit, *the setup is not working* skedari i instalimit nuk funksionon.

setup [ˈsetap] **em. 4)** sh.t. ky kuptim i emrit i referohet disa njësive që së bashku formojnë një komplet apo plotësi të përdorur për një qëllim të caktuar. Edhe ky kuptim i fjalës ndeshet më së shumti i papërkthyer, pra në formën **setap**. Si përkthim të saktë të këtij kuptimi propozojmë fjalën **komplet**, që megjithëse nuk gjendet ende në FGJSSH, përdoret në masë dhe e mbulon mirë kuptimin. Shembuj: *work setup* kompleti i punës, *setup units* njësitë e kompletit.

share [sher] **fol. 1)** sh.t. përdor në mënyrë të përbashkët me të tjerë një burim, godinë, pajisje, sistem, etj. Kjo folje nuk po përkthehet dhe rastishtë dëgjojmë shpesh përdorimin e **sher**. Disa përkthime të përshtatshme që sugjerojmë janë **bashkëndaj**, **bashkëpërdor**, **përdor bashkarisht**. Shembuj: *two processes share the memory* dy procese bashkëndajnë kujtesën, *the system is shared by many users* sistemi përdoret bashkarisht nga shumë përdorues.

share [sher] **fol. 2)** h.u. përhap në rrjete shoqërore një njoftim, postim, mesazh, fotografi apo formë tjetër informacioni. Edhe në këtë rast, fjala e huaj **sher** duhet të zëvendësohet me përkthimin e duhur që është **shpërndaj**. Shembuj: *share a photo* shpërndaj një fotografi, *share a post in the virtual social networks* shpërndaj një postim në rrjetet shoqërore virtuale.

slash [slesh] **em. graf.** simboli / që përdoret shpesh në shprehje aritmetike apo në gjuhë formale. Për këtë simbol po përdoret shpesh emërtimi **slesh** si në gjuhë angleze i cili ndeshet te [29] f. 24, te [31] f. 37, te [22] f. 131 etj. Në shqip vlejnë fjalët **thyesë**, **fraksion** të cilat gjenden në FGJSSH. Shembuj: *slash symbol* simboli i thyesës, *double slash symbol* simboli i fraksionit të dyfishtë.

slot [slot] **em. p.f.** hapje në një pajisje ku mund të futet ose të lidhet një pjesë apo pajisje shtesë. Shpeshherë e hasim këtë fjalë si në gjuhën angleze, pra në formën **slet**. Kjo ndodh p.sh. te [22] f. 98. Përkthimi i duhur është fjala **fole** që ndeshet e përdorur saktë te [31] f. 68. Shembuj: *expansion slot* fole zgjerimi, *SIM card slot* foleja e kartës SIM.

source code është kodi i një programi kompjuterik i shkruar në një gjuhë programimi të nivelit të mesëm ose të lartë, dhe që më pas kompilohet në kod makine ose interpretohet nga interpretuesi. Duke iu referuar përkthimit në

italishte (it. *codice sorgente*) te [46] f. 27 si dhe shembullit te [14] f. 25, gjykojmë që shprehja e duhur është **kod burimor**. Fjalë apo shprehje të tjera si ~~kodburim~~ apo ~~kodburim~~ që ndeshet te [31] f. 49 duhen shmangur.

subnet [sëb'skraibër] **em. rrj.** koncepti i nënrrjetit, pra një rrjet i vogël që është pjesë e një rrjeti më të madh. Po ndeshet shpesh ~~subnet~~ edhe në gjuhën shqipe, p.sh. te [29] f. 59. Fjala e duhur do të ishte **nënrrjet**. Shembuj: *subnet mask* maska e nënrrjetit, *subnet address block* blloku i adresave të nënrrjetit.

subscribe [sëb'skraib] **fol.** pranoj disa kushte për një shërbim apo ofertë periodike. Kjo fjalë po përdoret gjithnjë e më shumë pa përkthim, sidomos në kanalet e mediave shoqërore që përdoruesit pranojnë të ndjekin. Mund të zëvendësohet nga **pajtoj**, **pajtohem** ose **abonoj**, **abonohem** të cilat megjithëse me prejardhje nga italishtja (it. *abbonarsi*), kanë hyrë në përdorim dhe në FGJSSH kohë më parë. Mund të përdoret në ndonjë rast edhe anëtarësoj, anëtarësohem që gjendet te [21] f. 170. Shembuj: *subscribe to our channel* pajtohuni te kanali ynë, *subscribe to receive the latest news* pajtohuni që të merni lajmet e fundit.

subscriber [sëb'skraibër] **em.** person që pranon kushtet për një shërbim apo ofertë periodike. Në kontekstin e portaleve apo mediave elektronike në internet, kjo fjalë paraqitet në një buton që i mundëson përdoruesit të pranojë mesazhe periodike me lajme, njoftime apo të reja. Në ngjashmëri me foljen më sipër, ky emër mund të përkthehet **pajtimtar**, **abonent**, siç ndeshet te [26] f. 69. Shembuj: *digital service subscriber* pajtimtar i shërbimit digjital, *how many subscribers does your channel have?* sa pajtimtarë ka kanali yt?

subscription [sëb'skripshën] **em.** veprimi sipas foljes *subscribe* të sqaruar më sipër. Edhe për këtë emër kemi fjalët e ngjashme **pajtim**, **abonim**, duke plotësuar familjen e kësaj fjale. Shembuj: *monthly subscription* pajtim mujor, *subscription fee* tarifa e pajtimit.

supervised learning bashkësi metodash të mësimit automatik që trajnohen me të dhëna të etiketuara për të kryer parashikime. Shprehja e duhur në gjuhën shqipe është **mësim i mbikëqyrur**. Shprehja të mësuarit e mbikëqyrur që ndeshet te [18] f. 51 nuk është e gabuar, por paraqitet disi e paqartë.

switch [suiç] **em. 1) sh.t.** njësi që përdoret në qarqet elektrike, elektromekanike apo elektronike për hapjen ose mbylljen e qarkut, çka shoqërohet nga efekte të tjera në përputhje me funksionet e sistemit përfshirës. Emërtimi në gjuhën shqipe është **çelës**. Ndonjëherë ndeshet edhe fjala ndërprerës, p.sh. te [27] f. 98, e cila vlen në disa raste. Shembuj: *elektrik switch* çelës elektrik, *transistor switch* çelës me transistor.

switch [suiç] **fol. sh.t.** folja që lidhet me veprimin e hapjes dhe mbylljen e qarqeve ose me ndryshimin e gjendjes së elementeve të ndryshme në sisteme.

Përkthimi i duhur në shqip varet shumë nga konteksti dhe rasti specifik, por veçojmë fjalët **kyç** ose **ndez** për *switch on* dhe **shkyç** ose **fik** për *switch off*. Në rastet e tjera kur ndeshet vetëm fjala *switch* kemi të bëjmë me ndryshim të gjendjes së pajisjeve, kuptim që mbulohet në gjuhën shqipe nga fjalë të ndryshme si **ndërkyç**, **ndërçel**, **komutoj**. Shembuj: *switch off the light* fik dritën, *switch on the electric relay element* kyç elementin rele, *switch the deviced status* ndërkyç gjendjen e pajisjes.

switch [suiç] **em. 2) sh.t.** ky kuptim i dytë i emrit lidhet me një pajisje, teknikë apo mekanizëm që bën të mundur ndryshimin midis dy apo më tepër gjendjeve ose ndërlihdjen midis disa kanaleve komunikuese. Ky koncept në gjuhën shqipe shprehet nga fjalë të ndryshme si **ndërkyçës**, **ndërçelës** që ndeshet te [2] f. 47 ose **komutator** si te [3] f. 54. Shembuj: *automatic switch* ndërçelës automatik, *a switch of multiple states* një ndërçelës me shumë gjendje.

switch [suiç] **em. 3) rrj.** ky kuptim i tretë i emrit është më specifik dhe i referohet pajisjes së rrjetit, e cila lidh kompjutera të ndryshëm dhe drejton njësitë e informacionit që ata shkëmbejnë me njëri-tjetrin. Kjo fjalë nuk po përkthehet dhe po shkruhet *switch*, p.sh. te [29] f. 59, te [19] f. 19 etj. Fjalët e duhura janë po ato të kuptimit të sqaruar më sipër, pra **ndërçelës**, **ndërkyçës**, **komutator**. Shembuj: *a switch of 16 ports* një ndërçelës me 16 porta, *Cisco is the biggest manufacturer of computer network switches* Cisco është fabrikuesi më i madh i ndërçelësave të rrjeteve kompjuterike.

switching ['suiçing] **em. sh.t.** veprimi sipas foljes *switch* të sqaruar më sipër. Njësoj si më sipër mund të përdoren fjalë si **ndërçelje** që ndeshet te [2] f. 47 dhe te [3] f. 78, **komutim** që ndeshet te [14] f. 121 ose **ndërkyçje**, duke shmangur kështu fjalën *suiçing*. Shembuj: *packet switching network* rrjet me ndërkyçje paketash, *circuit switching network* rrjet me ndërkyçje qarku.

tag [teg] **em. h.u.** fjalë që përfaqëson etiketat e gjuhës HTML të cilat përcaktojnë karakteristika të ndryshme të formatimit të hipertekstit. Duhet përkthyer **etiketë** siç haset te [21] f. 175, te [18] f. 51, te [24] f. 86 etj. Në bibliografi ndodh ta ndeshim edhe *tag* si në gjuhën angleze, p.sh. te [31] f. 14 dhe te [31] f. 36. Shembuj: *color tags* etiketat e ngjyrave, *hyperlink tag* etiketa e hiperlidhjeve.

template ['templeit] **em. sh.t.** objekt apo strukturë që përdoret si shembull për të krijuar të tjera si ajo, sa më lehtë. Po e hasim gjithnjë e më shpesh krejt të papërkthyer, pra në formën *templeit*. Në gjuhën shqipe ka fjalë të ndryshme si **model**, **shabllon**, **gjedhe**, që e mbartin kuptimin e saj. Në bibliografi ndeshen më shpesh dy fjalët e para, përkatësisht te [21] f. 116 dhe te [19] f. 38, si dhe te [31] f. 21 e te [24] f. 10. Shembuj: *software template* model softueri, *design template* shabllon projektimi.

theme [thi:m] **em. graf.** bashkësi elementesh grafike (p.sh. madhësia dhe stili i shkrimit, ngjyrat, hijet, ndriçimi etj.) që përdoren bashkarisht për të stilizuar një dokument, ndërfaqe grafike apo objekt tjetër virtual. Kjo fjalë ndeshet shpesh ~~theme~~ si në gjuhën angleze. Në gjuhën shqipe përdoret fjala **temë** që mbart kuptime të tjera, por që zgjerohet fare mirë duke mbartur edhe këtë kuptim, si p.sh. te [31] f. 87, te [26] f. 82, te [25] f. 7 etj. Shembuj: *default Word theme* tema e paracaktuar Word-it, *grayscale theme* temë bardhezi.

timeline [ˈtajmlain] **em.** paraqitje grafike e kohës, zakonisht si vijë e zgjatur me data, muaj apo edhe vite dhe me ngjarjet përkatëse të renditura në kohë. Kjo fjalë po merr përdorim të gjerë në rrjetet shoqërore virtuale ku tregon historikun e postimeve të përdoruesve. Në vend që të përdoret pa përkthim, sugjerojmë që të përkthehet **kohështrirje**. Një tjetër kuptim i kësaj fjale është ai i boshtit horizontal që përfaqëson ndonjë njësi të kohës (sekonda, minuta etj.) në të cilën projektohet si grafik dinamika e ndonjë madhësie tjetër. Në këtë rast, fjala e duhur do të ishte **boshti i kohës**, dhe jo ~~rreshti i kohës~~ siç lexojmë te [19] f. 35 dhe te [19] f. 181 Shembuj: *timeline of computer models* kohështrirja e modeleve të kompjuterave, *user post timeline* kohështrirja e postimeve të përdoruesit, *timeline in seconds* boshti i kohës në sekonda.

tool [tu:11] **em. sh.t.** vegël apo mjet që mund të jetë fizik ose virtual, pra program kompjuterik. Përdoret shpesh në sistemet kompjuterike, veçanërisht në kontekstin e programimit ku përdoren mjete softuer për të lehtësuar zhvillimin e softuerëve të rinj. Në vend që të përdoret pa përkthim, kjo fjalë duhet të përkthehet **vegël, mjet**. Shembuj: *user tools* mjetet e përdoruesit, *software development tools* vegla për zhvillim të softuerit.

trick [trik] **em. sh.t.** mënyrë e lehtë, e shpejtë apo efektive për të kryer diçka. Kjo fjalë ndeshet në gjuhën e folur në formën ~~trik~~, pra pa përkthim. Në gjuhën shqipe mund të përdorim fare mirë fjalët **truk, marifet**, siç gjenden te [29] f. 26, te [22] f. 229, te [40] f. 16 etj. Shembuj: *a useful trick for fast typing* një marifet i dobishëm për shtypje të shpejtë, *learning programming tricks saves a lot of time* mësimi i marifeteve të programimit kursen shumë kohë.

unsupervised learning bashkësi metodash të mësimit automatik të cilat trajnohen me të dhëna të paetiketuara për të kryer parashikime. Shprehja e duhur në gjuhën shqipe është **mësim i pambikëqyrrur**, ndërsa të mësuarit e pambikëqyrrur që ndeshet te [18] f. 34, paraqitet disi e paqartë.

update [,apˈdejt] **fol.** ndryshoj diçka duke pasqyruar në të informacionet më të fundit apo duke e pasuruar me njohuritë, teknikat e teknologjitë bashkëkohore. Po hasim gjithnjë e më shpesh ~~apdejt~~, ndërkohë që përkthimi i duhur është **përditësoj**, siç përdoret te [25] f. 9. Fjalë të tjera te bibliografia si përtërij te [42] f. 84 apo freskoni te [41] f. 56 nuk janë të gabuara, por lidhen më

shumë me fjalën *refresh*. Ndeshen edhe fjalë si ~~abdetohet~~ te [17] f. 61 apo ~~azhurnohen~~ te [18] f. 93, të cilat janë jo vetëm të papërshtatshme, por edhe qesharake. Shembuj: *update the software* përditësoj softuerin, *update the user data* përditësoj të dhënat e përdoruesit.

update [,ap'dejt] **em.** veprimi sipas kuptimit të foljes më sipër, ose vetë entiteti i përditësuar që ka rezultuar nga ai proces. Edhe në këtë rast, në vend të bëj ~~update~~ që ndeshet te [29] f. 56, ~~azhurnim~~ te [21] f. 99, apo ~~azhurnim~~ te [17] f. 85 dhe [31] f. 23 duhet të përdoret emri **përditësim**. Shembuj: *regular updates* përditësime të rregullta, *monthly updates* përditësime mujore.

user ['ju:zër] **em.** fjalë që ka përdorim masiv në thuasje të gjitha kontekstet apo drejtimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Fatkeqësisht, kjo fjalë po haset gjithnjë e më shpesh pa përkthim, pra dëgjojmë ~~juzër~~. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është **përdorues**, siç e ndeshim te [24] f. 65, te [19] f. 89 etj. Shembuj: *user account* llogari e përdoruesit, *user rights* të drejtat e përdoruesit.

weakly supervised learning bashkësi metodash të mësimimit automatik të cilat trajnohen për të kryer parashikime duke përdorur të dhëna me etiketime “artificiale”, pra të gjeneruara automatikisht dhe jo të vendosura nga njerëzit. Shprehja e duhur në gjuhën shqipe është **mësim i mbikëqyrur dobët** dhe ndeshet te [45] f. 18.

3.4 Prurje të panevojshme

Një pjesë e fjalëve që po huazohen vitet e fundit janë jo vetëm të panevojshme, por edhe të dëmshme. Këto fjalë zëvendësojnë në përdorim fjalë të ndryshme të shqipes duke cenuar strukturën dhe stilistikën e saj. Justifikimi në raste të tilla është pretendimi se gjuha shqipe nuk ofron fjalë të përshtatshme që t'i mbartin mjaftueshëm mirë kuptimet e fjalëve të huaja. Ka raste kur ky pretendim qëndron dhe duhet detyrimisht të huazojmë. Ka gjithashtu shumë raste kur ky pretendim nuk qëndron aspak, sepse mund të gjejmë fjalë shqipe që e shprehin mjaft mirë kuptimin e fjalëve të huaja në rastet e përdorimit të tyre. Disa shembuj rastesh të tilla jepen më poshtë:

access ['akses] **em.** 1) me kuptim më të zakonshëm atë të mundësisë apo së drejtës për të hyrë e për të përdorur një sistem ose burim të caktuar, siç shpjegohet te [47] f. 11. Gjykojmë që ky kuptim i fjalës mbartet mjaft mirë nga fjala **hyrje** që ndeshet te [15] f. 56, te [21] f. 157, te [20] f. 16 etj., ose fjala **qasje** që ndeshet te [29] f. 53, te [14] f. 86, etj. Problem të madh përbën përdorimi masiv i fjalës me një përshtatje të lehtë fonetike nga fjala angleze, pra të shqiptuar dhe shkruar ~~akses~~ si te [41] f. 46 dhe te [32] f. 13, ose ~~aksesim~~ si te [29] f. 62 dhe te [22] f. 105. Ka edhe raste të tjera si te [30] ku fjala shfaqet e shkruar

access, pa asnjë ndryshim nga gjuha angleze. Shembuj: *direct access* hyrje e drejtpërdrejtë, *network access control* kontrolli i qasjes në rrjet, *free internet access* hyrje falas në internet.

access [ˈaksɛs] **em. 2**) një kuptim disi më specifik dhe “i hollë” i këtij emri (i vështirë për tu dalluar nga kuptimi i parë) është mundësia paraprake e hyrjes në një sistem apo rrjet dhe e përdorimit të tij, por pa e përfshirë vetë veprimin e hyrjes ose përdorimit. Në këtë rast duhen shmangur fjalët **akses** dhe **access** dhe të përdoren fjalë të ndryshme si **arritje** ose **arritshmëri**. Shembuj: *system access is impossible* arritja e sistemit është e pamundur, *the highway provides quick access to the hospital* autostrada ofron arritje të shpejtë te spitali.

access [ˈaksɛs] **em. 3**) ky kuptim i tretë është shumë teknik dhe ka të bëjë me kapjen e njësive të ndryshme në kodin e programeve (p.sh. ndryshoret apo qelizat e matricave), në kujtesën qendrore apo në kujtesat dytësore. Në këto raste sugjerojmë të përdoret fjala **kapje** siç haset te [22] f. 183, te [15] f. 9, te [19] f. 13 etj. Fjala **akses** që ndeshet te [38] f. 136 duhet shmangur. Shembuj: *access time of memory words* koha e kapjes së fjalëve të kujtesës, *quick access of matrix elements* kapje e shpejtë e elementeve të matricës.

access [ˈaksɛs] **fol.** veprimi i hyrjes, arritjes apo kapjes së një burimi, sistemi apo njësie, siç shpjegohet te [47] f. 11. Ky kuptim mund të shprehet në gjuhën shqipe me anë të foljeve **hyj**, **kap**, **arrij**, si p.sh. te [14] f. 8. Përshtatja **aksesoj** duhet shmangur në çdo rast. Shembuj: *I cannot access this system* nuk mund të hyj te ky sistem, *access matrix elements with the respective index* kapi elementet e matricës me indekset përkatëse.

accessible [ɛkˈsɛsɛbɛl] **mb.** është mbiemri që lidhet me kuptimin e parë dhe të dytë të emrit, siç u shpjeguan më sipër. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është i **arritshëm**, e **arritshme**, siç ndeshet te [18] f. 40. Përshtatja i **aksesueshëm** që ndeshet te [43] f. 44 duhet të shmanget në çdo rast. Shembuj: *the system will be accessible shortly* sistemi do të jetë i arritshëm së shpejti, *the network is not accessible through this line* rrjeti nuk është i arritshëm përmes kësaj linje.

allocate [ˈalɛkɛit] **fol.** caktoj sasinë e një burimi dhe ia jap atë një entiteti që e ka të nevojshëm për ta përdorur për një qëllim të caktuar. Këtë fjalë e ndeshim rëndom në formën **alokoj**, pra përbën një prurje të huaj. Ndër fjalët e përshtatshme që mund të përdoren janë **lëvroj**, **shpërndaj**, **caktoj**. Sugjerojmë që të përdoret **lëvroj** kur është fjala për burime që jepen në sasi të ndryshme (p.sh. kujtesa), **shpërndaj** kur ofrohen njësi të shumta dhe të numërueshme të një apo disa burimeve dhe **caktoj** kur jepet një burim i pandashëm (p.sh. një bërthamë CPU-je). Shembuj: *allocate memory to a proces* i lëvroj kujtesë një procesi, *allocate system resources* shpërndaj burimet e sistemit, *allocate a CPU core to the process* i caktoj një bërthamë CPU-je procesit.

allocation [ˌaləˈkeɪʃən] **em.** veprimi i caktimit të sasisë së një burimi e më tej dhënia e saj një entiteti që e ka të nevojshëm për ta përdorur për një qëllim të caktuar. Haset shpesh në gjuhën shqipe në formën ~~alokim~~, pra pa përpjekje për ta zëvendësuar me ndonjë fjalë më të përshtatshme. Nisur nga arsyetimi i mësipërm për foljen, si fjalë të përshtatshme që mund ta zëvendësojnë sugjerojmë **lëvrim**, **caktim**, **shpërndarje**. Qëndron deri diku edhe fjala rezervim siç përdoret te [40] f. 67 dhe te [40] f. 73. Shembuj: *dynamic memory allocation* lëvrim dinamik i kujtesës, *CPU allocation* caktim i CPU-së, *fair allocation of resources* shpërndarje e drejtë e burimeve.

ambiguity [ˌambiˈgʊːəti] **em.** shprehje jo e qartë e një koncepti ose identifikim jo i përpiktë i ndonjë objekti. Kjo fjalë haset shpesh e përkthyer në formën ~~ambiguitet~~, si p.sh. te [29] f. 12, te [31] f. 7, te [36] f. 134 etj. Gjykojmë si më të përshtatshme fjalë si **paqartësi**, **dykuptimësi**. Shembuj: *this variable name creates ambiguity* ky emër i ndryshores krijon dykuptimësi, *this formulation is full of ambiguities* ky formulim përmban shumë paqartësi.

association [əˌsəʊsiˈeɪʃən] **em.** 1) veprim që vendos bashkë entitete të ndryshme në një kontekst apo strukturë të caktuar. Ky kuptim i kësaj fjale përdoret në disiplina të ndryshme shkencore e teknike. Na qëllon shpesh ta ndeshim të përkthyer në formën ~~asosacien~~ e cila ndoshta vjen si prurje e panevojshme në dëm të fjalës shoqatë në ligjërimin e përgjithshëm. Përkthimi më i përshtatshëm për kuptimin teknik të fjalës është **shoqërim**. Shembuj: *association rule* rregull i shoqërimit, *association elements* elementet e shoqërimit.

association [əˌsəʊsiˈeɪʃən] **em.** 2) grupim njerëzish të bashkuar për një qëllim apo mision të caktuar. Edhe ky kuptim i përgjithshëm po haset i shprehur me fjalën ~~asosacien~~ që përsëri nuk është e përshtatshme. Sugjerojmë që të zëvendësohet me fjalën **shoqatë**. Shembuj: *Association for Computational Linguistics* shoqata për gjuhësinë kompjuterike, *Association for the Advancement of Artificial Intelligence* shoqata për përparimin e inteligjencës artificiale.

associative [əˈsəʊsiətɪv] **mb.** që ka të bëjë me veprimin e shoqërimit, që pranon apo mbështet veprimin e shoqërimit. Ky mbiemër rrjedh nga kuptimi i parë i emrit të mësipërm. Edhe këtë fjalë e hasim në gjuhën shqipe gjithnjë e më shpesh të shprehur me fjalën ~~asociativ~~. Sugjerojmë që të përkthehet **shoqërues**, **i shoqërimit**. Shembuj: *associative search* kërkim shoqërues, *associative law* ligji i shoqërimit, *associative element* element shoqërues.

atomicity [ˌatəˈmɪsəti] **em.** vetia e të qenit i pandashëm, i ndërtuar nga njësi të pandashme ose që ndodh në hapa të pandashëm. Kjo fjalë është përdorur më së shumti në kimi e fizikë, por kuptimi i saj shtrihet edhe në teknologjinë e informacionit, veçanërisht për të përshkruar procese apo veprime që nuk mund të ndahen në veprime më të thjeshta. Huazimi ~~atomeitet~~ ndoshta nuk është i

gabuar, por gjykojmë që **pandashmëri** është fjala më e përshtatshme dhe më e qartë. Shembuj: *atomicity of actions* pandashmëria e veprimeve, *atomicity of transactions* pandashmëria e transaksioneve.

compatible [këm'petëbëll] **mb. sh.t.** lidhet me versione të ndryshme të komponentëve harduer apo softuer që mund të punojnë ose jo në përputhshmëri me njëri-tjetrin. Për këtë mbiemër ndeshet ndonjëherë forma **kompatabël**, p.sh. te [35] f. 37. Sugjerojmë që në vend të saj të përdoret mbiemri i **përputhshëm**, e **përputhshme**. Shembuj: *compatible software versions* versione të përputhshme të softuerit, *compatible components* komponentë të përputhshëm, *compatible CPU architectures* arkitektura të përputhshme CPU-je.

copyright ['ko:pirajt] **em.** emër që nënkupton të drejtën ligjore për të publikuar, kopjuar, shpërndarë apo shitur krijimtari si shkrime, muzikë, filma, softuer etj. Kjo fjalë po përdoret në gjuhën e folur në formën **kopirajt** e cila nuk ka lidhje me gjuhën shqipe. Kohë më parë përdorej forma e shqipëruar **e drejtë autori** e cila është në harmoni me emërtimet e konceptit në gjuhët e tjera të Evropës kontinentale (fr. *droits d'auteur*). Fjala **kopirajt** është fare e panevojshme dhe përfshirja e saj në në FGJSSH (botimi i vitit 2006) përbën një gabim serioz. Shembuj: *copyright violation* shkelje e të drejtës së autorit, *copyright regulation* rregullore për të drejtat e autorit.

design [di'zajn] **em.** 1) kjo fjalë është e vështirë, sepse ka kuptime të ndryshme që nuk dallohen lehtë nga njëri-tjetri. Është gjithashtu e vështirë të gjehen fjalët përkuese të gjuhës shqipe për secilin nga kuptimet. Për këto arsye, vitet e fundit po përdoren emrat **dizajn**, **dizenjo**, **dizenjim** apo ndonjë tjetër i ngjashëm. Për mendimin tonë, këto fjalë janë të panevojshme, sepse kuptimet e tyre mbarten fare mirë nga fjalë shqipe që gjenden në FGJSSH, të cilat po i paraqesim sipas konteksteve të përdorimit. Kuptimi i parë për emrin **design** është veprimi sipas foljes përkatese. Në një kontekst teknik apo inxhinierik i shkon për shtat fjala **projektim** që haset te [8] f. 71. Duhet shmangur pra fjala **dizenjim**, e cila ndeshet te [29] f. 51 ku lexojmë “**dizenjimin** e rrjeteve” (do të duhej: “projektimin e rrjeteve”). Në rastet ku kemi të bëjmë me plane, dokumente, raporte, tabela apo objekte të ngjashme, shkojnë më shumë emrat foljorë **hartim**, **përpilim**. Një shembull është: *yearly plan design* hartimi i planit vjetor. Edhe për këto raste ndeshen në bibliografi përdorime të gabuara, si te [17] f. 50 ku lexojmë “**dizenjimi** i tabelave” (do të duhej: “hartimi i tabelave”), te [17] f. 75 ku lexojmë “**dizenjimi** i raportit” (do të duhej: “përpilimi i raportit”) etj. Kur kemi të bëjmë me vizatime, skema, piktura me laps apo punime të ngjashme, shkojnë më shumë emrat foljorë **vizatim**, **skicim**. Disa shembuj janë: *design of a black and white portrait* vizatimi i një portreti bardhezi, *the initial design of the building* skicimi fillestar i godinës, *the design of this diagram* is

not easy skicimi i këtij diagrami nuk është i lehtë. Në kontekstin e faqeve ueb, ndër pamjeve të prezantimeve etj. dallojmë dy raste. Kur vihet theksi te puna për krijimin e tyre (jo veçanërisht te aspekti pamor) mund të përdoren fjalët **ndërtim**, **hartim**, p.sh. *the design of this web page will take some time* ndërtimi i kësaj faqeje ueb do të dojë ca kohë. Në rastet kur vihet theksi te aspekti pamor i atyre objekteve mund të përdoren fjalët **skicim**, **stilizim**. Disa shembuj të përdorimit të tyre janë: *desing of the slides* skicimi i ndër pamjeve, *the design of this web page* stilizimi i kësaj faqeje ueb, *CSS is a design language* CSS-ja është një gjuhë stilizimesh. Edhe për raste të tilla përdoren në bibliografi huazimet nga anglishtja, p.sh. te [31] f. 10 ku lexojmë “**Dizenjimi** është realizuar në formën e një libri” (do të duhej: “skicimi është realizuar në formën e një libri”). Theksojmë se të gjitha fjalët shqipe që propozojmë te ky paragraf gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH.

design [di'zajn] **em. 2)** ky kuptim i dytë i emrit ka të bëjë me objektet grafike apo veçoritë e tyre. Fjalët që sugjerojmë janë **skicë**, **grafikë**, **stil** që gjenden në FGJSSH dhe mund të përdoren në përputhje me rastin konkret. Njësoj si në rastin e kuptimit të mësipërm, edhe për këtë kuptim po përdoren prurje të panevojshme si ~~dizajn~~ apo ~~disenj~~. Te [25] f. 67 lexojmë p.sh. “Ndryshoni ~~dizanjin~~ e ~~slide-ve~~” (do të duhej: “Ndryshoni stilin e ndër pamjeve”) ndërsa te [26] f. 82 lexojmë “Tema është një bashkësi elementesh ~~dizajni~~” (do të duhej: “Tema është një bashkësi elementesh grafike”). Një rast i rrallë ku nuk përdoret huazim i panevojshëm gjendet te [41] f. 31 ku lexojmë “sipas skicës së Emës...”, pra është përdorur fjala skicë. Nga të gjithë shembujt e trajtuar te këta dy paragrafë, duket se nuk ka ndonjë rast përdorimi të emrit *design* për të cilin të mos kemi ndonjë emër të përshtatshëm në gjuhës shqipe.

design [di'zajn] **fol.** është folja që paraqet veprimet e lidhura me kuptimin e parë të emrit më sipër. Prurja e panevojshme në këtë rast është ~~dizenj~~ dhe variantet e ndryshme në të cilat mund të paraqitet. Njësoj si për emrin, edhe për foljen dallohen kontekste të ndryshme të përdorimit. Në kontekstin e punëve inxhinierike shkon për shtat folja **projektoj**. Te [26] f. 72 lexojmë p.sh. “Një firmë inxhinierike ka ~~dizenjuar~~ një urë”. Në këtë rast mund të thonim fare mirë “Një firmë inxhinierike ka projektuar një urë”. Në rastet ku kemi të bëjmë me plane, dokumente, raporte, tabela apo objekte të ngjashme, na vlejnjë foljet **hartoj**, **përpiloj**. Disa shembuj do të ishin: *design a detailed plan* përpiloi një plan të detajuar, *design the report of expenses* hartoi raportin e shpenzimeve etj. Për vizatimet, skicat, skemat, pikturat me laps apo punimet e ngjashme kemi foljet **vizatoj**, **skicoj**. Kur është fjala për krijimin e ndër pamjeve, faqeve ueb etj. mund të përdoren foljet **ndërtoj**, **hartoj**. Disa shembuj të përdorimit të tyre janë: *design a simple web page in HTML* ndërtoni një faqe të thjeshtë ueb

në HTML, *design a few slides that describe your country* hartoni disa ndër pamje që përshkruajnë vendin tuaj. Në rastet kur është fjala për aspektet pamore të atyre objekteve mund të përdorim foljet **skicoj**, **stilizoj**. Këto folje i gjejmë të përdorura saktë edhe në bibliografi. Lexojmë p.sh. “kanë skicuar tiparet tuaja” te [18] f. 6, “stilizoni tabelën” te [41] f. 29, “skiconi skemën e plotë” te [9] f. 130 etj. Edhe foljet e propozuara te ky paragraf gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH dhe duket qartë që mbulojnë çdo rast përdorimi të foljes *design*, duke e bërë huazimin e saj të panevojshëm.

designed [di'zajnd] **mb.** në këtë rast kemi të bëjmë me mbiemrin që lidhet me foljen dhe kuptimin e parë të emrit, siç u shpjeguan më sipër. Duhet shmangur prurja i.e *dizenjuar* dhe variantet e ndryshme të saj që ndeshen te [31] f. 45, te [22] f. 68, te [27] f. 433 etj. Në vend të tyre mund të përdoren i.e **projektuar**, **hartuar**, **vizuar**, **skicuar**, **stilizuar**, në përputhje me rastet që u dalluan dhe shtjelluan më sipër.

designer [di'zajnër] **em.** në këtë rast kemi të bëjmë me fjalën që emëron specialistët e ndryshëm që kryejnë veprimet e mbartura nga foljet më sipër. Duhet shmangur prurjet e panevojshme *dizajner* që ndeshet te [41] f. 15, *dizenjator* që ndeshet te [43] f. 86 si dhe forma të tjera të ngjashme. Në vend të tyre mund të përdorim **projektues** kur kemi të bëjmë me specialistin e projekteve inxhinierike, **grafist** për specialistin që stilizon faqe ueb, kopertina dhe objekte të ngjashme apo përpunon imazhe me programe grafike, **stilist** për personin që stilizon faqe ueb, ndër pamje etj., **skicues** për personin që ka skicuar diçka, dhe **hartues**, **përpilues** për personin që harton apo përpilon një plan, raport etj. Shembuj: *designer of web pages* stilist i faqeve web, *fashion designer* stilist mode, *graphic designer* grafist.

dimension [di'menshën] **em. mat.** fjalë që ndeshet kryesisht në matematikë ku përcaktohet si numri minimal i koordinatave të nevojshme për të përcaktuar një pikë në një hapësirë. Sot po ndeshet gjithnjë e më shpesh në drejtime ndërdisiplinore, por fatkeqësisht shprehet me anë të fjalës *dimension* që siç vihet në dukje te [48] f. 20 përbën një huazim të panevojshëm nga italishtja. Ndeshim p.sh. “tabelat me një *dimension*” te [15] f. 70, “në tri *dimensione*” te [18] f. 28 etj. Fjala e duhur shqipe që e shpreh mjaft mirë konceptin është **përmasë**, e cila haset tek [5] f. 17, te [1] f. 135 dhe në botime të tjera të rëndësishme. Shembuj: *matrix dimensions* përmasat e matricës, *the two dimensions of the plane* dy përmasat e planit.

dimensional [di'menshënëll] **mb. mat.** është mbiemri që shpreh cilësinë e të paturit të një numri të caktuar përmasash. Fjala e duhur që kemi është **përmasor** dhe paraqitet shpesh si njësi fjalëformuese duke marrë përpara numërorë. Sugjerojmë që të shmangen në çdo rast format me prurjen *dimensional*, të cilat

po ndeshen shpesh në bibliografi. Disa raste raste janë “fushat tridimensionale” (do të duhej: “fushat tripërmasore”) te [49] f. 217, “tabelë një dimensionale” (do të duhej: “tabelë njëpërmasore”) te [38] f. 122, “shumat 3 dimensionale” (do të duhej: “shumat 3-përmasore”) te [24] f. 31 etj. Një rast i rrallë i shmangies së huazimit gjendet te [15] f. 148 ku lexojmë “vektorët dypërmasorë”.

launch [lɔ:nɔŋ] **fol.** është fjalë e vështirë për shkak të kuptimeve të ndryshme që mbart në kontekste të ndryshme, kuptime që po shprehen në gjuhën shqipe me prurje si *lançoj*, *lansoj* apo ndonjë formë të ngjashme. Një nga kuptimet më të shpeshta në teknologjinë e informacionit është ai i vënies në veprim të programeve kompjuterike. Për këto raste kemi **aktivizoj**, **vë në veprim**. Disa shembuj janë: *launch the program with the mouse* aktivizojë programin me anë të miushit, *with this shortcut you can easily launch the interface* me këtë shkurtores mund ta vësh në veprim lehtësisht ndërfaqen. Një tjetër kuptim është ai i nisjes së ndonjë fushate apo aktiviteti, çka mund të shprehet me anë të foljes **nis**. P.sh. *the government launched an afforestation campaign* qeveria nisi një fushatë pyllëzimi. Në disa raste të tjera kemi të bëjmë me nxjerrje për zbatim të një rregulloreje ose nxjerrje në qarkullim të titujve, bonove, etj. Për këto raste mund të përdorim **nxjerr**, **nxjerr në qarkullim**. P.sh. *Google launched a new data collection regulation* Google-i nxori një rregullore të re për mbledhjen e të dhënave, *the government launched high interest bonds* qeveria nxori në qarkullim bono me interes të lartë. I ngjashëm është edhe kuptimi i hedhjes për herë të parë në treg të produkteve apo shërbimeve nga firma të ndryshme. Për raste të tilla kemi **hedh në treg**. Disa shembuj janë: *Google will launch a new phone model* Google-i do të hedhë në treg një model të ri telefoni, *Microsoft launched Windows 11 system in autumn 2021* Microsoft-i hodhi në treg sistemin Windows 11 në vjeshtë 2021. Ka raste kur produktet, shërbimet e reja, karakteristikat e tyre apo planet për të ardhmen vetëm njoftohen ose bëhen të njohura publikisht. Në këto raste mund të përdoren fjalët **shpalos**, **prezantoj**. P.sh. *AMD launched Zen4 architecture specifications* AMD-ja shpalosi specifikimet e arkitekturës Zen4, *TSCM launched a new manufacturing strategy to fulfil market demand* TSCM-ja prezantoi një strategji të re fabrikimi për të plotësuar kërkesën e tregut. Siç mund të shihet, të gjitha fjalët dhe shprehjet e propozuara te ky paragraf gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH dhe i mbulojnë të gjitha kuptimet e fjalës *launch*, duke i bërë huazimet *lançoj*, *lansoj* të panevojshme.

monitor [ˈmo:nitër] **fol. sh.t.** është folje që shpreh veprimin e kontrollit të vazhdueshëm të diçkaje për të mbajtur në kontroll ecurinë e saj dhe për të bërë ndërhyrjet e nevojshme në raste problemesh. Në gjuhën e folur ka hyrë në përdorim të gjerë fjala *monitëroj*. Një fjalë që e mbulon mirë kuptimin është mbikëqyr e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *monitor the*

production process mbikëqyr procesin e prodhimit, *monitor the data transmission* mbikëqyr transmetimin e të dhënave.

multidimensional [ˌmaltidiˈmɛnshɛnɛll] **mb. mat.** është mbiemri që shpreh cilësinë e të paturit të një numri të lartë përmasash. Fjala e duhur që kemi është **shumëpërmator** që ndeshet te [38] f. 132. Sugjerojmë që të shmanget prurja e panevojshme **multidimensional** e cila ndeshet te [39] f. 50 dhe në raste të tjera. Shembuj: *multidimensional array* matricë shumëpërmasore, *multidimensional data representation* paraqitje shumëpërmasore e të dhënave, *multidimensional data structure* strukturë shumëpërmasore e të dhënave.

portable [ˈpo:rtɛbɛll] **mb. sh.t.** që mund të mbartet apo zhvendoset me lehtësi, ose që mund të përdoret me lehtësi në mjedise të ndryshme. Shpesh na ndodh të dëgjojmë fjalën *portabël*, p.sh. te [41] f. 14. Në vend të saj mund të përdoret shumë mirë fjala shqipe i **mbartshëm**, e **mbartshme**, siç e gjejmë te [38] f. 57. Shembuj: *portable programming code* kod programimi i mbartshëm, *portable operating system* sistem operativ i mbartshëm.

print [print] **fol. graf.** krijoj imazhe shkronjash e figurash në letër apo ndonjë material tjetër nëpërmjet një pajisjeje që vendos bojë në sipërfaqen e materialit. Kjo fjalë po përdoret dendur në gjuhën shqipe në trajtën **printoj**, si në të folur edhe në bibliografi. Veç kësaj, shqetësim të madh përbën fakti që forma **printoj** ka hyrë edhe në FGJSSH (botimi i vitit 2006) duke ligjruar kështu përdorimin e saj. Sugjerimi ynë është përdorimi i foljes **shtyp** e cila qëndron në harmoni të plotë me fjalë të tjera të kësaj familjeje si shtypi i ditës, shkronjë shtypi, *shkrim shtypi*, *shtypshkronjë*, etj. Kjo folje ndeshet deri diku edhe në bibliografi, si p.sh. te [38] f. 12, [38] f. 52, etj. Për më tepër, një nga kuptimet e foljes shtyp në FGJSSH (në të gjitha botimet, nga 1980 deri te 2006) është pikërisht ky, pra “riprodhoj me anë të mjeteve të posaçme tekste, vizatime, figura, etj.”. Për këto arsye e gjykojmë si të paarsyeshme dhe si një gabim të rëndë përfshirjen në FGJSSH 2006 të fjalës **printoj**. Shembuj: *print a document* shtyp një dokument, *print on paper* shtyp në letër.

print [print] **em. graf.** procesi i ngjeshjes me pajisje të posaçme të shkronjave apo figurave në letër apo material tjetër. Edhe ky emër foljor shprehet gabimisht me fjalën **printim** duke futur në gjuhën shqipe një fjalë të huaj të panevojshme. Kjo fjalë mund të përkthehet fare thjesht **shtypje** kur është fjala për dokumente, shkresa, libra, etj., të cilët shtypen në letër shtypi dhe **stampim** kur është fjala për fotografi të cilat riprodhohen në letër të veçantë, për skicime imazhesh që vendosen në veshje ose materiale tekstili, si edhe për forma të tjera që gdhenden në materiale të veçanta. Përsëri gjykojmë që përfshirja e fjalës **printim** në FGJSSH 2006 është e panevojshme dhe e gabuar. Shembuj: *print format* formati i shtypjes, *print quality* cilësia e shtypjes.

printed ['printid] **mb. graf.** mbiemri që lidhet me emrin dhe foljen e mësipërme dhe që në gjuhën shqipe po shprehet rëndom në trajtën *i,e printuar*. Njësoj si më sipër, mbiemri *i,e printuar* është përfshirë në FGJSSH në mënyrë të panevojshme dhe të gabuar. Sugjerimi ynë është që të përdoren fjalët *i,e shtypur* kur është fjala për shkresa, dokumente, libra etj. që riprodhohen në letër shtypi dhe *i,e stampuar* për forografi apo figura që riprodhohen në letër të veçantë, në tekstil apo në materiale të tjera. Shembuj: *printed book* libër i shtypur, *printed photography* fotografi e stampuar.

prioritize [prai'orëtaiz] **fol.** i caktoj përparësi apo i jap rëndësi dhe rendit sipas saj punë, detyra, probleme etj. Këtë fjalë e ndeshim shpesh në trajtën *prioritarizoj*, çka gjykojmë që është e panevojshme. Sugjerojmë që në vend të saj të përdoren në gjuhën shqipe togfjalëshit **caktoj përparësi, jap përparësi**. Shembuj: *prioritize the future tasks* u caktoj përparësi detyrave të ardhshme, *prioritize the computation requirements* u jap përparësi nevojave përlllogaritëse.

sort [so:rt] **fol. sh.t.** rendit ose radhit një bashkësi elementesh sipas një kriteri apo disa kriterëve. Për këtë fjalë kemi në gjuhën shqipe fjalën **rendit** e cila ndeshet e përdorur saktë te [38] f. 53 dhe në raste të tjera. Futja e fjalëve *sortoj*, *sortim* si p.sh. te [42] f. 266, te [49] f. 177 etj. na duket jo vetëm e panevojshme, por edhe qesharake. Shembuj: *sort a vector of numbers in ascending order* rendit një vektor numrash në rend rritës, *sort the words in alphabetic order* rendit fjalët në rend alfabetik.

sorted [so:rtid] **mb.** është mbiemri që lidhet me foljen e mësipërme. Përsëri mund të përdoret fjala *i,e renditur*. Përdorimi i fjalës *i sortuar*, si p.sh. te [39] f. 203 na duket i panevojshëm dhe qesharak. Shembuj: *sorted vector of numbers* vektor i renditur numrash, *words sorted in alphabetic order* fjalë të renditura në rend alfabetik.

sorting [so:rting] **em.** veprimi i renditjes, pra emri foljor që lidhet me foljen e shpjeguar më sipër. Në gjuhën shqipe kemi fjalën **renditje** që e mbulon më së miri kuptimin në çdo rast. Prurja *sortim* që ndeshet p.sh. te [39] f. 202 është e panevojshme dhe qesharake. Shembuj: *sorting algorithm* algoritëm për renditje, *sorting numbers in ascending order* renditja e numrave në rend rritës.

support [së'po:rt] **fol.** dhënia e ndihmës ose gatishmëria për të dhënë ndihmë në raste problemesh apo defektesh të lidhura me infrastrukturën harduer apo softuer. Kjo fjalë po përdoret gjithnjë e më shpesh në formën *suportoj*, çka përbën një prurje jo vetëm të panevojshme, por edhe qesharake. Në bibliografi ndeshim *suportoj* në raste si te [29] f. 4, te [26] f. 11, te [15] f. 118 etj. Fjala shqipe **mbështet** (në disa raste edhe **përkrash**) siç ndeshet te [19] f. 161, te [43] f. 13 etj. e mbulon më së miri këtë kuptim, ndaj gjykojmë që përbën përkthimin e duhur të saj në kontekstin e teknologjisë së informacionit. Shembuj: *we can support*

your hardware maintenance at any time ne mund të mbështetim mirëmbajtjen e harduerit tuaj në çdo kohë, *C language supports many data types* gjuha C mbështet shumë tipa të dhënash.

support [sə'pɔ:rt] **em.** është emri sipas kuptimit të foljes më sipër. Edhe kjo fjalë po përdoret si në gjuhën angleze, pra po ndeshim gjithnjë e më shpesh fjalën *support* edhe në gjuhën shqipe, çka gjykojmë se përbën një prurje të panevojshme. Te [24] f. 93 i njëjti kuptim shprehet me anë të fjalës asistencë, e cila edhe pse gjendet në FGJSSH, nuk na duket fort e përshtatshme. Në gjuhën shqipe mund të përdoret fare mirë emri **mbështetje** (në disa raste edhe **përkrahje**) duke e mbuluar më së miri këtë kuptim të fjalës angleze. Shembuj: *the support was slow* mbështetja ishte e ngadaltë, *call client support at this number* thirrni mbështetjen e klientit te ky numër.

vulnerability [vʌlnərə'billəti] **em. sig.** të qenit i dobët në diçka ku mund të goditesh apo dëmtohesh lehtësisht. Kjo fjalë përdoret shpesh në kontekstin e sigurisë kompjuterike dhe ka hyrë në formën *vulnerabilitet*. Përshtatja e saj në gjuhën shqipe është **dobësi, pikë e dobët** me raste përdorimi që mund të shtrihen pa problem edhe në fushën e sigurisë kompjuterike. Shembuj: *critical vulnerability* dobësi kritike, *system vulnerabilities* pikat e dobëta të sistemit.

3.5 Mospërshtatje dhe keqpërshtatje

Një problem tjetër është mospërshtatja e një pjese të fjalëve nga anglishtja. Kjo viher re shpesh në rastet kur përkthimi i fjalëve bazohet vetëm te njëfarë “akordimi” i tyre, pa përpjekje për të gjetur fjalë përkuese që lidhen ngushtë me konceptin dhe kuptimin. Më poshtë paraqiten disa fjalë tipike të kësaj kategorie:

accelerator [æk'seləreitər] **em. sh.t.** pajisje ose metodë që përdoret për t'i dhënë hov një procesi, për të përshpejtuar ecurinë e tij. Një nga përdorimet më të shpeshta i referohet procesorit grafik të kompjuterit që përshpejton përpunimin dhe shfaqjen e imazheve, siç sqarohet te [47] f. 11. Një huazim që ka hyrë në përdorim është **akselerator**, fjalë që na duket jo bindese, duke pasur parasysh se koncepti mund të shprehet mjaft mirë nga fjala **përshpejtues**. Shembuj: *graphics accelerator* përshpejtuesi i grafikës, *hardware accelerator* përshpejtues harduer.

assignment [ə'sainmənt] **em. prog.** është fjala për operacionin e dhënies së vlerës në programim, pra kur një vlerë lidhet me një ndryshore apo objekt tjetër. Një keqpërshtatje e kësaj fjale është **asenjim**, çka është fare e panevojshme. Një fjalë që ndoshta qëndron deri diku është **shoqërim**, operacioni i shoqërimit që ndeshet te [50] f. 60 dhe te [39] f. 54. Fjala që gjykojmë si më të përshtatshme dhe që ka përdorimin më të gjerë në bibliografi është **vlerëdhënie**, e cila ndeshet

te [38] f. 71, te [29] f. 27, te [15] f. 120 etj. Shembuj: *assignment operator* operatori i vlerëdhënies, *assignment instruction* instruksioni i vlerëdhënies.

approach [ë'prëuç] **em.** është fjalë që përdoret në ligjërimet tekniko-shkencore për të përshkruar mënyra apo metoda të zgjidhjes së problemeve apo të konceptimit e projektimit të sistemeve. Një përshtatje e gabuar me përdorim të shpeshtë është ~~përafrim~~ që ndeshet te [15] f. 192, por që në fakt i shkon për shtat një koncepti tjetër (përafrimet e vlerave në përlllogaritje numerike), pra krijon paqartësi. Një tjetër përshtatje e zakonshme është qasje, fjalë e cila qëndron deri dikur dhe që ndeshet te [18] f. 13, te [15] f. 192 etj. Rekomandojmë gjithsesi përdorimin e fjalës **përqasje**. Shembuj: *modular approach* përqasje modulare, *top-down approach* përqasje nga-kreu-poshtë.

attach [ë'taç] **fol.** shtoj një dokument, imazh apo objekt tjetër në një dërgesë postare apo në një mesazh të postës elektronike. Folja e duhur në gjuhën shqipe është **bashkëngjit** ose **bashkëlidh**, siç përdoret saktë te [22] f. 116. Një variant i shtrembëruar është ~~bashkangjit~~ që dëgjohet më shpesh në gjuhën e folur. Shembuj: *attach an image* bashkëngjit një imazh, *attach the code in a .zip file* bashkëngjit kodin në një skedar .zip.

attached [ë'taçt] **mb.** mbiemri që lidhet me foljen më sipër. Edhe në këtë rast, përshtatja e duhur është i,e **bashkëngjitur**, siç ndeshet te [22] f. 116. Forma i,e **bashkangjitur** duhet shmangur në çdo rast. Shembuj: *attached image* imazh i bashkëngjitur, *attached PDF documents* dokumente PDF të bashkëngjitur.

attachment [ë'taçmënt] **em. 1)** veprimi sipas kuptimit të foljes së mësipërme, pra veprimi i shtimit të një dokumenti, imazhi apo objekti tjetër në një dërgesë. Fjala e saktë në këtë rast është **bashkëngjitje** ose **bashkëlidhje**, ndërsa forma e shtrembër ~~bashkangjitje~~ duhet shmangur. Shembuj: *attachment failed, please try again* bashkëngjitja dështoi, ju lutemi të provoni përsëri, *multiple attachments* bashkëngjitje të shumëfishta.

attachment [ë'taçmënt] **em. 2)** objekti që bashkëngjitet në një dërgesë ose në një mesazh të postës elektronike. Fjala e duhur për këtë kuptim është **shtojcë**. Fjala bashkëngjitje mund të përdoret, por forma ~~bashkangjitje~~ duhet shmangur. Shembuj: *please check the attachment for the specifications* ju lutemi të kontrolloni shtojcën për specifikimet, *PDF attachments* shtojca PDF, *the attachment is modified* shtojca është modifikuar.

authenticate [o:'thentikeit] **fol. sig.** vërtetoj identitetin e një përdoruesi për ta lejuar apo jo të hyjë në një sistem apo rrjet kompjuterik. Një formë e keqpërshtatur e kësaj fjale është ~~autentifikoj~~. Njësoj si në rastin e fjalëve **diagnostikoj** dhe ~~diagnostifikoj~~ nga mjekësia, gjykojmë që forma e duhur për këtë rast është **autentikoj**. Shembuj: *the system is not correctly authenticating*

every user sistemi nuk po autentikon saktë çdo përdorues, *please authenticate yourself prior to log in* ju lutemi të autentikoheni para se të hyni.

authentication [o: ,thenti'keishën] **em. sig.** emri që lidhet me veprimin sipas foljes më sipër. Një formë e keqpërshtatur e tij është **autentifikim**. Ka përhapje të gjerë në bibliografi, p.sh. te [24] f. 84, te [20] f. 7 etj. Njësoj si më sipër, gjykojmë që përshtatja e duhur në gjuhën shqipe duhet të jetë **autentikim**. Shembuj: *weak authentication can lead to critical issues* autentikimi i dobët mund të çojë në probleme kritike, *authentication with strong passwords* autentikim me fjalëkalime të forta.

basic ['beizik] **adj.** që përbën pjesën kryesore dhe të domosdoshme të diçkaje, pjesën mbi të cilën ngrihen elementet e tjera. Ky mbiemër ndeshet shpesh i shtrembëruar në formën **bazik**, **bazike**, p.sh. te [36] f. 86, te [19] f. 89, te [27] f. 408 etj. Forma **bazik**, **bazike** është e saktë vetëm kur përdoret në shkencën e kimisë. Forma e duhur për çdo rast tjetër është mbiemri **bazë**. Shembuj: *the basic module of the system* moduli bazë i sistemit, *the basic version of the software* versioni bazë i softuerit.

coefficient [,këui'fishënt] **em. mat.** simbol apo numër që qëndron përpara një madhësie të cilën e shumëfishon. Në fizike dhe në tekste të inxhinierisë mbart kuptimin e një madhësie që përcakton një cilësi apo veti. Ky koncept i matematikës dhe disiplinave tekniko-shkencore është bërë zakon të shkruhet **køfiçent** apo **køfiçent**, të dyja forma të shtrembëruara që duhen shmangur. Forma e saktë e kësaj fjale është **koeficient** dhe gjendet e shpjegohet në FGJSSH. Ndeshet edhe në bibliografi, si p.sh. te [6] f. 24, te [28] f. 46, te [9] f. 13 etj. Shembuj: *algebraic coefficients* koeficientët algjebrikë, *the coefficient of friction* koeficienti i fërkimit.

communicative [kë'mju:nikëtiv] **mb.** që ka lidhje me komunikimin, që ka aftësi apo kapacitete për të komunikuar (dhënë dhe marrë) informacion. Fjala e duhur për këtë mbiemër është **komunikues**. Në disa raste si te [29] f. 50 ndeshet forma **komunikativ** e cila është e panevojshme. Shembuj: *communicative skills* aftësi komunikuese, *communicative units* njësi komunikuese.

compile [këm'pail] **fol.** veprimi i kthimit të kodit të shkruar në një gjuhë programimi të nivelit të lartë në kod makine. Një keqpërshtatje e kësaj fjale është **kompajloj** që ndeshet te [39] f. 2. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **kompiloj**. Shembuj: *compile the source code* kompiloj kodin burimor, *compile the source files* kompiloj skedarët burimor.

compiler [këm'pailër] **em.** program kompjuterik që përkthen programe të tjera nga gjuhët e nivelit të lartë në gjuhën e makinës. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **kompilator**, siç e hasim te [38] f. 96, te [15] f. 62 etj.

Një keqpërshtatje e panevojshme është fjala ~~kompa~~iler që ndeshet te [39] f. 12. Shembuj: *C language compiler* kompilatori i gjuhës C, *compiler of high-level languages* kompilator i gjuhëve të nivelit të lartë.

curve [kë:rv] **em.** vijë e lakuar e një grafiku që përfraçëson një dukuri apo ecuri të një madhësie. Po dëgjojmë gjithnjë e më shpesh fjalën ~~kurbë~~ e cila përbën një përshtatje fonetike të pjesshme të fjalës angleze. Sugjerojmë që në vend të saj të përdoret fjala **lakore** e cila gjendet te [9] f. 39. Shembuj: *normal distribution curve* lakorja e shpërndarjes normale, *the curve of a continuous function* lakorja e një funksioni të vazhduar.

define [di'fain] **fol.** veprimi i përcaktimit të një koncepti, objekti apo moduli kodi të një programi. Te [39] f. 288 dhe në raste të tjera ndeshet keqpërshtatja ~~defin~~oj e cila duhet shmangur në çdo rast. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **përcaktoj**. Shembuj: *define a function in C* përcaktoj një funksion në gjuhën C, *define a variable as constant* përcaktoj një ndryshore si konstante.

definition [,defi'nishën] **em. sh.t.** shpjegim apo formulim i kuptimit të një fjale, koncepti, metode, etj. Na ndodh të dëgjojmë shpesh ~~definicion~~ e cila me siguri vjen nga italishtja (it. *definizione*). E gjejmë të njëjtën fjalë edhe në bibliografi te [50] f. 55, [39] f. 293 etj. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe i kësaj fjale është **përkufizim**, **përcaktim**. Shembuj: *clear definition* përkufizim i qartë, *function definition* përcaktim i funksionit.

disponibility [dis'ponëbilëti] **em.** të qenit i disponueshëm, i gatshëm për të dhënë përgjigje apo shërbim. Gjykojmë që përkthimi i duhur është fjala **disponueshmëri**. Forma ~~disponibilitet~~ ka hyrë pa përshtatje dhe duhet shmangur. Shembuj: *software system with high disponibility* sistem softuer me disponueshmëri të lartë, *disponibility is an important feature* disponueshmëria është një cilësi e rëndësishme.

domain [dëu'mein] **em. h.u.** hapësira e vlerave të mundshme të një ndryshoreje ose e emërtimeve në internet që mbarojnë me të njëjtat shkronja. Kjo fjalë e ka origjinën nga matematika ku nënkupton bashkësinë e përcaktimit të një funksioni, pra bashkësinë e vlerave të mundshme të argumentit të tij. Përdorimi u shtri më tej në informatikë për emërtimet në internet. Fatkeqësisht, në rastin e dytë po vihet re një përdorim i shtrembër i fjalës në format ~~domain~~ ose ~~domein~~, p.sh. te [41] f. 47, te [19] f. 68, te [14] f. 118 etj. Përkthimi i duhur duhet të jetë i njëjtë me atë në kontekstin e matematikës, pra **domen** siç shfaqet te [21] f. 158, te [22] f. 110, te [18] f. 22 etj. Shembuj: *function domain* domeni i funksionit, *taken domain* domen i zënë, *public domain* domen publik.

duplicate ['du:plikeit] **em.** që është kopje identike e diçkaje. Fjala e duhur që shpjegohet edhe në FGJSSH është **dublikatë**. Fatkeqësisht po ndeshim shpesh

fjalën **dublikim**, p.sh. te [24] f. 60. Shembuj: *remove the duplicate variable* hiqe ndryshoren dublikatë, *duplicates take a lot of memory and should be removed* duplikatat zënë shumë kujtesë dhe duhet të hiqen.

duplicate [ˈdu:plikeit] **fol.** krijoj një kopje identike të diçkaje. Edhe për foljen kemi fjalën **dubloj** që gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Një formë e papërshtatshme është **dublikej** e cila ndeshet te [17] f. 52, te [19] f. 47 etj. Shembuj: *duplicate the vector and save the original one* dublo vektorin dhe ruaj origjinalin, *duplicate the documents* dubloj dokumentet.

edit [ˈedit] **fol.** në rastet më të zakonshme të përdorimit, kjo folje tregon ndryshim të përmbajtjes së një teksti, dokumenti, skedari apo në përgjithësi objekti virtual. Fatkeqësisht po ndeshet më shpesh pa përshtatje, pra në formën **editoj** si në anglisht. Hasim pra “për të **edituar**” te [41] f. 35, “krijon dhe **editon** tekstin” te [19] f. 44 etj. Përkthimi i duhur i kësaj foljeje është **redaktoj**. Në disa raste, kjo fjalë lidhet me botimin e librave, pra përkthehet **botoj**. Shembuj: *creates and edits the text* krijon dhe redakton tekstin, *edit a paragraph* redaktoj një paragraf, *edit in large scale* botoj në shkallë të gjerë.

edit [ˈedit] **em.** emër foljor që në një nga kuptimet i referohet ndryshimit apo modifikimit të përmbajtjes së një shkrimi, dokumenti apo objekti tjetër virtual. Njësoj si në rastin e foljes, po ndeshet shpesh në formën **editim** çka përbën një mospërshtatje. Lexojmë pra “**editimi** i skedarëve të tekstit” te [19] f. 10, “**editimi** i qelizës” te [24] f. 17, “**editimi** i imazheve” te [18] f. 101 etj. Në secilin prej këtyre rasteve duhet përdorur emri foljor **redaktim** dhe ndonjëherë **korrigjim**. Shembuj: *text file edit* redaktim i skedarit tekst, *a quick edit* një korrigjim i shpejtë, *file edit* redaktim i skedarit, *image edit* redaktim i imazhit.

editor [ˈeditër] **em.** emër që në një nga kuptimet i referohet një programi kompjuterik që shërben për shkrimin dhe redaktimin e teksteve. Njësoj si folja përkatëse, edhe emri po përdoret pa përshtatje, pra në formën **editor**. Ndeshim pra “**editori** i gjuhës Paskal” te [38] f. 62, “**editor** teksti” te [41] f. 35, “funksionet që përmbush **editori**” te [23] f. 36 etj. Përkthimi i duhur në këtë kuptim është **redaktor**, **redaktues** dhe ndeshet i shkruar saktë në pak raste si te [15] f. 61 dhe në ndonjë rast tjetër. Shembuj: *text editor* redaktues teksti, *Python language editor* redaktor i gjuhës Python, *image editor* redaktor imazhesh.

interactive [ˌintërˈektiv] **mb.** që edhe jep edhe merr informacion, që lejon kalimin e informacionit në të dyja drejtimet. Kjo fjalë ndeshet shpesh në formën e papërshtatur **interaktiv**, si p.sh. te [32] f. 19, [29] f. 49, [23] f. 60 etj. Përkthimi i duhur është fjala **ndërveprues**, siç ndeshet te [19] f. 35. Shembuj: *interactive system* sistem ndërveprues, *interactive interface* ndërfaqe ndërvepruese.

line [la:jn] **em. graf.** fjalë që mbart shumë kuptime, një ndër të cilat është

rreshti i tekstit. Shpesh në vend të **rresht** hasim *linjë*, p.sh. te [14] f. 29. Shembuj: *text lines* rreshtat e tekstit, *second line of the code* rreshti i dytë i kodit.

margin [ˈma:rxhin] **em. graf.** hapësirat boshe në buzët e një flete shkrimi, dritareje grafike apo objekti virtual. Ndeshet shpesh e mospërshtatur apo e keqpërshtatur në forma si **margin** te [29] f. 5 dhe te [24] f. 46, **marginja** te [31] f. 50 dhe te [21] f. 144, **marginet** te [19] f. 73 apo **marginet** te [41] f. 23. Përkthimi i duhur është **kontur** ose **anësore**, e cila ndeshet e përdorur saktë te [23] f. 69. Shembuj: *left margin* anësorja e majtë, *page margins* konturet e faqes.

memory [ˈmemëri] **em. a.p.** njësi apo pajisje që përdoret për ruajtjen e informacionit me qëllim përdorimin e mëvonshëm të tij. Fjala shqipe **kujtesë** e mbart plotësisht kuptimin e këtij koncepti dhe ndeshet te [28] f. 209, te [40] f. 149 etj. Fatkeqësisht po përdoret masivisht fjala **memorje** si në gjuhën e folur edhe në botime. E ndeshim p.sh. te [38] f. 111, te [41] f. 8, te [23] f. 9 etj. Shembuj: *main memory* kujtesa qendrore, *stable memory* kujtesë e qëndrueshme.

menu [ˈmenju:] **em. graf.** ndeshet ndër të tjera te dritaret e programeve grafike ose te faqet ueb dhe shërben për ta drejtuar përdoruesin në komanda të ndryshme të programit ose në seksione të ndryshme të faqes. Kjo fjalë është huazuar prej kohësh si në formën e saj origjinale, pra **menu**, formë që e gjejmë te [34] f. 123. Në disa raste si te [22] f. 89, te [26] f. 29 etj. ndeshet forma **meny**, me siguri e ndikuar nga mënyra sesi shqiptohet kjo fjalë në gjuhën gjermane (gjerm. *menü*). Shembuj: *the menu of commands* menuja e komandave, *find the command in the menu* gjeje komandën te menuja.

navigation [,naviˈgeishën] **em. h.u.** veprimi i lundrimit, pra i kalimit nga një faqe te një faqe tjetër në internet. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **lundrim**. Në tekste të ndryshme si te [31] f. 12, te [29] f. 56, te [23] f. 49 etj. ndeshet forma **navigim** e cila është e papërshtatur. Shembuj: *internet navigation* lundrimi në internet, *improved navigation speed* shpejtësi e përmirësuar e lundrimit.

preventive [priˈventiv] **mb.** që ka mundësi të shmangi ose parandalojë probleme apo efekte negative. Në teknologjinë e informacionit sugjerojmë që të përdoret fjala **parandalues**. Fjala **preventive** po ndeshet gjithnjë e më shpesh, p.sh. te [29] f. 65. Disa kuptime të saj gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH dhe mund të përdoren në financë, mjekësi etj. Shembuj: *preventive measures* masa parandaluese, *preventive maintenance* mirëmbajtje parandaluese.

query [ˈkuiiri] **em. b.d.** fjalë që ndeshet shpesh në terminologjinë e bazave të të dhënave. Nisur nga shembujt që ndeshim te [51], si dhe nga përdorimi te [15] f. 65 dhe te [14] f. 90, sugjerojmë që kjo fjalë të përkthehet **pyetësor**, **pyetës**, të cilat që gjenden dhe shpjegohen në FGJSSH. Fjala **kërkesë** që ndeshet te [20] f. 32 krijon paqartësi. Duhet shmangur në çdo rast edhe përdorimi i fjalës

query pa asnjë përkthim, siç ndodh te [21] f. 105, te [30] f. 8, te [17] f. 50 etj. Shembuj: *query language* gjuhë pyetësorësh, *query result* rezultati i pyetësorit.

record [rekërd] **em. sh.t.** një njësi që paraqitet si një rreshtim vlerash të ndryshme, zakonisht në një tabelë të bazës së të dhënave, në një skedar apo strukturë tjetër mbajtëse. Në disa botime si te [42] f. 140, te [40] f. 11, te [21] f. 94 etj., kjo fjalë është përkthyer saktësisht **regjistrim**. Në disa të tjera si te [17] f. 53, te [22] f. 26, te [24] f. 62 etj., paraqitet *rekërd* si në anglisht, fjalë që në gjuhën shqipe paraqet një koncept tjetër. Shembuj: *a table of 100 records* një tabelë me 100 regjistrime, *a record of 5 fields* një regjistrim me 5 fusha.

scope [skëup] **em. prog.** fusha apo zona ku një njësi e një programi (p.sh. një ndryshore) është e dukshme apo vepruese. Në bibliografi kjo fjalë përkthehet në forma të ndryshme, si “dukshmëri” te [50] f. 217 dhe [39] f. 370, “zona e njohjes” te [29] f. 26 apo “zonë e veprimit” te [34] f. 25. Këto përshtatje mund të mos jenë plotësisht të pavlefshme, por mbartin gjithsesi paqartësi. Emërtimi më i përshtatshëm për këtë koncept është **fushëveprim**, **fushë e veprimit**. Shembuj: *this variable has local scope* kjo ndryshore ka fushëveprim lokal, *global scope declarations are not always appropriate* deklarimet me fushëveprim global nuk janë gjithnjë të përshtatshme.

silicon [ˈsilikën] **em.** është fjala për elementin kimit **silic**, elementi me numër 14 në tabelën periodike i cili është shfaqur kohë më parë nëpër fjalorë, p.sh. te [7] f. 187. Për fat të keq, për shkak të ngjashmërisë së fjalës *silicon* me fjalën tjetër *silicone* e cila përfaqëson materialin sintetik të protezave, fjala *silicon* po përkthehet masivisht **silikën** në bibliografi. Kjo ndodh p.sh. te [23] f. 11, te [15] f. 12, te [23] f. 11 etj. Shembuj: *silicon electronics* elektronika e silicit, *silicon integrated circuit* qark i integruar silici.

tabular [ˈtebjëlër] **mb.** që është organizuar si tabelë, pra si një strukturë me rreshta dhe shtylla. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është **tabelor**, e cila ndeshet rrallë në bibliografi. Për fat të keq hasim më shpesh fjalë të tjera si p.sh. **tabular** ose **tabulare** te [17] f. 72 dhe te [28] f. 68 ose **tabelare** te [28] f. 138. Shembuj: *tabular format* format tabelor, *tabular method* metodë tabelore, *tabular representation* paraqitje tabelore.

visual [ˈvizhuëll] **mb. graf.** që paraqitet apo ilustron grafikisht, pra në mënyrë të dukshme. Po përdoret gjithnjë e më shpesh fjala **vizual** që nuk përbën shqipërim të mirfilltë. Në bibliografi e ndeshim te [32] f. 18, te [18] f. 107, te [23] f. 134 etj. Një fjalë tjetër e përshtatur pak më mirë është *viziv* që ndeshet te [17] f. 57 dhe te [31] f. 71. Në vend të tyre sugjerojmë të përdoret fjala **pamor**, **pamore**, që e mbart më së miri kuptimin. Shembuj: *visual system* sistem pamor, *visual representation* paraqitje pamore, *visual effects* efektet pamore.

visually [ˈvizhuëlli] **ndajf. graf.** ndajfolje që lidhet me kuptimin e mbiemrit më sipër, pra që tregon mënyrën pamore apo grafike të paraqitjes. Po ndeshim shpesh fjalën *vizualisht*, p.sh. tek [41] f. 41. Në vend të saj sugjerojmë përdorimin e fjalës **grafikisht**, e cila e mbart më së miri kuptimin. Shembuj: *visually depicted* përshkruar grafikisht, *visually oriented* i orientuar grafikisht.

3.6 Mungesa dhe neologjizma

Krahas përtësës në përkthime apo përkthimeve pa përshtatje, një problem tjetër përbëjnë edhe fjalët e munguara, të cilat do të duhej të zëvendësonin shumë fjalë angleze. Mungesa e përpjekjeve fjalëformuese në vitet e fundit ka qenë një arsye pse këto mungesa nuk janë plotësuar dhe rrjedhimisht kanë lënë shteg për futje të fjalëve të huaja përkatëse pa shqipërimin e duhur. Në këtë seksion po sjellim disa shembuj tipikë si edhe neologjizmat përkatëse të bazuara kryesisht te përngjitja apo kompozimi i rrënjëve ekzistuese në gjuhën shqipe:

at [et] **parafj. h.u.** simboli @ që përdoret përpara emrit të përdoruesit në rrjetet shoqërore dhe tek adresat e postës elektronike ku lidh emrin e përdoruesit me emrin e domenit. Kjo fjalë po shqiptohet thuhetse gjithnjë si në anglishte, pra *et*. Sugjerojmë që të përkthehet **arreth** (a në rreth), fjalë që lidhet me formën e simbolit. Shembuj: *use at symbol to refer to the users* përdorni simbolin arreth për t’iu referuar përdoruesve, *at symbol has special meaning* simboli arreth ka kuptim të veçantë.

benchmark [ˈbençma:rk] **fol. sh.t.** vlerësoj duke krahasuar, vë në bankë prove; vlerësoj në mënyrë krahasuese shpejtësinë apo cilësi të tjera të një objekti apo sistemi. Kjo është një fjalë e vështirë që ka qenë mungesë e hershme. Propozimi ynë është fjala **bankëshënoj** e cila lidhet me etimologjinë e fjalës *benchmark*. Shembuj: *benchmark the execution time* bankëshënoj kohën e ekzekutimit, *benchmark the new computer* bankëshënoj kompjuterin e ri.

benchmark [ˈbençma:rk] **em. 1) sh.t.** emri foljor që nënkupton veprimin e vlerësimit krahasues. Njësoj si folja përkatëse, ky emër ka përbërë mungesë prej shumë vjetësh. Propozimi ynë është përdorimi i fjalës **bankëshënim**. Shembuj: *program runtime benchmark* bankëshënim i kohës së ekzekutimit të programit, *comparative system benchmarks* bankëshënimë krahasuese të sistemit.

benchmark [ˈbençma:rk] **em. 2) sh.t.** në këtë rast kemi të bëjmë me një model, objekt apo shkallë matëse që merret si standard për krahasimin e objekteve apo modeleve të tjera midis tyre. Ky kuptim mbartet mjaft mirë nga fjala **etalon** që përdoret prej kohësh në shumë disiplina teknike. Shembuj: *the kilogram benchmark is an osenium-iridium cylinder* etaloni i kilogramit është një cilindër prej oseniumi dhe iridiumi, *multi-core system benchmark* etalon i

sistemit shumëbërthamësh.

bold [bo11d] **mb. graf.** mbiemër që i referohet llojit të shkrimit me shkronja të theksuara nga vijat më të trasha dhe më të errëta se në shkrimin e zakonshëm. Përkuesi i tij në gjuhën shqipe përbën një mungesë të kahershme. Ndodh shpesh në gjuhën e folur të dëgjojmë format ~~bo11d~~ apo ~~i-bo11duar~~, të cilat janë qesharake. Nëse i referohemi bibliografisë, gjejmë përpjekje për ta zëvendësuar me shprehje si “me të theksuara, me të trasha” te [35] f. 83, “me të nxirë” te [39] f. 60 etj. Këto fjalë e shprehje janë gjithsesi jo e përgjithshme, duke qenë se ky lloj shkrimi është i pavarur nga ngjyra, e cila mund të mos jetë detyruesisht e zezë. Propozimi është që veç fjalës i.e **theksuar** e cila vlen në disa raste, të përdoren edhe fjalët **bojëtrashë**, **bojëtrashur** të cilat i afrohen thelbësisht konceptit dhe mbulojnë kuptimisht të gjitha rastet e përdorimit të këtij shkrimi (p.sh. edhe rastet e tekstit në temë të errët, pra kur kemi sfond të zi dhe shkrim të bardhë e të theksuar). Shembuj: *a bold paragraph* një paragraf bojëtrashë, *the bold text is more visible* teksti i bojëtrashur është më i dukshëm.

top-down [,top 'daun] **mb. sh.t.** përjasje apo metodologji e njohur për zgjidhjen e problemeve apo projektimin e sistemeve, e cila e nis procesin nga problemi tërësor të cilin e ndan vazhdimisht në nënprobleme më të vogla e të thjeshta duke zbritur e përfunduar në probleme elementare që zgjidhen lehtë. Edhe këtu kemi të bëjmë me një mungesë të hershme, ndaj dhe në botime të ndryshme si te [19] f. 65 e ndeshim pa përkthim, pra në format ~~top-down~~, ~~top daun~~ ose ~~top-down~~. Propozimi ynë është mbiemri **nga-kreu-poshtë**. Shembuj: *top-down system development* zhvillim nga-kreu-poshtë i sistemit, *top-down approach* përjasje nga-kreu-poshtë.

bottom-up [,botëm 'ap] **mb. sh.t.** përjasje apo metodologji e njohur për zgjidhjen e problemeve apo projektimin e sistemeve që e nis procesin nga zgjidhja apo ndërtimi i pjesëve fundore, të cilat bashkohen hap pas hapi për të dhënë zgjidhjen apo sistemin e plotë. Edhe këtu kemi të bëjmë me një mungesë të hershme në gjuhën shqipe. Haset, pra, përdorimi në format ~~botëm-ap~~, ~~botëm ap~~, p.sh. te [19] f. 64. Propozimi ynë është mbiemri **nga-fundi-sipër**. Shembuj: *bottom-up system development* zhvillim nga-fundi-sipër i sistemit, *bottom-up approach* përjasje nga-fundi-sipër.

decrement ['dekrément] **em. prog.** fjalë që përdoret në kontekstin e programimit dhe nënkupton veprimin e zvogëlimit apo të zbritjes me 1 të vlerës së një ndryshoreje që mban një numër të plotë. Kjo fjalë përbën mungesë dhe ndeshet shpesh në formën ~~dekrément~~. Propozimi ynë është fjala **njëzbritje** e cila lidhet ngushtësisht me konceptin dhe veprimin e nënkuptuar. Shembuj: *iterative decrement* njëzbritje përsëritëse, *index decrement* njëzbritje e indeksit.

decrement ['dekrément] **fol. prog.** në ngjashmëri me emrin, folja shpreh

veprimin e zvogëlimit apo të zbritjes me 1 të vlerës së një ndryshoreje që mban një numër të plotë. Kjo folje ndeshet në formën *dekrementoj*. Sugjerimi ynë është fjala **njëzbres**, e cila lidhet ngushtësisht me konceptin dhe veprimin e nënkuptuar. Shembuj: *decrement the counter* njëzbres numërorin, *decrement the variable iteratively* njëzbres ndryshoren në mënyrë të përsëritur.

embolden [im'beuldën] **fol. graf.** shkruaj një fjalë apo pjesë teksti me shkrim të theksuar për ta dalluar nga fjalët e tjera. Njësoj siç propozojmë mbiemrat **bojëtrashë**, i.e **bojëtrashur** për fjalën *bold*, propozojmë gjithashtu foljen **bojëtrash** për fjalën *embolden*. Shembuj: *embolden the entire paragraph* bojëtrash të gjithë paragrafin, *embolden every title* bojëtrash çdo titull.

ergonomics [,ë:rgë'nomiks] **em.** fushë që studion ndërveprimin e njerëzve me pajisjet në mjedisin e punës, për të rritur prodhueshmërinë dhe shmangur rreziqet ndaj shëndetit. Kjo fjalë mund të shqipërohet **ergonomi**, për analogji me fjalët e fushave studimore apo profesioneve të ndryshme. Shembuj: *ergonomics specialist* specialist ergonomie, *ergonomics training* trajnim rreth ergonomisë.

incorporated [in'ko:rpëreitid] **mb. sh.t.** që është i bashkuar në trupin apo përbërjen e diçkaje tjetër më të madhe. Përdoret për të përshkruar njësi me funksione të veçanta që janë të implementuara në brendësi të sistemeve apo të njësive më të mëdha. Këtë mbiemër e ndeshim shpesh të përkthyer në formën *inkorporuar*, p.sh. te [41] f. 15. Kjo formë nuk përbën shqipërim, por është në një linjë me origjinën latine të fjalës trup (lat. *corpus*, it. *corpo*). Propozojmë si shqipërim të mirëfilltë fjalën i.e **trupëzuar**. Shembuj: *incorporated unit* njësi e trupëzuar, *incorporated function* funksion i trupëzuar.

increment ['inkrément] **em. prog.** veprimi i rritjes me 1 të vlerës së ndonjë ndryshoreje që mban një numër të plotë në kodin e programit. Njësoj si fjala *decrement*, kjo fjalë nuk ka gjetur përkuese në gjuhën shqipe dhe ndeshet shpesh në formën *inkrement* ose *inkrementim*, p.sh. te [31] f. 61 ose te [20] f. 39. Propozimi ynë është fjala **njërritje**, e cila lidhet ngushtësisht me konceptin dhe veprimin e nënkuptuar. Kur është fjala për rritje të paspecifikuar të vlerës mund të përdoret fjala **rritje** e cila është më e përgjithshme. Shembuj: *iterative increment* njërritje përsëritëse, *index increment* njërritje e indeksit.

increment ['inkrément] **fol. prog.** rritja me 1 e vlerës së një ndryshoreje që mban një numër të plotë në kodin e një programi kompjuterik. Në gjuhën shqipe kjo folje ndeshet në formën *inkrementoj*. Propozimi ynë është fjala **njërrit** e cila lidhet ngushtësisht me konceptin dhe veprimin e nënkuptuar. Në rastet e rritjes pa specifikim të vlerës mund të përdoret fjala **rrit** e cila është më e përgjithshme. Shembuj: *increment the counter* njërrit numërorin, *increment the variable iteratively* njërrit ndryshoren në mënyrë të përsëritur.

initialize [i'nishëlaiz] **fol. prog.** në kontekstin e programimit, kjo folje shpreh veprimin e vendosjes së një vlere fillestare të një ndryshore, objekt apo njësi tjetër e kodit. Në bibliografi ka prurje jo të përshtatshme si p.sh. *inicjalizoj* që ndeshet te [15] f. 82, te [19] f. 142, te [26] f. 54 etj. Në vend të tyre propozojmë fjalën **vlerënis** (nis vlerën) e cila e shpreh mjaft mirë veprimin në fjalë. Shembuj: *initialize integers to 0* vlerënisini në 0 ndryshoret e numrave të plotë, *use quotes to initialize strings* përdorni thonjëzat për të vlerënisur germëvargjet.

initialization [i,nishëlë'zeishën] **em. prog.** shpreh veprimin sipas foljes më sipër. Edhe për emrin gjejmë prurje të panevojshme si *inicjalizim* që ndeshet te [50] f. 145, te [29] f. 26, te [31] f. 63 etj. Në ndonjë rast si te [20] jepet shpjegimi vlerëdhënie, çka i përket një fjale dhe koncepti tjetër. Propozimi ynë është fjala **vlerënisje** (nisje e vlerës). Shembuj: *variable initialization* vlerënisja e ndryshores, *quick initialization* vlerënisje e shpejtë.

key [ki:] **em. p.f.** çelës i vendosur në tastierë që shtypet për të shkruar simbolin të cilit i përkon. Për këtë njësi fizike është përdorur tradicionalisht emri **tast, tasti, taste, tastet**, siç gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Në bibliografi vëmë re që fjala paraqitet e shtrembëruar, si p.sh. *tastø* te [38] f. 64, *tastën* te [21] f. 104, *tastat* te [17] f. 5 apo *tastøs* te [40] f. 54. Duhet theksuar se në pajisjet e sotme që kanë ekrane me prekje dhe tastiera virtuale, kjo njësi nuk gjendet si çelës që shtypet, por si buton grafik që preket. Në këto raste sugjerojmë të përdoret fjala **prekël**. Shembuj: *mechanical keyboards have big keys* tastierat mekanike kanë taste të mëdhenj, *virtual keyboard with very sensitive keys* tastierë virtuale me prekla shumë të ndjeshme.

printer ['printër] **em. graf.** pajisje e lidhur me një kompjuter që merr komanda prej tij për të shtypur në letër shkresa, dokumente, libra apo objekte të tjera informacioni. Kjo fjalë përbën një mungesë të rëndësishme dhe po përdoret masivisht **printer**, pra pa asnjë përpjekje për shqipërim me një fjalë më të përshtatshme. Përveçse në tekstet e teknologjisë së informacionit, fjala **printer** ka hyrë edhe në botime të tjera si te [54] f. 61, te [55] f. 192 etj. Njësoj si folja *print* e trajtuar te seksioni 3.4, shqetësim të madh përbën fakti që forma **printer** ka hyrë në FGJSSH (botimi i vitit 2006) duke ligjëruar kështu mungesën e përpjekjeve për shqipërim të saj, pra, përbën një gabim serioz. Propozimi ynë është fjala **gjurmështypës** bazuar në disa konsiderata. Së pari, morfema *print* në gjuhën angleze përrputhet me gjurmë në gjuhën shqipe (*fingerprints* – gjurmët e gishtave) që në këtë rast lidhet me gjurmët e shkronjave apo imazheve që pajisja lë në letër. Së dyti, në të gjitha gjeneratat e pajisjes, shkrimi i shkronjave apo imazheve në letër është kryer duke shtypur apo hedhur bojën në letër me teknika të ndryshme si goditje mekanike, polarizim elektromagnetik, rreze lazer etj. Së treti, morfema shtypje e bën këtë fjalë të përputhshme

me familjen ekzistuese shtypshkronjë, shtypi i ditës, shkrim shtypi, shkronjë shtypi, shtyp, për analogji me fjalët *la stampa*, *stampare*, *stampante*, *stampatrice* të gjuhës italiane. Shembuj: *a laser printer* një gjurmështypës lazer, *duplex printer* gjurmështypës dyanësh.

shortcut ['sho:rtkat] **em. 1) s.o.** kuptimi i parë i kësaj fjale është ai i një shtypjeje të kombinuar të disa tasteve për të kryer një veprim apo ekzekutuar një komandë shkurt dhe shpejt. Në të folur haset rëndom fjala **shortkat**, pa përpjekje për ta shqipëruar. E njëjta gjë vihet re edhe në botime të ndryshme si te [41] f. 84, te [31] f. 78 etj. Edhe kalku shkurtprerje (ose prerje shkurt) që ndeshet te [38] f. 53 nuk na duket i përshtatshëm. Propozimi ynë është fjala **shkurto**. Shembuj: *Ctrl + C is the copy command shortcut* Ctrl + C është shkurtoja e komandës së kopjimit, *quick shortcut* shkurto e shpejtë.

shortcut ['sho:rtkat] **em. 2) s.o.** kuptim tjetër i kësaj fjale është ai i një skedari në një ndërfaqe të sistemit operativ, i cili nuk përmban informacion, por shënjon te një skedar apo direktori dhe të çon tek ajo. Edhe për këtë kuptim haset në gjuhën shqipe fjala **shortkat**, p.sh. te [23] f. 43, te [25] f. 6 etj. Propozimi ynë është përsëri fjala **shkurto**. Shembuj: *shortcut icon* ikonë e shkurtores, *user directory shortcut* shkurto e direktorisë së përdoruesit.

slide [slajd] **em. graf.** fotografi a vizatim me tekst e figura që krijohet në kompjuter e shihet në ekranin e tij dhe që më pas projektohet në mur apo në ndonjë pëlhurë të bardhë. Edhe kjo fjale nuk po përkthehet, ndaj ndeshim çdo ditë e më shumë **slide**, si p.sh. te [22] f. 63, te [41] f. 74 apo te [25] f. 82. Haset edhe me njëfarë përshtatje në formën **slajd**, si p.sh. te [22] f. 71 apo te [23] f. 128. Deri disa vite më parë ka pasur përhapje fjala **diapozitiv** (it. *diapositiva*) e cila përbën huazim nga italishtja dhe gjendet jo vetëm në FGJSSH, por edhe në ndonjë botim si te [22] f. 93. Propozimi ynë është fjala **ndërpamje** (pamje për ndërveprim ose ndërkomunikim), e cila është plotësisht shqip dhe lidhet mirë me konceptin dhe kuptimin e tij. Shembuj: *a presentation of twenty slides* një prezantim me njëzet ndërpamje, *projecting the slides* projektimi i ndërpamjeve.

string [string] **em. prog.** bashkësi karakteresh shkronjore, numerike apo të veçanta që ndjekin njëra-tjetrën dhe që në kodin e programeve shkruhen brenda thonjëzave teke apo çifte. Edhe kjo fjale nuk është shqipëruar, ndaj haset shpesh e papërkthyer ose e papërshtatur. Ndeshim **string** te [34] f. 7, te [21] f. 48, te [14] f. 49 etj. Ndeshim gjithashtu variante të tjera si **stringu**, **stringun** te [29] f. 44, te [30] f. 32, etj., ose **stringjet**, **stringjeve**, te [39] f. 36, te [29] f. 44 etj. Në disa raste si te [29] f. 30 dhe te [15] f. 118, fjala haset e përkthyer **varg karakteresh**, shprehje që është e qartë, por që nuk është praktike në përdorim. Fjala e shkurtër **varg** që përdoret te [38] f. 70 dhe te [22] f. 141 është praktike, por e paqartë, sepse krijon ngatërresa me vargjet numerike. Nisur

nga këto konsiderata, propozimi ynë është fjala **germëvarg** që është praktike dhe e shpreh shumë mirë konceptin në fjalë. Shembuj: *string of special symbols* germëvarg karakteresh të veçanta, *string concatenation* bashkim i germëvargjeve.

subscript [ˈsabskript] **em. graf.** shkronjë (ndonjëherë edhe fjalë), numër apo simbol që shkruhet apo shtypet pak më poshtë se vija e shkrimit të një rreshti, dhe që shpesh lidhet me një tjetër simbol për të paraqitur një specifikë të tij. Për këtë fjalë gjejmë përkthime të ndryshme në tekste, si shkrim poshtë te [35] f. 106 ose shenjë e zhvendosur poshtë tek [35] f. 84. Të dy këta shembuj na duken jo praktikë për përdorim dhe në vend të tyre propozojmë fjalën **nëntekst**. Shembuj: *the subscript i designates the index* nënteksti **i** tregon indeksin, *this subscript is invisible* ky nëntekst është i padukshëm.

substring [ˈsabstring] **em. prog.** germëvarg më i shkurtër që merret nga një germëvarg më i gjatë, ose që bashkohet me të tjerë. Nisur nga shembujt e shumtë të fjalëve me parashtesën **sub-** të cilat në gjuhën shqipe vijnë me **nën-**, gjykojmë që fjala e duhur në këtë rast është **nënvarg**. Dallimi nga nënvargjet numerike mund të kuptohet nga konteksti apo rasti konkret i përdorimit, siç vëmë re te [21] f. 52. Shembuj: *obtain two substrings* marr dy nënvargje, *concatenate many substrings in a single one* bashkoj shumë nënvargje në një të vetëm.

subtext [ˈsabtekst] **em. graf.** në një prej kuptimeve është e njëvlershme me fjalën *subscript* të diskutuar më sipër. Për të njëjtat arsye si më sipër, propozojmë fjalën **nëntekst** si përkthim të saj në gjuhën shqipe.

superscript [ˈsu:përskript] **em. graf.** shkronjë (ndonjëherë edhe fjalë), numër apo simbol që shkruhet apo shtypet pak më sipër se vija e shkrimit të një rreshti, dhe që shpesh lidhet me një tjetër simbol për të paraqitur një specifikë të tij. Njësoj si për fjalën *subscript*, edhe për këtë fjalë gjejmë përkthimet shkrim lart te [35] f. 106 dhe shenjë e zhvendosur lart tek [35] f. 84. Në vend të tyre propozojmë të përdoret fjala **mbitekst**. Shembuj: *the superscript n designates the dimension* mbiteksti **n** tregon përmasën, *this superscript is invisible* ky mbitekst është i padukshëm.

supertext [ˈsu:përtekst] **em. graf.** në një prej kuptimeve është e njëvlershme me fjalën *superscript* të diskutuar më sipër. Për të njëjtat arsye si më sipër, propozojmë fjalën **mbitekst** si përkthim të saj në gjuhën shqipe.

trackball [ˈtrekbo:11] **em. p.f.** pajisje kompjuterike hyrëse që përfshin një sferë të rrotullueshme me të cilën përdoruesi kontrollon e lëviz kursorin në ekran. Edhe kjo fjalë haset në gjuhën shqipe vetëm në trajtë të huazuar, pra ~~trackball~~. Në disa raste si te [23] f. 29 dhe te [15] f. 45 ndeshet e përkthyer sfera rrotulluese që deri dikur qëndron. Propozimi ynë është fjala **gjurmësferë** e cila është më e përmbledhur dhe lidhet shumë mirë me strukturën dhe funksionin e pajisjes.

Shembuj: *use the trackball instead of the mouse* përdor gjurmësferën në vend të miushit, *the trackball is broken* gjurmësfera është e prishur.

tuple [ˈtapɛ11] **em. prog.** strukturë të dhënash që paraqitet si një varg prej dy apo më shumë vlerash nga tipa të çfarëdoshëm. Në bibliografi e gjejmë kryesisht në formën *n-ështe*, p.sh. te [21] f. 79, te [15] f. 191 etj. Në ndonjë rast si p.sh. te [21] f. 80 e gjejmë të përkthyer **regjistrim** çka gjykojmë që duhet shmangur, duke pasur parasysh se regjistrim përdoret për koncepte të tjera. Nisur nga fakti që në FGJSSH kemi *dyshe*, *treshe*, etj., gjykojmë që shkrimi i duhur i kësaj fjale duhet të jetë nështë pra pa vizë ndarëse. Shembuj: *a tuple of strings* një nështë germëvargjesh, *tuples are immutable in Python* nështë janë të pandryshueshme në Python.

wireless [ˈuaiɛrles] **em. rrj.** sistem i transmetimit të informacionit elektronik që përdor sinjale valore, pra që nuk përdor fije apo kablllo përcjellëse. Edhe kjo fjalë përbën një mungesë të rëndësishme dhe e ndeshim në përditshmëri të papërkthyer, pra dëgjojmë shpesh **uaiërless**. Në bibliografi ndeshet në formën **wireless**, si p.sh. te [17] f. 82, te [30] f. 6 etj. Propozimi ynë është emri **jokabllor** që lidhet drejtpërdrejt me fjalën angleze *wireless* dhe me kuptimin e saj. Shembuj: *the wireless is off* jokabllori është i fikur, *the wireless signal weak* sinjali i jokabllorit është i dobët.

wireless [ˈuaiɛrles] **mb. rrj.** mbiemri që tregon mënyrën e transmetimit të informacionit, pra duke përdorur valë në vend të lidhjeve me kablllo. Në ngjashmëri me emrin më sipër, edhe ky mbiemër ndeshet në forma të ndryshme si “pa kabulla” te [29] f. 70, “pa kablllo” te [26] f. 64, “pa tel” te [20] f. 15 etj. Njësoj si më sipër, ne propozojmë mbiemrin **jokabllor** që mund të përdoret shkëmbyeshëm me mbiemrin **valor**. Shembuj: *wireless network* rrjet jokabllor, *wireless communication technology* teknologji komunikimi jokabllorë.

3.7 Harresa dhe rijetësime

Një burim tjetër i rëndësishëm termash që mund të përdoren për të zëvendësuar fjalët angleze janë disa fjalë të hershme që gjenden e shpjegohen në FGJSSH, por që fatkeqësisht janë “harruar” dhe po përdoren gjithnjë e më rrallë. Rijetësimi i këtyre fjalëve sjell përfitime të shumëfishta. Së pari, shmangim fjalët e huaja duke i zëvendësuar me fjalë shqip që e mbartin mirë kuptimin përkatës dhe, së dyti, zgjerojmë e pasurojmë leksikun e gjuhës së folur. Më poshtë jepen disa shembuj tipikë që hyjnë te kjo kategori:

home [hëum] **em. h.u.** faqja e parë që hapet pasi vendoset një adresë te shfletuesi i uebit. Kjo faqe përmban rubrika dhe seksione me lidhje e hiperlidhje të cilat e çojnë përdoruesin në faqe të tjera. Ky koncept po emërtohet shpesh

home, pa asnjë përshtatje. Ndonjëherë ndeshim fillimi¹⁾ ose shtëpia, si p.sh. te: [22] f. 107. Edhe këto fjalë nuk na duken bindëse, sepse përbëjnë përkthime fjalë për fjalë. Sugjerojmë që në këtë kontekst të përdoren fjalët **kryefaqja**²⁾ ose **kreu**. Shembuj: *home page kryefaqja*, *home button butoni kreu*.

homepage [hëum,peixh] **em. h.u.** ndeshet edhe në formën *home page* dhe ka kuptim të njëjtë me fjalën më sipër. Edhe kjo fjalë ndeshet shpesh ~~homepage~~ ose ~~home page~~, pa asnjë përkthim apo përshtatje. Kjo ndodh te [25] f. 42, te [41] f. 48 etj. Në disa raste si te [21] f. 182 gjejmë faqja vetjake që nuk është shumë e përshtatshme për të mbartur kuptimin. Bazuar mbi të njëjtin arsyetim si më sipër sugjerojmë që fjala e duhur në gjuhën shqipe është **kryefaqe**.

link [link] **em. h.u.** kjo fjalë mbart shumë kuptime, një ndër të cilat është shënjesa që i bashkëngjitet një pjese teksti apo imazhi në një faqe ueb dhe mundëson kapërcimin nga ajo faqe te një faqe tjetër. Këtë fjalë po e ndeshim thujtë gjithnjë të papërkthyer, pra dëgjojmë e lexojmë vazhdimisht **link**, p.sh. te [31] f. 12, te [41] f. 47 etj. Ka edhe raste si te [25] f. 58 apo te [31] f. 43 ku kjo prurje paraqitet në trajtën e shquar numri shumë, pra, në formën ~~linket~~ që është e papranueshme. Emri foljor i veprimit të krijimit të lidhjes shprehet me anë të prurjes së panevojshme **linkim**, si p.sh. te [29] f. 23, te [31] f. 15 etj. Në një pjesë të mirë të rasteve si te [21] f. 173, te [22] f. 117, te [23] f. 149 etj. ndeshim fjalën **lidhje** e cila është e duhura, si për emrin e konceptit edhe për emrin foljor që shpreh veprimin e krijimit të lidhjes. Veç saj mund të rijetësojmë e të përdorim edhe fjalët **vjegë**, **vjegëz**, të cilat shpjegohen në FGJSSH dhe e mbartin mirë kuptimin e këtij koncepti. Shembuj: *the link is given below* lidhja jepet më poshtë, *send me the page link* më dërgo vjegën e faqes.

link [link] **fol. h.u.** folja që shpreh veprimin e krijimit të lidhjes së një pjese teksti apo imazhi në një faqe ueb. Fjala e vetme që shkon në këtë rast është folja **lidh**, siç ndeshet p.sh. te [38] f. 51. Shembuj: *the video is linked in the comments below* videoja është lidhur te komentet më poshtë, *link the address please* lidh adresën të lutem.

overflow [,ëuvër'flëu] **fol. prog.** të tejkalosh kapacitetin e një njësie mbajtëse duke shkaktuar defekte, gabime apo humbje informacioni. Kjo fjalë qëllon të mos përkthehet, pra të ndeshim **overflow**, **overflou**. Një fjalë e përgjithshme dhe e përshtatshme që mund të përdoret është **derdh**. Krahas saj sugjerojmë gjithashtu rijetësimin e fjalës **teptis** e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *overflow the memory buffer* derdh tamponin e kujtesës, *overflow the stack* teptis stivën.

¹⁾si p.sh. te <https://gjuhashqipe.com/fillimi>

²⁾si p.sh. te: <http://njetuferrezeshneperre.blogspot.com>

overflow [ˌœuvərˈfləʊ] **em. prog.** emri foljor që lidhet me foljen e mësipërme, pra veprimi i tejkalimit të kapacitetit të një njësie mbajtëse duke shkaktuar defekte, gabime apo humbje informacioni. Edhe kjo fjalë ndeshet shpesh e papërkthyer, pra ~~overflow~~, ~~överflow~~. Përveç fjalës **derdhje** që ndeshet te [21] f. 22, te [40] f. 190 etj., sugjerojmë rijetësimin e fjalës **teptisje** e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *stack overflow* derdhje e stivës, *unexpected register overflow* teptisje e papritur e regjistrit.

path [paːθ] **em. s.o.** rruga që duhet ndjekur nëpër hierarkinë e një sistemi skedarësh apo në një kontekst tjetër për të kaluar nga rrënja ose kreu i hierarkisë tek një skedar, direktori apo njësi tjetër. Kjo fjalë po haset gjithnjë e më shpesh e papërkthyer, pra në formën ~~path~~, p.sh. te [22] f. 7. Ndeshen edhe fjalët shteg, rrugëkalim, p.sh. te [40] f. 82 dhe [23] f. 47, të cilat janë fjalë të vlefshme dhe e mbartin mirë kuptimin. Sugjerimi ynë është që veç tyre, të rijetësojmë fjalën **rruginë**, e cila përputhet mjaft mirë në kuptim me këtë koncept. Shembuj: *absolute path* rruginë absolute, *relative path* shteg relativ, *user directory path* rrugina e direktorisë së përdoruesit.

upgrade [ˌapˈɡreɪd] **fol. sh.t.** rinovoj një makineri, mekanizëm apo sistem kompjuterik harduer ose softuer duke e kaluar në një version të ri e me teknologji të përmirësuar. Këtë fjalë në gjuhën shqipe e ndeshim shpesh të papërkthyer. Propozojmë që në vend të fjalës ~~apgrejd~~ të rijetësohet fjala **lartësoj** e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH duke mbartur disa kuptime shumë të afërta. Shembuj: *upgrade the software system* lartësoj sistemin softuer, *upgrade the kernel to version 5.12* lartësoj kernelin në versionin 5.12.

upgrade [ˌapˈɡreɪd] **em. sh.t.** emri foljor që shpreh veprimin sipas foljes së mësipërme, pra rinovimi i një makinerie, mekanizmi apo sistemi kompjuterik harduer ose softuer duke e kaluar në një version të ri me teknologji të përmirësuar. Edhe në këtë rast, në vend të përdorimit të fjalës angleze ~~apgrejd~~, sugjerojmë fjalën **lartësim**. Shembuj: *software system upgrade* lartësim i sistemit softuer, *this upgrade takes a lot of time* ky lartësim kërkon shumë kohë.

workshop [ˈuːrkʃɒp] **em.** fjalë që në përdorimin më të shpeshtë i referohet një takimi për fjalime e diskutime mbi tema të një rrethi të caktuar profesional. Në shumicën e rasteve, kjo fjalë përdoret në trajtë huazimi, pra haset thjesht ~~workshop~~. Disa fjalë të përshtatshme në gjuhën shqipe janë **punëtakim**, **takim pune**. Mund të jetë me vlerë edhe rijetësimi i fjalës *punëtori* e cila gjendet dhe shpjegohet në FGJSSH. Shembuj: *the topic of this workshop* tema e këtij punëtakimi, *workshop proposal* propozim për takim pune.

3.8 Shmangie nga tradita

Në shumë raste po vihen re shmangie nga tradita e botimeve shkollore dhe atyre shkencore që ka qenë zhvilluar ndër vite. Në raste të tilla, fjalët përkthehen në një formë shumë të ngjashme me atë të anglishtes, duke anashkaluar fjalët tradicionale që përputhen më mirë me morfologjinë dhe fonetikën e shqipes. Disa shembuj të tillë jepen më poshtë:

amplitude [ˈamplitju:d] **em. tel.** është fjala për një nga madhësitë kryesore që karakterizojnë valët, p.sh. ato që përdoren në radiotransmetime. Dikur për këtë fjalë përdorej fjala shqipe **gjani**, si p.sh. te [2] f. 30. Sot ndeshim vetëm fjalën *amplitudë*, p.sh. te [9] f. 10. Ajo që dëshirojmë të theksojmë nuk është shmangia e fjalës *amplitudë*, e cila duhet pranuar se ka hyrë me kohë në përdorim, por përdorimi sinonimisht me të i fjalës **gjani** që përbën një vlerë të shtuar në terminologjinë e kësaj fushe. Shembuj: *amplitude of acoustic waves* gjania e valëve zanore, *amplitude modulation* modulim në gjani, *amplitude of radio waves* amplituda e valëve të radios.

axis [ˈaksis] **em. sh.t.** vijë imagjinare apo konkrete kundrejt së cilës rrotullohet një objekt, ndahet simetrikisht një figurë, ose vendosen e llogariten pikat në një grafik. Kjo fjalë haset në shkrime nga disiplina të ndryshme, fatkeqësisht në formën **aks**. Fjala më e përshtatshme në gjuhën shqipe është **bosht**. Kjo e fundit është përdorur prej kohësh, si në tekste shkollore edhe në botime enciklopedike apo leksikografike si p.sh. te [6] f. 11, por ndeshet deri diku edhe në ndonjë botim të ri si te [25] f. 29. Duhet theksuar gjithsesi se në shumicën e botimeve të reja, p.sh. te [17] f. 37, te [24] f. 41 apo te [18] f. 112 përdoret fjala **aks**. Shembuj: *rotation axis* boshti i rrotullimit, *axis of coordinates* boshti i koordinatave, *axis of symmetry* boshti i simetrisë.

calculus [ˈkalkjëlës] **em. mat.** fjalë që ndeshet shpesh në tekstet e matematikës për shkollat e mesme dhe përbën emërtimin e një dege të matematikës që studion funksionet, derivatet dhe integralet. Në botimet e viteve të fundit si p.sh. te titulli i [53], po ndeshet termi **kalkulus** që bazohet te fjala e huaj, ndërkohë që tradicionalisht kjo pjesë e matematikës në gjuhën shqipe është quajtur **analiza matematike**. Shembuj: *calculus has many applications in engineering* analiza matematike ka zbatime të shumta në inxhinieri, *calculus classes are important* orët mësimore të analizës matematike janë të rëndësishme.

cascade [kaˈskejd] **em. sh.t.** i referohet njësive të lidhura njëra pas tjetrës apo hap pas hapi, në formën e rrjedhës së një ujëvare. Kjo fjalë përdoret në disiplina të ndryshme teknike duke iu referuar lidhjes dhe funksionimit të njësive të ndryshme që formojnë sisteme komplekse, hapave të njëpasnjëshëm të proceseve etj. Prej vitesh ka hyrë në përdorim edhe fjala kaskadë, e cila mund të

përbëjë një devijim nga tradita. Në ligjërimin e përgjithshëm, kaskadë është fare e papranueshme, çka vihet në dukje te [48] f. 34. Në ligjërimin tekniko-shkencor dhe në tekste apo botime të hershme leksikografike si p.sh. te [2] f. 72 ndeshim fjalën ujëvarë. Në botimet e reja si te [14] f. 150 apo te [28] f. 86 gjejmë edhe ujëvarë edhe kaskadë. Sugjerimi ynë është që të përdoret më shpesh fjala ujëvarë, ndërsa kaskadë të përdoret në raste më të rralla. Shembuj: *a cascade of condensators* një ujëvarë kondensatorësh, *cascade connection of the units* lidhje ujëvarë e njësie.

coaxial [ko'eksiëll] **mb. sh.t.** me bosht të përbashkët ose që rrotullohet rreth një boshti simetrie. Vite më parë është përdorur fjala **bashkëboshtor**, e cila përbën një përshtatje të plotë të fjalës së huaj dhe gjendet te [1] f. 19 e në botime të tjera të vjetra. Për fat të keq, në botime të reja si te [22] f. 99, te [15] f. 203, te [19] f. 24 etj. ndeshim **koaksial**, **koaksiale**, çka përbën një prurje të papërshtatur dhe shmangie të traditës. Shembuj: *coaxial cable* kabëll bashkëboshtor, *coaxial interconnected parts* pjesë të ndërlidhura bashkëboshtore, *coaxial design of the mechanism* projektim bashkëboshtor i mekanizmit.

combination [,kombi'neishën] **em. mat.** fjalë që përdoret si në ligjërimin e përgjithshëm edhe në atë shkencor, specifikisht në tekstet e matematikës. Përkthimi i duhur është fjala **kombinim**, e cila është përdorur prej shumë vjetësh në tekstet shkollore të matematikës. Forma **kombinacion** (ita. *combinazione*) duhet shmangur nga përdorimi, sepse përbën teprim me prapashtesën **-acion** (siç u sqarua te seksioni 3.1.6) dhe devijim nga tradita. Edhe prurje të tjera si **kompleksion** që ndeshet te [27] f. 3 na duken të pajustificueshme. Shembuj: *combination of different data types* kombinim i tipave të ndryshëm të të dhënave, *combination of three set elements* kombinim prej tri elementesh të bashkësisë.

keyboard ['ki:bo:rd] **em. p.f.** fjalë me përdorim të shpeshtë që emërton pajisjen fizike e cila përdoret për shkrim apo radhitje të tekstit në kompjuter. Në gjuhën shqipe, kjo pajisje është emërtuar tradicionalisht **tastierë**. Po vihet re gjithsesi njëfarë përhapje në përdorim e fjalës **tastaturë**, veçanërisht në gjuhën e folur. Ka shumë gjasa që ky devijim të ndikohet nga emërtimi i pajisjes në gjuhën gjermane (gjerm. *tastatur*) dhe duhet shmangur. Shembuj: *keyboard layout* planpamja e tastierës, *international keyboard* tastierë ndërkombëtare, *american standard keyboard* tastiera standarde amerikane.

initial [i'nishëll] **em. graf.** fjalë që në një nga kuptimet e saj i referohet shkronjave të para të fjalëve të ndryshme që përbëjnë emrin e një njeriu apo ndonjë emër tjetër zakonisht të përveçëm. Ky koncept po shprehet prej kohësh gabimisht me fjalën **iniale** e cila ka origjinë të huaj dhe është e panevojshme. Kohë më parë ishte bërë traditë që ky koncept të shprehej nëpërmjet fjalës **nistore**, e cila duhet të rikthehet në përdorim. Shembuj: *the person with initials*

A H personi me nistore A H, *spell the initials of your name* shqipto nistoret e emrit tënd, *the initial of the string is E* nistorja e germëvargut është E.

permutation [pë:rmju'teishën] **em. mat.** edhe kjo fjalë gjendet në tekstet e matematikës dhe lidhet me mënyrën e vendosjes së elementeve të bashkësive në pozicione apo rende të ndryshme si dhe numrin e vendosjeve të tilla. Po ndeshet vitet e fundit në formën *permutacion*, veçanërisht në materialet mësimore të shpërndara në rrjet. Ndeshet edhe në botime shkollore si te [52] f. 57 apo te [40] f. 213. Përkthimi i duhur në gjuhën shqipe është fjala **përkëmbim** e cila ka një traditë të gjatë përdorimi në tekstet shkollore të matematikës. Shembuj: *find the permutations of the set elements* gjej përkëmbimet e elementeve të bashkësisë, *a high number of permutations* një numër i lartë përkëmbimesh, *computing the number of permutations* llogaritja e numrit të përkëmbimeve.

priority [prai'o:rëti] **em.** rëndësia që i jepet diçkaje në raport me diçka tjetër të ngjashme. Ky koncept është shprehur në gjuhën shqipe me anë të fjalës **përparësi**. Vitet e fundit po përdoret gjithnjë e më shpesh fjala *priority* që ndeshet p.sh. te [40] f. 30. Shembuj: *priority of each task* përparësia e secilës detyrë, *high priority process* proces me përparësi të lartë.

subject ['səbɪhɛkt] **em.** fushë në një shkresë zyrtare apo mesazh të postës elektronike ku vendoset titulli i mesazhit apo lënda e shkresës. Për këtë kuptim të fjalës është përdorur tradicionalisht fjala **lëndë**, **lënda**. Vitet e fundit po devijohet nga tadita duke përdorur (me siguri për lehtësi përkthimi ose nga padituria) fjalën *subjekt*, p.sh. te [22] f. 115, te [41] f. 59, te [24] f. 89 etj. Fjala *subjekt* që përdoret në gjuhën shqipe për kuptime të tjera, nuk ka asnjë arsye pse ta zëvendësojë fjalën **lënda**, kur është fjala për kuptimin e sqaruar më sipër.

variable ['veriëbëll] **em. prog.** simbol apo emërtim që përfaqëson një madhësi apo të dhënë të caktuar e cila kombinohet me të tjera nëpërmjet veprimeve aritmetike, logjike, etj. Kjo fjalë ka qenë emërtuar **ndryshore**, siç shpjegohet në FGJSSH dhe ndeshet te [38] f. 59, te [34] f. 20, te [22] f. 139 etj. Për fat të keq, po haset gjithnjë e më shpesh forma e papërkthyer *variabël*, p.sh. te [31] f. 41, te [29] f. 24, te [30] f. 41 etj. Shembuj: *scalar variable* ndryshore skalare, *a variable that occupies 4 bytes* një ndryshore që zë 4 bajte.

variable ['veriëbëll] **mb. sh.t.** mbiemri që lidhet me kuptimin e emrit më sipër, pra me madhësi të ndryshueshme. Edhe në këtë rast, po ndeshet fjala *variabël*, p.sh. te [9] f. 46, te [15] f. 85 etj. Fjala e duhur në gjuhën shqipe është i **ndryshueshëm**, e **ndryshueshme**. Shembuj: *variable memory size* madhësi e ndryshueshme e kujtesës, *variable voltage* tension i ndryshueshëm.

Problemet e paraqitura më sipër vijnë, me sa kuptojmë, nga prirja drejt përkthimeve fjalë për fjalë të cilat janë më të lehta. Bie në sy p.sh. emërtimi

linjë në fillim të çdo kapitulli te [23]. Në faqen 27 të këtij teksti shkruhet “Në këtë linjë synohet që nxënësi të...”. Është e qartë që kemi të bëjmë me një përkthim fjalë për fjalë të fjalës angleze *line*, e cila, ndër kuptimet e shumta, i referohet edhe kapitujve nëpër tekste. Në traditën e teksteve shkollore shqipe është përdorur fjala kapitull, e cila në këtë rast do të përbënte përshtatjen e duhur. E njëjta gjë vihet re edhe te [19] ku në fillim të çdo kapitulli ndeshet fjala tematikë, me siguri përkthim i fjalës angleze *topic*. Edhe në këtë rast përshtatja e duhur në gjuhën shqipe duhej të kryhej me emërtimin kapitull. Gabime të tilla ndeshen edhe për fjalë të tjera në botime të shumta.

4 Problematika të hapura

Për disa fjalë ka qenë e pamundur të gjejmë shqipërime apo përshtatje të pranueshme. Të tilla janë një pjesë e ndërkombëtarizmave, disa fjalë informale dhe me kuptime të figurshme ose mungesa të hershme, keqpërshtatjet apo përshtatjet e pjesshme të të cilave kanë zënë rrënjë prej kohësh në të folur dhe në botime. Këto fjalë paraqiten si problematika të hapura dhe gjykojmë që nevojiten diskutime të gjera për të gjetur format e duhura të përshtatjes apo huazimit të tyre. Në vazhdim jepen disa shembuj nga kjo kategori:

animate është folje që shpreh veprimin e krijimit të modeleve, imazheve, apo lojërave që duken të lëvizshme apo si të vërteta e njerëzore. Në tekste të ndryshme si te [22] dhe te [19], kjo fjalë përkthehet *animoj*, çka nuk përbën një shqipërim të mirfilltë. Është e vështirë në këtë rast të gjejmë një përshtatje të favorshme, jo vetëm në përputhje me kuptimin e fjalës së huaj, por edhe bazuar te hapësira leksikore të shqipes. Një variant ndoshta i pranueshëm mund të ishte fjala jetësoj, pra i jap jetë objekteve e imazheve duke i bërë të lëvizshme. Nuk jemi të bindur nëse folja jetësoj mund të pranohet gjerësisht.

animated është mbiemri që lidhet me foljen më sipër. Në bibliografi si p.sh. te [18] f. 29 ndeshim prurjen i,e *animuar*. Njësoj si për foljen më sipër, një variant mund të ishte i,e jetësuar.

animation është veprimi sipas kuptimit të foljes më sipër, pra krijimi i modeleve, imazheve, apo lodrave që duken të lëvizshme apo si të vërteta e njerëzore. Një kuptim tjetër i emrit është vetë objekti që rezulton. Në shumicën e rasteve e ndeshim *animacion*, p.sh. te [30] f. 3, te [41] f. 74, te [23] f. 134 etj. Në raste të tjera ndeshim fjalën *animim*, p.sh. te [31] f. 8, te [23] f. 135 etj. Në ndonjë rast të veçantë si te [31] f. 109 ndeshen të dyja format e mësipërme. Nuk mund ta themi me siguri nëse jetësim mund t'i mbarti të dyja kuptimet e emrit dhe mund të pranohet gjerësisht.

animative është një mbiemër që mbart kuptimin e të qenit i tillë që mund të bëhet i lëvizshëm e me tipare njerëzore, ndryshe nga mbiemri *animated* që tregon se objekti është bërë i tillë. Ndonjëherë ky mbiemër cilëson efektet që përdoren për të arritur këtë qëllim. Kjo fjalë është përkthyer *animativ* te [22] dhe na duket e vështirë për t'u shqipëruar, duke qenë se mbiemri jetësor nuk do të mund t'i shprehte kuptimet e ndryshme në mënyrë të qartë dhe të dallueshme.

backup ose *back-up* ndeshet me përdorim të gjerë në drejtime të ndryshme të informatikës dhe si emër nënkupton veprimin e ruajtjes së të dhënave të një sistemi informatik, ose të të dhënave së bashku me softuerin dhe konfigurimet e sistemit në një pajisje të jashtme. Nëse sistemi dëmtohet dhe humbet të dhënat ose konfigurimet, kopja në pajisjen e jashtme përdoret për ta rikthyer

në gjendjen e mëparshme. Përdoret edhe për të emërtuar vetë kopjen rezervë të të dhënave që krijohet dhe ruhet. Na duket e vështirë të gjejmë një fjalë ose një shprehje në gjuhën shqipe që ta mbarti këtë kuptim. Për këtë arsye ndeshen rëndom përdorime si ~~bekap~~ oes ~~backup~~, p.sh. te [19] f. 10, te [43] f. 14, te [29] f. 55 etj. Në disa raste si tek [19] ndeshim shprehjen “ruajtje e kopjes elektronike” e cila është disi e gjatë. Shprehje disi më të shkurtra janë “kopje rezervë” dhe “kopje mbështetëse” të cilat ndeshen te [40]. Nuk jemi të sigurt nëse këto shprehje mund të pranohen.

backup ose *back-up* është veprimi i ruajtjes së të dhënave të sistemeve informatike për të parandaluar humbjen e tyre. Njësoj si për emrin, është e vështirë të gjendet një fjalë në gjuhën shqipe që ta zëvendësojë këtë folje. Për këtë arsye ndeshen rëndom përdorime si ~~bej backup~~ apo ~~bej bekap~~. Disa shprehje të mundshme do të ishin “mbaj kopje mbështetëse” apo “krijoj kopje rezervë”, por që përsëri nuk duken praktike për përdorim të shpeshtë.

case-sensitive është mbiemër që shpreh dallimin midis shkronjave të mëdha dhe atyre të vogla prej programeve apo sistemeve kompjuterike. Këtë fjalë e gjejmë pa përkthim, p.sh. te [31] ku lexojmë *case-sensitive* në faqen 37 dhe *case sensitive* në faqen 58. Nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë fjalë apo shprehje të përmbledhur që ta shprehi mirë këtë kuptim.

chat nënkupton si folje përfshirjen në një bisedë virtuale me një apo disa persona të tjerë duke shkëmbyer mesazhe teksti. Kjo fjalë ka përdorim të gjerë ndërkombëtar dhe po përdoret masivisht në formën ~~çatoj~~, e cila na duket e papranueshme. Është e vështirë t’i rezistohet prirjes për ta përdorur këtë fjalë si në gjuhën e origjinës, ndaj variante të shqipëruara si bisedoj virtualisht vështirë se mund të hyjnë në përdorim masiv.

chat është emri sipas kuptimit të foljes më sipër. Në të folur haset në format ~~çat~~ dhe ~~çet~~. Në bibliografi gjejmë *chat*, te [17] f. 93, te [22] f. 110 etj. Shqipërimi si bashkëbisedim dhe komunikim në kohë reale që ndeshen përkatësisht te [21] f. 167 dhe te [29] f. 58 duken të vështira për tu pranuar.

chip është emër që i referohet qarqeve elektronike me integritet të lartë (dendësi shumë të lartë transistorësh) të cilët përbëjnë bazën e elektronikës numerike dhe pjesës harduer të kompjuterikës. Kuptimi i drejtpërdrejtë është *çifël* apo *cefël*, duke qenë se njësitë të cilave i referohet janë copëza të vogla prej materiali gjysmëpërcjellës. Në tekstet e sotme si te [9] f. 40, te [41] f. 9 apo te [18] f. 41 ndeshet në formën *çip*, pra fonetakisht njësoj si fjala e huaj. Na duket e vështirë që *çifël* apo *cefël* të pranohen, duke qenë se në gjuhën shqipe devijojnë ndjeshëm nga kuptimi ndërkombëtar që ka marrë fjala angleze. Një variant që e mbulon mirë nga ana kuptimore është fjala *mikroqark* që ka gjasa më të mira për të zënë rrënjë, të paktën në ligjërimin libror.

cookie është emër që i referohet disa skedarëve të vegjël që faqet e ndryshme ueb vendosin në pajisjet e përdoruesve të atyre faqeve me qëllim mbledhjen e të dhënave të ndryshme. Të dhënat tregojnë se si përdoruesi ka ndërvepruar me faqen dhe bëjnë të mundur përmirësimin e shërbimit që ajo ofron, por mund të përdoren edhe për arsye reklamimi. Kjo fjalë po shfaqet herë si ndërkombëtarizëm dhe herë e përshtatur në gjuhë të ndryshme. Në gjuhën gjermane është huazuar në formën *cookie*, pra pa asnjë ndryshim. Forma më e natyrshme në gjuhën shqipe do të ishte biskotë. Nëse do ta trajtonim si një ndërkombëtarizëm lind diskutimi për mënyrën e shkrimit të saj.

custom që është ideuar, projektuar apo ndërtuar specifikisht për një person, arsye apo qëllim. Në gjuhën e folur e ndeshim rëndom *kastëm*. Në bibliografi haset në forma të ndryshme si sipas parapëlqimit të [35] f. 96, me porosi të [38] f. 50 apo i zgjedhur të [22] f. 32. Nuk është e lehtë të gjendet një fjalë apo shprehje që mbulon shumicën e rasteve të përdorimit.

debug është folje që shpreh veprimin e korigjimit të gabimeve në kodet e programeve kompjuterike. Fjala për gabimet në kod është *bug* që do të thotë insekt. Ky emërtim është informal dhe shumë i vështirë për t'u përshtatur në gjuhë të tjera. Në gjuhën e folur dëgjojmë shpesh *dibag*. Në bibliografi gjejmë përpjekje si ndreqje e gabimeve të [22] f. 238 dhe të [34] f. 43, largim i gabimeve të [19] f. 65 etj. Këto shprehje është e vështirë të pranohen, duke pasur parasysh përdorimin e gjerë që ka marrë fjala angleze.

debugger është program kompjuterik që ndihmon në gjetjen dhe korigjimin e gabimeve në kodet e programeve që shkruhen nga programistët. Në bibliografi gjendet ndonjë shprehje si korrektues i programeve që ndeshet të [15] f. 66.

debugging është veprimi sipas foljes më sipër dhe paraqitet gjithashtu shumë i vështirë për t'u përshtatur. Në bibliografi gjejmë rrallë ndonjë përpjekje si të [19] f. 172 ku haset shprehja korrigjim i kodit.

desktop është emër me përdorim ndërkombëtar që në kuptimin kryesor u referohet makinave kompjuterike që përdoren për qëllime të ndryshme nëpër zyra. Kjo fjalë ka hyrë në përdorim masiv në formën *desktop* dhe na duket e vështirë që të mund të zëvendësohet nga ndonjë fjalë tjetër, edhe nëse ndonjë e tillë do të propozohet. Një kuptim tjetër më teknik dhe specifik i kësaj fjale është ai i sistemit grafik të sistemeve operative që përdoren në kompjutera. Për këtë kuptim ndoshta mund të përdoret shprehja *sistem grafik*.

e-mail është ndoshta ndërkombëtarizmi me përdorim më të shpeshtë në të gjitha gjuhët, për shkak të masivizimit që shërbimi i postës elektronike ka marrë në mbarë botën. Në rastet më të shpeshta, kjo fjalë po ndeshet *e-mail*, p.sh. të [17] f. 55, të [29] f. 48 etj. Në disa raste të tjera si të [30] f. 5 apo të [41] f. 56

hasim formën email. Shqipërimi më i fortë është postë elektronike dhe ndeshet te [38] f. 12, te [24] f. 88 etj. Duket se përdorim më të madh ka forma e-mail, e cila është më e shkurtër se postë elektronike. Në disa raste edhe më të rralla kryhet përshtatja fonetike, duke e shkruar në formën imejll. Një propozim tjetër mjaft interesant është fjala postel (**postë elektronike**), e cila përbën bashkimin e fillesave të fjalëve që përbëjnë shprehjen postë elektronike. Pavarësisht se paraqitet si një fjalë mjaft elegante, kjo e fundit duket e vështirë për tu pranuar, duke qenë se bashkime të tilla fjalësh nuk janë të natyrshme në gjuhën shqipe. Shkrimi i duhur i fjalës *e-mail* ngelet problem i hapur dhe pjesë e diskutimeve.

footer është emër që përdoret më së shumti në programet kompjuterike për shkrime e redaktime dokumentesh dhe ka të bëjë me konturin e poshtëm të dokumentit, aty ku vendosen shënime të caktuara që përsëriten në faqe të ndryshme. Në bibliografi ndeshim emërtime si “shënim në fund të faqes” te [35] f. 91, “nëntitull” te [35] f. 105, “këmba e faqes” te [38] f. 51, “shënimet në këmbë” te [17] f. 40 etj. Asnjë prej tyre nuk bind, sepse krijojnë keqkuptime.

firewall është pajisje dhe mekanizëm që shërben për të mbrojtur rrjetet kompjuterike nga rreziqet dhe sulmet e jashtme. Edhe kjo fjalë po kthehet në ndërkombëtarizëm dhe në gjuhën e folur ndeshet siç shqiptohet në gjuhën angleze, pra fajiëruoll. Në ligjërimin libror si te [22] f. 120 dhe te [29] f. 61 ndeshet e shkruar në formën firewall, pa asnjë përshtatje e madje edhe pa u lakuar. Një rast i përkthyer është shkrimi në formën “muri mbrojtës (firewall)” që haset te [17] f. 85. Shkrimi në këtë formë, si përkthim i plotë dhe me sqarim në kllapa të fjalës në gjuhën angleze, ndoshta është i arsyeshëm.

framework është fjalë që përdoret shpesh në programim dhe inxhinieri softuer dhe i referohet një bashkësie modulesh softuer që përdoren për të lehtësuar dhe shpejtuar zhvillimin e programeve kompjuterike për një drejtim të caktuar zbatimesh dhe detyrash. E kemi të vështirë të gjykojmë nëse kjo fjalë duhet trajtuar si një ndërkombëtarizëm apo nëse duhet shqipëruar. Propozimi ynë do të ishte fjala punështrim (shtrim i punës) që e mbulon mirë kuptimin e konceptit. Si në shumë raste të tjera, ngelet dyshimi se sa gjasa do kishte për të zënë rrënjë fjala shqipe që propozohet, kundrejt fjalës së huaj *framework* që ka hyrë tashmë në përdorim, të paktën në gjuhën e folur.

hacker është fjalë që përdoret shpesh në fushën e sigurisë kompjuterike dhe ka të bëjë me personat që përpiqen për të hyrë në sisteme apo rrjete kompjuterike pa autorizim dhe duke tejkalluar mekanizmat mbrojtës. Kjo fjalë po përdoret e shqiptuar haker si tek [18] f. 136 dhe tek [20] f. 7 ose pa ndryshim, pra hacker si p.sh. te [29] f. 57. Një fjalë që i afrohet për nga kuptimi do të ishte zhbirues. Ngelet mëdyshja nëse fjala angleze duhet pranuar si ndërkombëtarizëm apo duhet zëvendësuar me zhbirues apo ndonjë fjalë të ngjashme.

header njësoj si *footer* por këtu është fjala për konturin e sipërm të faqes. Në bibliografi ndeshim emërtime të ndryshme si koka e gjallë te [35] f. 91, koka e faqes te [38] f. 51, shënimet në kokë te [17] f. 40 etj. Përsëri e kemi të vështirë të gjykojmë nëse ndonjë prej tyre përbën emërtimin e duhur të konceptit.

host është fjalë që përdoret në disa kontekste të informatikës. Në një prej tyre ka të bëjë me makinën virtuale tek e cila instalon dhe ekzekutohen sisteme operative të virtualizuara. Shumë i ngjashëm është përdorimi që emërton mjedisin ku “strehohen” programet ueb apo programe të tjera të cilat përdoruesi i arrin dhe i kontrollon së largu. Një përdorim tjetër ndeshet në rrjete kompjuterike ku kjo fjalë emërton një nyjë të rrjetit që komunikon me nyjat e tjera dhe që mund të jetë kompjuter personal, pajisje transmetuese, pajisje e ndërmjetme etj. Po vihet re përdorimi i fjalës si në gjuhën angleze, pra ndeshim *host* te [31] f. 25, te [22] f. 111, te [15] f. 221 etj. Nuk jemi të sigurt nëse kjo fjalë duhet pranuar si ndërkombëtarizëm apo duhen bërë përpjekje për shqipërim.

laptop është ndërkombëtarizëm që ndeshet shpesh, për shkak se pajisja kompjuterike e mbartshme të cilës i referohet ka marrë përhapje dhe përdorim mjaft të gjerë vitet e fundit. Kjo fjalë ka hyrë në të folur si në formën e gjuhës së origjinës, pra ndeshim në përditshmëri të thuhet dhe shkruhet *laptop* edhe në gjuhën shqipe. Në disa botime si te [41] f. 15 dhe te [23] f. 13 ndeshet shqipërimi kompjuter portativ. Ky emërtim ngjan me fjalën italiane *portatile*, ose ndonjëherë *computer portatile* dhe na duket i pranueshëm. Na duket gjithsesi e vështirë që këto forma të pranohen dhe të përdoren në masë, duke qenë se forma si në gjuhën e origjinës ka kohë që përdoret.

memorize është folja që shpreh veprimin e ruajtjes së informacionit në kujtesën e pajisjeve kompjuterike. Ndryshe nga *memory*, për të cilën kemi fjalën kujtesë, kjo folje paraqitet e vështirë. Në të folur përdoret shpesh fjala *memorizoj*, e cila ndeshet edhe në botime, p.sh. te [41] f. 76 apo te [23] f. 14. Një fjalë tjetër më e rrallë është *memoruj* që ndeshet te [27] f. 407. Na duket e vështirë që *memorizoj* të zëvendësohet nga ndonjë shqipërim më i mirë.

memorization është emri foljor i lidhur me foljen më sipër si dhe mbiemri që shpreh funksionin apo rolin e një njësie, pra atë të ruajtjes së informacionit. Në gjuhën e folur dhe në bibliografi ndeshet më shpesh në format *memorizim* dhe *memorizues*, p.sh. te [28] f. 183. Ndeshet ndonjëherë edhe *memoruese*, p.sh. te [50] f. 188 dhe te [39] f. 12. Edhe në këtë rast na duhet e vështirë që *memorizim* dhe *memorizues* të mund të zëvendësohen.

monitor është pajisje që shfaq informacionin që del nga një kompjuter apo sistem tjetër. Po e ndeshim shpesh në gjuhën e folur në formën *monitor*, pa asnjë ndryshim nga fjala angleze. Kjo fjalë është e ngjashme me fjalën *ekran*,

por nuk jemi të sigurt nëse mund ta zëvendësojmë me fjalën ekran në çdo rast. Huazimi i emrit monitor është ndoshta i nevojshëm.

online është ndërkombëtarizëm shumë i përdorur, sidomos dy vitet e fundit për shkak të virtualizimit të shumë veprimtarive. Bazuar te shpjegimi që jepet tek [33] f. 263, kjo fjalë tregon që një veprim apo proces kryhet duke përdorur një pajisje kompjuterike si kompjuter personal, telefon të mençur etj. të lidhur në internet dhe duke komunikuar nga larg. Në bibliografi ndeshet në shumicën e rasteve online, pra si në gjuhën e origjinës. Kjo ndodh te [43] f. 49, te [17] f. 87, te [41] f. 64 etj. Në pak raste si te [21] f. 164 dhe te [24] f. 94 përshtatet fonetiki në formën onlajn. Ende nuk mund ta themi me siguri se si duhet shkruar në gjuhën shqipe kjo prurje.

option është fjalë që ka kohë që ka hyrë në përdorim në formën option. Edhe në bibliografi paraqitet në atë formë, p.sh. te [24] f. 47. Në ndonjë rast tjetër si te [39] f. 3 e hasim në formën opcion. Nëse do të duhet të zgjidhnim midis këtyre dy varianteve, gjykojmë që option është fjalë më e përshtatshme, nisur nga shkalla më e gjerë e përdorimit.

roaming është përdorimi i telefonisë së lëvizshme jashtë rrjetit lokal (p.sh. në një shtet tjetër) duke u lidhur me rrjetet e firmave të tjera. Për këtë fjalë, në gjuhën e folur dëgjojmë rëuming, siç shqiptohet në gjuhën angleze. Në bibliografi ndeshet në pak raste si te [29] f. 53 e shkruar roaming dhe me sqarim në kllapa “thirrjet jashtë vendit”. Ndoshta kjo fjalë duhet pranuar si një ndërkombëtarizëm dhe huazuar pa ndryshime.

router është pajisje rrjeti që merr paketa informacioni nga një drejtim dhe i dërgon në një drejtim tjetër te një pajisje e lidhur me të, duke u bazuar te një algoritëm i përcaktimit të rrugës së paketave dhe te adresat e burimit dhe destinacionit që paketa mbart. Në bibliografi e ndeshim shpesh në formën router, pa asnjë ndryshim nga fjala angleze. Kjo ndodh p.sh. te [29] f. 70. Në disa raste të tjera si te [29] f. 59 dhe te [24] f. 87 ndeshet e përshtatur në formën ruter, fjalë që nuk përbën shqipërim të mirëfilltë. Disa mundësi shqipërimi ndoshta të pranueshme janë rrugëzues ose rrugëtues.

routing është procesi i marrjes së paketave të informacionit nga një drejtim dhe dërgimi në një drejtim tjetër. Në bibliografi ndeshet e përshtatur me fjalën rrugëzim, p.sh. te [24] f. 87. Në ndonjë rast tjetër si te [19] f. 20 ndeshim fjalën rrugëtim. Edhe në këtë rast është vështirë të gjykojmë cila formë duhet përdorur, duke qenë se fjala është shumë teknike.

schedule është folje që shpreh veprimin e hartimit të një plani të punëve apo aktiviteteve, shpesh të renditur në kohë. Në sistemet kompjuterike ky veprim ndodh shpesh të kryhet automatikisht nga module softuer të sistemit.

Në gjuhën e folur dëgjojmë shpesh skeduloj. Disa shqipërime të mundshme do të ishin planshtroj ose planvujtoj. Na duket e vështirë që të mund ta zëvendësojnë fjalën skeduloj e cila ngjason shumë me fjalën angleze.

schedule është emri që lidhet me foljen më sipër, pra një plan i kryerjes së punëve ose radhë kohore e aktiviteteve. Ky koncept shprehet në shqipen e folur me anë të fjalës skedul, p.sh. te [32] f. 16. Te [14] f. 21 ndeshim edhe fjalën skedulim për procesin, pra emrin foljor që rrjedh nga folja. Njësoj si për foljen, disa shqipërime të mundshme do të ishin planshtrim ose planvijim, të cilat përsëri duken të vështira të pranohen në përdorim të gjerë.

scheduler është moduli softuer që kryen veprimin e shprehur nga folja më sipër. Në gjuhën e përditshme ndeshim fjalën scheduler. Njësoj si më sipër, dy mundësi shqipërimi janë fjalët planshtrues, planvijues.

server është makinë e lidhur në internet që ofron faqe ueb apo shërbime të tjera për përdoruesit. Kjo fjalë ka hyrë në përdorim masiv njësoj si në anglisht, pra në formën server. Po në këtë formë ndeshet edhe në bibliografi, p.sh. te [24] f. 86, te [19] f. 18, te [38] f. 11 etj. Nuk jemi të sigurt, por ndoshta duhet pranuar si një huazim në atë formë.

site kuptimi i drejtpërdrejtë është vendi i një godine, qyteti etj. Në kontekstin e teknologjisë së informacionit mbart kuptimin e një hapësire virtuale në internet, ku firmat, organizatat apo individët vendosin informacion. Për këtë kuptim ka hyrë fjala sajt që ndeshet p.sh. te [15] f. 214. Një tjetër variant është sit që ndeshet te [31] f. 11. Nuk jemi të sigurt nëse duhet të pranojmë ndonjë nga këto fjalë apo nëse mund të gjehet ndonjë shqipërim tjetër.

storage ka të bëjë me procesin e ruajtjes së përhershme të informacionit në pajisje të ndryshme si dhe kapacitetin ruajtës të atyre pajisjeve, pra sasinë e informacionit që mund të mbajmë. Në përdorimin si emër po ndeshet gjithnjë e më shpesh, njësoj si në gjuhën e origjinës, pra storage në të shkruar dhe storich në shqiptim. Një shqipërim që i shkon për shtat këtij përdorimi është fjala storazh, e cila ndjek shembujt e disa fjalëve të tjera tekniko-shkencore me prejardhje të huaj si voltazh, kilometrazh etj. Përdorimi i kësaj fjale në shprehje si *storage device* apo *storage capacity* ndeshet në tekste në forma të ndryshme si bartës te [34] f. 74 dhe te [40] f. 152, si dhe rezervim te [40] f. 182. Për procesin gjejmë edhe ruajtje, p.sh. te [41] f. 7. Ende nuk mund ta themi me siguri se cila formë është më e përshtatshme dhe nëse përshtatjet në gjuhën shqipe do të mund ta zëvendësonin përdorimin e fjalës si në gjuhën angleze.

visualize është veprimi i paraqitjes grafike të informacionit. Po përdoret gjithnjë e më shpesh fjala vizualizoj, e cila nuk përbën shqipërim të mirfilltë. Në bibliografi haset p.sh. te [21] f. 87, te [24] f. 72 etj. Një shqipërim mund të

ishte fjala pamësoj e cila lidhet me familjen e fjalëve pamje, pamor, duke i plotësuar.

visualization është emri foljor që lidhet me foljen më sipër. Edhe për këtë fjalë po ndeshim më së shumti vizualizim, p.sh. te [37] f. 44, te [15] f. 60, te [19] f. 89 etj. Një shqipërim i mirë mund të ishte fjala pamësim, e cila do të plotësonte familjen pamje, pamor, pamësoj.

website që ka kuptim të afërt me fjalën *site* të diskutuar më sipër, por që e vë theksin më shumë te faqja konkrete që ruhet në hapësirën virtuale. Po përdoret masivisht fjala website pa asnjë ndryshim nga fjala angleze, p.sh. te [29] f. 56, te [41] f. 50, te [19] f. 67 etj. Ka edhe raste me përshtatje gjysmake si websajt te [31] f. 21, sit web te [31] f. 11 etj. Nëse do të pranohej fjala sajt për *site*, mund të pranohej edhe fjala websajt për *website*, bazuar në arsyetimin për fjalën *web* që u dha te seksioni 3.2.3.

5 Problematika të teksteve shkollore

Përgjatë shfletimit të bibliografisë, nuk mund të mos t'i shihnim me shqetësim problemet e ndryshme që shfaqen në tekstet e informatikës ose të teknologjisë së informacionit për klasat e arsimit parauniversitar. Veç problemeve që lidhen me përkthimet “Google Translate”, disa prej të cilave u vunë në dukje më sipër, vihen re edhe shumë probleme të tjera. Organizimi i programit mësimor në kapituj duket në disa raste jo i përshtatshëm. Tek [31] vërejmë p.sh. që në kapitullin e parë mësohet zhvillimi i faqeve ueb me anë të programit Macromedia Dreamweaver. Kjo nënkupton që nxënësit të kenë njëfarë njohjeje bazë të koncepteve të uebit, si elementet e gjuhës HTML. Ndërkohë, kapitulli i dytë i po të njëjtit tekst trajton pikërisht ato koncepte bazë të gjuhës HTML. Kemi të bëjmë, pra, me një renditje të mbrapshtë të këtyre dy kapitujve. Në mënyrë të ngjashme, kapitulli i katërt te [19] f. 105 është emërtuar “Programimi dhe Algoritmika”. Edhe ky emërtim është i mbrapshtë, duke pasur parasysh botimet e ngjashme (ndeshet zakonisht emërtimi “Algoritmikë dhe programim”), si edhe vetë radhën e njohurive që merren në të (fillohet me koncepte nga algoritmika dhe kalohet në njohuri programimi).

Shqetësim përbën edhe prirja drejt përkthimeve fjalë për fjalë, pa përshtatjen e duhur dhe duke anashkaluar traditën e emërtimeve në botimet shkollore. Kjo vihet re në emërtimin e kapitujve, siç u vu në dukje te kreu 3.8. Prirja drejt përkthimeve fjalë për fjalë vihet re edhe nëse krahasojmë të njëjtat fjalë në botimet më të hershme, me mënyrën se si janë përkthyer në botimet e viteve të fundit. Një shembull është fjala angleze *record*, e cila në botimet e viteve '90 ndeshet e përkthyer saktësisht **regjistrim** (një hyrje në një bazë të dhënash). Në botimet e fundit, të njëjtën fjalë e gjejmë të përkthyer **rekord**, e cila ngjan me fjalën angleze dhe në shqip i referohet një koncepti tjetër (arritja më e lartë në një garë sportive etj.), pra përbën një emërtim të gabuar. Një tjetër shembull është fjala angleze *column*, e cila dikur përkthehej më së shumti shtyllë dhe më rrallë kolonë. Në botimet e viteve të fundit, këtë fjalë e ndeshim vetëm kolonë, pra si fjala në gjuhën angleze. Te [14] f. 29 shkruhet “...mund të jetë e vështirë për të testuar linjat individuale të kodit...”. Në këtë rast, fjala angleze *lines* është përkthyer gabimisht **linjat**, në vend që të përkthehej **rreshtat**, duke iu referuar rreshtave të kodit.

Nuk mungojnë as gabimet logjike nga pakujdesia, si p.sh. te [19] f. 129 ku jepet $g = 3,14$ (përafrim i konstantes π) dhe shpjegohet “nxitimi i rënies së lirë”, ndërkohë që dihet se nxitimi i rënies së lirë ka vlerë të përafërt 9,81. Gabimet e natyrës sintaksore janë gjithashtu të shpeshta. Vihen re p.sh. ngatërime të foljeve me emra apo e kundërta. Te [38] f. 49 folja *browse* jepet e përkthyer **shfletues**, pra si emër. Përkthimi i duhur në këtë rast do të ishte folja **shfletoj**.

Një tjetër shembull i ngjashëm ndeshet te [38] f. 51 ku shprehja *map network drives* (këtu fjala *map* paraqitet si folje) përkthehet ~~harta e drajverave të rrjetit~~, ku mungon folja. Përkthimi i duhur do të ishte **pasqyro njësitë e rrjetit**. Te [23] f. 87 lexojmë “bashkësia e disa karaktereve të ndara me spacio bosh formon një fjalë”. Në këtë rast kemi përdorimin e fjalës ~~spacie~~ (it. *spazio* – hapësirë), e cila përbën shtrembërim të fjalës përkatëse italiane. Në këtë rast, në vend të ~~spacie bosh~~ duhej të shkruhej **hapësirë**. Gafa të ngjashme gjenden edhe te [41] f. 12 ku shkruhet ~~natyralisht~~ në vend të **natyrisht**, te [20] f. 7 ku shkruhet ~~autentifikim~~ në vend të **autentikim**, te [14] f. 72 ku shkruhet ~~integriteti preferencial~~ në vend të **integriteti referencial** etj. Këto gabime lidhen kryesisht me redaktimin e teksteve, proces që në shumicën e rasteve duket se është i dobët dhe i pakujdesshëm. Në raste të tjera si te [37] dhe [32] redaktimi mungon qartas, po të kemi parasysh faktin që në këto tekste shkronjat ë dhe ç nuk figurojnë fare por shkruhen e dhe c.

BIBLIOGRAFI

- [1] Q. Turdiu, P. Pilika, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e matematikës dhe e mekanikës teorike)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [2] S. Kuneshka, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e elektromagnetizmit)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [3] R. Çani, E. Emiri, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi, S. Riza: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e elektroteknikës)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [4] F. Sinoimeri, S. Kuneshka, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi, S. Riza: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e termodinamikës)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [5] F. Sinoimeri, S. Kuneshka, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi, S. Riza: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e energjisë atomike)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [6] S. Kuneshka, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi, S. Riza: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e mekanikës)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [7] M. Karajani, K. Popa, A. Xoxe, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbiba, M. Domi: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e kimisë)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.
- [8] B. Daja, Ç. Fico, M. Qarri, A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, F. Leka, L. Dodbiba, S. Doga: “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (terminologjia e arkitekturës)”, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Prishtinë, 1969.

- [9] Luçiana Toti (Kini): “Elektronika 1”, Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM), Tiranë, 2014.
- [10] David Crystal: “*Internet Linguistics: A Student Guide*”, Routledge, 2011.
- [11] Erion Çano, Ondřej Bojar: “*Efficiency Metrics for Data-Driven Models: A Text Summarization Case Study*”, Association for Computational Linguistics, Proceedings of INLG 2019, the 12th International Conference on Natural Language Generation, pp. 229-239, Tokyo, Japan, 2019.
- [12] Yoav Goldberg: “*A Primer on Neural Network Models for Natural Language Processing*”, CoRR, ArXiv abs/1510.00726, Computation and Language, 2015.
- [13] Erion Çano, Ondřej Bojar: “*How Many Pages? Paper Length Prediction from the Metadata*”, Association for Computation Machinery, Proceedings of NLPPIR 2020, the 4th International Conference on Natural Language Processing and Information Retrieval, pp. 91-95, Seoul, Korea, 2020.
- [14] Altina Myderizi, Ada Gogu: “Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 12 (me zgjedhje, për arsimin e mesëm të përgjithshëm)”, Pegi, Tiranë, 2018.
- [15] Eqerem Arkaxhiu, Juliana Ahmeti: “Hyrje në informatikë”, SHBLU, Tiranë, 2007.
- [16] Androkli Kostallari, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Emil Lafe: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Akademia e shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 1973.
- [17] Marenglen Bukli, Esmeralda Tasho, Genc Brahimaj, Guri Tome: “Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, kurrikula bërthamë)”, ERIK, Tiranë, 2010.
- [18] Matt Burgess: “Inteligjenca Artificiale: Si do të përcaktohet dekada e ardhshme nga zhvillimi i sistemeve kompjuterike?”, Lekë, 2021.
- [19] Ada Gogu, Altina Myderizi: “Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 10 (për klasën e 10-të të arsimit të mesëm të përgjithshëm)”, Pegi, Tiranë, 2016.
- [20] Ada Gogu, Altina Myderizi: “Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit 11 (për arsimin e mesëm të përgjithshëm)”, Pegi, Tiranë, 2017.

- [21] Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Frederik Shalësi: “Informatika 4 (për shkollat e mesme, drejtimi natyror)”, IDEART, Tiranë, 2006.
- [22] Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Entela Jegeni: “Informatika 3 (drejtimi natyror)”, IDEART, Tiranë, 2008.
- [23] Frederik Shalësi, Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu: “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (për klasën e X-të)”, IDEART, Tiranë, 2011.
- [24] Frederik Shalësi, Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu: “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (bërthamë, për klasën e XI-të)”, IDEART, Tiranë, 2012.
- [25] Lediana Bardhi, Anduela Lila: “TIK 7 (për klasën e shtatë të arsimit 9-vjeçar)”, Mediaprint, Tiranë, 2020.
- [26] Lediana Bardhi, Anduela Lila: “TIK 8 (për klasën e tetë të arsimit 9-vjeçar)”, Mediaprint, Tiranë, 2020.
- [27] Agni Dika: “Qarqet Kompjuterike Kombinuese 1”, Adea, Prishtinë, 2005.
- [28] Ilia Ninka: “Sisteme logjike”, SHBLU, Tiranë, 2010.
- [29] Marenglen Bukli, Genc Brahimaj, Silvana Greca, Indrit Baholli: “TIK i Avancuar (për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, kurrikula me zgjedhje të detyruar)”, ERIK, Tiranë, 2010.
- [30] Suela Maxhelaku, Esmeralda Tasho, Silvana Greca: “Ushtrime dhe problema TIK 11 (bërthamë dhe me zgjedhje)”, Irisoft Education, Tiranë, 2017.
- [31] Marenglen Bukli, Genc Brahimaj, Esmeralda Tasho, Silvana Greca: “TIK 12 (për klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit, kurrikula me zgjedhje të detyruar)”, ERIK, Tiranë, 2011.
- [32] Bashkim Ruseti, Kozeta Sevrani: “Sistemet e informacionit të menaxhimit”, Tiranë, 2014.
- [33] University of Columbia: “*Dictionary of Computer and Internet Terms (seventh edition)*”, Columbia University Press, New York, 2002.
- [34] Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu: “Informatika 3 (për shkollën e mesme të përgjithshme të profilizuar, profili natyror)”, SHBLSH, Tiranë, 2003.
- [35] Neki Frashëri, Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu: “Informatika 1 (për shkollën e mesme të profilizuar)”, SHBLSH, Tiranë, 2002.

- [36] Nuri Gokaj: “Baza të gjuhësisë së përgjithshme”, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 1997.
- [37] Bashkim Ruseti, Kozeta Sevrani: “Informatika (për Fakultetin e Ekonomisë)”, Tiranë, 2012.
- [38] Ilia Ninka, Eqerem Arkaxhiu, Frederik Shalësi: “Informatika 2 (për shkollat e mesme të përgjithshme)”, SHBLSH, Tiranë, 2002.
- [39] Agni Dika: “Bazat e Programimit në C++”, Arbëria Design, Tetovë, 2005.
- [40] Ilia Ninka: “Struktura të dhënash”, SHBLU, Tiranë, 1998.
- [41] Lediana Bardhi, Anduela Lila: “TIK 6 (për klasën e gjashtë të arsimit 9-vjeçar)”, Mediaprint, Tiranë, 2019.
- [42] Ilia Ninka: “Struktura të dhënash”, SHBLU, Tiranë, 2012.
- [43] Lediana Bardhi, Anduela Lila: “TIK 9 (për klasën e nëntë të arsimit 9-vjeçar)”, Mediaprint, Tiranë, 2019.
- [44] Mihallaq Maço: “Praktika me televizorët bardhezi dhe me ngjyra”, 8 Nëntori, Tiranë, 1989.
- [45] Samela Bajraktari: “Zbulimi i Sulmeve në Rrjet Njëpërmjet Teknikave të Mësimit Automatik”, Zenodo, Tetor, 2021.
- [46] Michelangelo Grosso, Paolo Prinetto, Maurizio Rebaudengo, Matteo Sonza Reorda: “*La programmazione in Assembler x86*”, Xlibris, 2012.
- [47] Daniela Cancila, Stefano Mazzanti: “*Il dizionario enciclopedico di informatica (inglese-italiano, italiano-inglese)*”, Zanichelli, Bologna, 2009.
- [48] Shaban Kelmendi, Muhamed Dolaku: “Fjala shqip në vend të fjalës së huaj”, GJUHA JONË, Mitrovicë, 2000.
- [49] Agni Dika: “Algoritmet (njohuri themelore me programe në C++)”, Adea, Prishtinë, 2007.
- [50] Agni Dika: “Programimi i Orientuar në Objekte në C++”, Arbëria Design, Tetovë, 2008.
- [51] Paolo Atzeni, Stefano Ceri, Stefano Paraboschi, Riccardo Torlone: “*Basi di dati: Modelli e linguaggi di interrogazione (Terza edizione)*”, McGraw-Hill, 2009.

- [52] Tanush Shaska: “Algjebra”, AulonnaPress, 2010.
- [53] Tanush Shaska: “Kalkulus II (njehsimi integral)”, AulonnaPress, 2010.
- [54] Mustafa Ibrahim: “Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare”, Interlingua, Shkup, 2009.
- [55] Vinçens Marku: “Fjalor i Rimave”, FIORENTIA, Shkodër, 2016.
- [56] Vedat Kokona: “Fjalor frëngjisht-shqip”, botimet Kokona, Tiranë, 2008.
- [57] Ali Dhrimo, Edmond Tupja, Eshref Ymeri: “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, botimet EDFA, Tiranë, 2007.
- [58] Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillari, Hajri Shehu, Thanas Feka, Valter Memisha, Artan Goga: “Fjalor i gjuhës shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

KOPERTINA